

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • NR. 424 • MARS 2026

SADEKATUL FITRI – NGA TRADITA
PROFETIKE TE PRAKTIKA BASHKËKOHORE

SHFRYTËZIMI I DHJETËSHIT
TË FUNDIT TË RAMAZANIT

HISTORI E SHKRUAR
ME LAPS TË HUAJ

Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan

*Të dashur qytetarë,
Të respektuar besimtarë,
Vëllezër dhe motra,*

Sot, në këtë natë të bekuar të Ramazanit dhe në atmosferën festive të datës sonë më të rëndësishme kombëtare, 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së vendit tonë, zemrat tona rrahin njësoj për besimin dhe atdheun.

Ramazani është muaji kur Fjala Hyjnore zbriti si dritë për njerëzimin, udhëzim për zemrat, shërim për shpirtat dhe mëshirë për botët. Është koha kur zemrat hapen për Librin e Zotit dhe shpirtat përulen para Madhërisë së Tij. Ai na mëson durimin, faljen dhe solidaritetin, duke na kujtuar se forca më e madhe e njeriut është zemra e pastër dhe dora që ndihmon.

Zoti i Madhërihëm thotë: “Muaji Ramazan është muaji në të cilin zbriti Kurani.” (El Bekare, 185).

Ky muaj i bekuar na fton në rrugën e drejtë, na edukon me drejtësi, dhembshuri e moral të lartë dhe na udhëzon drejt paqes së brendshme. Ramazani është shkolla e shpirtit, ku besimtari pastrohet nga gabimet, forcohet në besim dhe rritet në devotshmëri. Është koha kur leximi i Kuranit bëhet frymëmarrje e zemrës, lutja gjuhë e shpirtit dhe sadakaja dritë në rrugën tonë. I Dërguari ynë, Muhamedi a.s., ishte njeriu më bujar, ndërsa bujaria e tij arrinte kulmin pikërisht në këtë muaj.

Në këtë natë të bekuar, kur hëna e Ramazanit ngrihet mbi horizontin shpirtëror të vendit tonë, le të reflektojmë për dy dashuri që na formësojnë: dashurinë ndaj fesë dhe dashurinë ndaj atdheut. Ramazani është më shumë se agjërim; është një shkollë hyjnore vetëpërmbytjeje, pastrim ndërgjegjeje dhe lartësim moral. Ai e bën njeriun më



të ndjeshëm ndaj tjetrit dhe më të përkushtuar ndaj së mirës së përbashkët.

Historia jonë dëshmon se besimi ka qenë burim frymëzimi për angazhim qytetar dhe kombëtar, veçanërisht në momentet kyçe si shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, kur u kurorëzua një sakrificë e gjatë për liri, drejtësi dhe dinjitet.

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Dashuria ndaj fesë dhe ndaj atdheut nuk janë në kundërshtim, por plotësojnë njëra-tjetrën. Besimi e formon karakterin, ndërsa atdheu i jep atij hapësirë veprimi. Ramazani na thërret ta forcojmë lidhjen me Zotin dhe përgjegjësinë ndaj vendit tonë, institucioneve dhe së ardhmes së përbashkët.

Agjërimi i muajit Ramazan është një nga adhurimet më të veçanta, sepse është ibadet që besimtari e kryen vetëm për hir të Krijuesit, me bindje të plotë, vullnet të lirë dhe sinqeritet të thellë shpirtëror. Ai nuk është thjesht përmbajtje nga ushqimi dhe pija, por një akt i pastër devotshmërie që buron nga zemra dhe dëshmon besimin e vërtetë. Për këtë sakrificë të heshtur e të sinqertë, agjëruesi ka shpërblim të veçantë te Zoti, sepse agjërimi është adhurim intim ndërmjet robit dhe Krijuesit të tij, i njohur plotësisht vetëm prej Tij. Në këtë qëndron madhështia e tij: një

përkushtim i brendshëm që e pastron shpirtin, e forcon karakterin dhe e afron njeriun me mëshirën hyjnore.

*Të dashur qytetarë,
Vëllezër dhe motra,*

Mesazhi i Ramazanit është paqja. Ai pastron zemrën nga urrejtja, ndalon fyerjen dhe e ngre respektin në themel të bashkëjetesës. Është thirrje për vetëpërmbytje, vëllazëri dhe dashuri aktive, që sjell harmoni shoqërore. Nxitja e urrejtjes është mëkat i rëndë dhe tradhti ndaj frymës së këtij muaji. Ta ruajmë vëllazërinë dhe kombin tonë me zemër të pastër dhe vendosmëri që dashuria të triumfojë mbi çdo përçarje.

Le të lutemi që ky Ramazan të na gjejë më të bashkuar në vlera, më të fortë në besim dhe më të vendosur në mbrojtje të lirisë sonë. Le të jetë kohë reflektimi për thellimin e dashurisë ndaj fesë si burim drite dhe ndaj Kosovës si amanet i të parëve e përgjegjësi ndaj brezave që vijnë.

Në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të saj, si Myfti i Republikës së Kosovës, ju përcjell urimet më të sinqerta për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan. Le të jetë kjo kohë pastrimi shpirtëror, afrimi me Zotin dhe forcimi i unitetit, dashurisë e solidaritetit ndërmjet nesh.

*Gëzuar dhe me fat muajin e bekuar
Ramazan!*

*Zoti e bekoftë popullin tonë dhe
Republikën e Kosovës!*

Prishtinë, 18 shkurt 2026

*Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë*


- 2 **Urimi i Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, me rastin e fillimit të muajit të bekuar Ramazan**

EDITORIALI

- 4 **Kur'ani – arsyeja pse një natë u bë më me vlerë se një jetë njeriu**

FETARE

- 5 **Ramazani dhe njeriu bashkëkohor – nga fikhu i përmbajtjes te fikhu i transformimit**
Dr. Selatin Mehani
- 9 **Agjëroni, do të jeni të shëndetshëm!***
Ismail Haveriq
- 12 **Namazi i teravive**
Shjeh Vehbi Sulejman Gavoqi²
- 17 **Efektet e punëve të rënda fizike në prishjen e agjërimit**
Mr. Ekrem Maqedonci
- 20 **Shfrytëzimi i dhjetëshit të fundit të Ramazanit**
Mr. Vedat Shabani
- 24 **Sadekatul fitri – nga tradita profetike te praktika bashkëkohore**
Dr. Ejup Haziri
- 28 **E drejta e institucioneve fetare në përcaktimin e prioriteteve brenda fondeve të zekatit**
Flurim Krasniqi
- 31 **Kuptimi i kaderit në akiden islame**
Dr. Bahri Hoxha



- 35 **Përulu që të lartësohesh!**
Dr. Afrim Jusufi
- 37 **Përfitimet e faljes së namazit**
Sead Ahmetaj

FAMILJA DHE EDUKIMI

- 40 **Ngrohtësia e syfyrin të varfër**
Bajram Zeqiri

KULTURË

- 42 **Histori e shkruar me laps të huaj**
Besnik Jaha, phd
- 45 **Ngritja e Islamit deri në vitin 2050**
Piers Morgan
- 49 **Libër që mbështillet me semantikë të pasur dhe argumentuese**
Bilall Maliqi

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 51 **Ndriçime historike - 2**
Harun Shabanaj

AKTIVITETE

- 55 **Myftiu Tërnavë mori pjesë në iftarin e shtruar nga emiri i Katarit, Tamim bin Hamad al Thani**



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 424 • viti 39 • Mars 2026
• Ramazan 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

“Dituria Islame”,
rr. “Bajram Kelmendi”, nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
“Printing Press”, Prishtinë



Kurani – arsyeja pse një natë u bë më me vlerë se një jetë njeriu

“Na kemi zbritur - shpallur atë (Kurani) në Natën e Kadrit . E kush të tregon ty se çështë Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj. Engjëjt dhe Xhibrili, me lejen e Zotit të tyre, zbresin në të, për të zbatuar (të gjitha) urdhrat e Zotit. Paqe, ajo natë qoftë gjer në agim.”

(El Kadër, 1-5)

Asnjë ngjarje nuk mund ta bënte një natë më madhështore se kjo: që nga qielli të zbriste Libri që u bë udhëzim për njerëzimin dhe dritë për zemrat e tyre gjer në amshim. Ky Libër, pos faktit që përmbodhi ajkën e gjithë librave të tjerë të mëhershëm, gëzoi të drejtën ekskluzive dhe hyjnore nga Zoti, që të përmyllte zinxhirin fisnik të të gjithë dërgesave të mëhershme qiellore në tokë. Dhe, sigurisht me këtë Libër u nderua një njeri duke u zgjedhur si lajmëtar dhe peygamber, i graduar si më i miri dhe më i dashuri tek Allahu ndër gjithë peygamberët e Tij. Fjala e Zotit, e zbritur te Muhamedi u cilësua nga vetë Ai, si një Fjalë e Rëndë. Allahu thotë: *“Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë (të madhe).”* (El Muzemil, 5).

E rëndë për peshën e porosive të përmbledhura në të dhe për madhësinë e mesazheve hyjnore që kristalizojnë gjer në skajshmëri dilemat më kapitale të njeriut në këtë botë, si dhe fazat e ardhshme të tij, në jetën e përtejme. Rëndesën e kësaj Fjale, e ndiente Muhamedi a.s. edhe gjatë zbritjes së saj, siç edhe transmetonte Abdullah ibën Amëri, i cili ka thënë: E pyeta Peygamberin a.s., dhe i thashë: “O i Dërguari i Allahut, a e ndien (si përjetim) shpalljen?” Ai tha: “Dëgjo një tingull si zhurma e zinxhirëve (ose kambanave), me çrast unë shtangem në heshtje në atë çast; dhe nuk më është shpallur asnjëherë shpallja pa menduar se shpirti im do të më dalë.” (Transmeton Imam Ahmed).

Megjithatë, vlerën dhe madhësinë e kësaj nate, po të mos e pikaste vetë Krijuesi Absolut, s'do të arrinte ta kuptonte dot as vetë Peygamberin, që e kishte pranuar Mesazhin e Tij. Allahu në mënyrë eksplicite e emërtoi një kaptinë në Kuran, me emrin e kësaj nate. Kaptina El Kadër (kaptina e vlerës dhe madhësisë) pra ishte ajo kaptinë që e mori emrin e njëjtë me atë të natës në cilën zbriti Kurani - Nata e Kadrit - vlerës dhe madhësisë. Aty Zoti rrëfeu të pathënat e kësaj nate duke thënë: *“Na kemi zbritur - shpallur atë (Kurani) në Natën e Kadrit . E kush të tregon ty se çështë Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj. Engjëjt dhe Xhibrili, me lejen e Zotit të tyre, zbresin në të, për të zbatuar (të gjitha) urdhrat e Zotit. Paqe, ajo natë qoftë gjer në agim.”* (El Kadër, 1-5). Rrëfimi i Zotit për Peygamberin rreth kësaj nate mbetet lajmi më kreibil për të, e gjithsesi edhe për të gjithë ata që besojnë në shenjtërinë e misionit të tij.

Për ta kuptuar madhësinë e kësaj nate, duhet ndalur e menduar se si do të ishte gjendja e njerëzimit, nëse tek ata nuk do të ishte ekzistent Libri të cilin Zoti e kishte zbritur mu në këtë natë. Dilema, nëse në këtë natë është zbritur i tërë Kurani ne qiellin e kësaj bote, apo në të ka filluar zbritja e Kuranit, nuk prek fare madhësinë e kësaj nate. Në të dy interpretimet ajo mbetet e pashembullt dhe e papërsëritshme në histori.

Andaj, Ai Zot që zgjodhi që një Libër të pashembullt ta zbresë në Natën e Kadrit, bekoji ymetin që i besoi këtij Libri, duke bërë veprën e kryer prej tij në këtë natë, më me vlerë se veprën që do ta bënte për një mijë muaj. Më me vlerë se sa vepra që do të mund të bënte kushdo nga besimtarët gjatë një jete të tërë prej mbi tetëdhjetë e tri vjetëve. Duke qenë se në muajin Ramazan, fshihet kjo natë, i Dërguari i Allahut, i nxiste shokët e tij që të jenë vigjilentë e ta kërkojnë atë natë më shtim adhurimi dhe përkushtimi në dhjetëshin e fundit, për të mos mbetur të privuar nga shpërblimi madhështor i rezervuar ekskluzivisht brenda saj. Ai i porosiste shokët e tij dhe gjithë besimdrejtët duke u thënë: *“Kërkojeni Natën e Kadrit në dhjetë netët e fundit të Ramazanit.”* (El Buhari, 2020; Muslimi, 1169). Por, formën e kërimit e shëmbëlleu ai vetë, duke u izoluar në xhami (*itika*) në dhjetëshin e fundit të Ramazanit, duke shmangur jetën e rëndomtë dhe duke ndërruar disiplinën e tij të përditshme në favor të adhurimit e përgjërimit ndaj Zotit të tij, që aq shumë e shijonte. Andaj, nëse aspirojmë bekimet e Zotit në atë natë, ta ndjekim me sinqeritet atë që më së miri na rrëfeu për vlerën e asaj Nate dhe që iu përkushtua fisnikërisht gjer në vdekje jetësimit të mirëfilltë të Librit që iu zbrit nga Zoti i tij.

Mr. Driton Arifi

Ramazani dhe njeriu bashkëkohor – nga fikhu i përmbajtjes te fikhu i transformimit

Dr. Selatin Mehani

HYRJJE

Ramazani zë një vend qendror në jetën fetare të myslimanëve dhe përfaqëson një nga shtyllat themelore të Islamit. Ai përfaqëson një periudhë të veçantë shpirtërore dhe sociale, gjatë së cilës agjërimi zë vendin qendror. Agjërimi i Ramazanit nuk është vetëm një praktikë fetare, por edhe një disiplinë etike dhe shëndetësore, që synon vetëpërmbajtjen, solidaritetin dhe përforcimin e vetëdijes morale. Në kontekst shkencor, ai ofron një fushë të gjerë studimi mbi ndikimet fiziologjike, psikologjike dhe shoqërore tek individit dhe komuniteti. Megjithatë, pavarësisht përhapjes së gjerë të praktikimit të agjërimin, vërehet se ndikimi i tij në jetën e përditshme të njeriut bashkëkohor shpesh mbetet i kufizuar dhe i përkohshëm. Agjërimi kryhet, por transformimi i thellë shpirtëror dhe moral nuk është gjithmonë i dukshëm.

Njeriu bashkëkohor jeton në një realitet të karakterizuar nga ritmi i shpejtë i jetës, konsumi i tepruar dhe mbingarkesa informative. Në këtë kontekst, adhurimet rrezikojnë të reduktohen në praktika formale, të shkëputura nga funksioni i tyre formues. Agjërimi, në veçanti, shpesh perceptohet si përmbajtje fizike nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime bashkëshortore, pa u shoqëruar me një proces të vetëdijshëm ndryshimi të brendshëm.

Ky punim synon të argumentojë se ky reduktim i kuptimit të agjërimin është pasojë e dominimit të asaj që mund të quhet “fikhu i përmbajtjes”, dhe se rikthimi i efektit real të Ramazanit kërkon kalimin drejt “fikhut të transformimit”, i cili e sheh agjërimin si projekt formues të njeriut në tërësi.

PROBLEMATIKA E KUPTIMIT TË AGJËRIMIT NË REALITETIN BASHKËKOHOR

Në diskursin e përditshëm fetar, agjërimi trajtohet kryesisht nga këndvështrimi normativ: si manifestohet agjërimi, çfarë e prish atë, cilat janë kushtet e tij dhe cilat janë përjashtimet ligjore. Kjo qasje është e domosdoshme për vlefshmërinë juridike të adhurimit, por mbetet e pamjaftueshme për realizimin e qëllimeve të tij më të thella. Problemi shfaqet kur ky nivel normativ shndërrohet në horizontin e vetëm të kuptimit. Si pasojë, agjërimi përjetohet si barrë kohore, si disiplinë sezonale, ose si traditë shoqërore, dhe jo si proces formimi. Kjo shpjegon pse shumë individë kthehen shpejt në sjelljet e mëparshme sapo përfundon Ramazani.



DEFINICIONI I AGJËRIMIT NGA ASPEKTI GJUHËSOR DHE SHERIATIK

Nga aspekti gjuhësor, agjërimi (صوم) nënkupton përmbajtjen nga diçka, lënien dhe heqjen dorë prej saj; ai shpreh përmbajtje të përgjithshme dhe largim nga një veprim a send.¹ Kështu thuhet: filani agjëroi duke u përmbajtur nga të folurit, ose nga fjalët e kota, ose nga e pavërteta dhe dëshmia e rreme, ose nga të ngrënit dhe të pirët. Allahu i Lartësuar tregon për Merjemen, kur ajo ishte shtatzënë me Isain, paqja qoftë mbi të: “Atëherë ai e thirri atë prej poshtë saj: ‘Mos u trishto! Zoti yt ka bërë nën ty një përrua. Shkunde pranë vetes trungun e palmës: do të bien mbi ty hurma të pjekura. Ha dhe pi dhe qetësohu. E nëse sheh ndonjë njeri, thuj: ‘Unë i kam bërë një zotim Mëshiruesit për agjërime, prandaj sot nuk do t’i flas asnjë njeriu.’” (Merjem, 24-26).

Këtu, termi “agjërime” nënkupton përmbajtje nga të folurit, pra një formë e përmbajtjes gjuhësore.²

Nga aspekti juridiko-fetar, agjërime është adhurim ndaj Allahut të Lartësuar, i realizuar përmes përmbajtjes nga veprat që e prishin agjërimit; ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime, duke filluar nga agimi i vërtetë e deri në perëndim të diellit, shoqëruar me qëllimin (nijetin).³

Duke u mbështetur në kuptimin gjuhësor dhe fetar, agjërime në thelb përfaqëson një akt të përmbajtjes së vetëdijshme, i cili nuk synon vetëm ndalimin formal nga veprime të caktuara, por orienton njeriun drejt reformimit të brendshëm dhe një kalimi transformues nga një gjendje shpirtërore, etike dhe shoqërore në një tjetër më të lartë.

NGA FIKHU I PËRMBAJTJES TE FIKHU I TRANSFORMIMIT

Në këtë studim, shprehjet “fikhu i përmbajtjes” dhe “fikhu i transformimit” përdoren si kategori analitike për të dalluar mes dimensionit formal-juridik të agjërimit dhe qëllimit të tij edukativ e transformues. Fikhu i përmbajtjes përqendrohet kryesisht në aspektin trupor të agjërimit: ndalimin e ushqimit, pijes dhe marrëdhënieve intime nga agimi deri në perëndimin e diellit. Ky dimension është themelor dhe përbën bazën juridike të agjërimit, por ai nuk përfaqëson qëllimin përfundimtar të tij.

Në të kundërt, fikhu i transformimit e sheh agjërimit si një proces të vetëdijshëm riedukimi të njeriut. Përmbajtja fizike shndërrohet në mjet për disiplinimin e dëshirave, për forcimin e vullnetit dhe për rivendosjen e ekuilibrit mes trupit, shpirtit dhe arsyes. Në këtë kuptim, agjërime nuk synon thjesht ndalimin, por riorientimin e individit. Allahu i Lartësuar ka urdhëruar agjërimit me një qëllim të qartë shpirtëror: “O ju që besuat! Agjërime ju është caktuar juve,

Fikhu i transformimit e sheh agjërimit si një proces të vetëdijshëm riedukimi të njeriut.

sikurse u ishte caktuar atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.” (El Bekare, 183).

Shprehja kuranore لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ tregon qartë arsyen ligjore të Sheriatit تعليل الشارع për këtë ibadet. Kjo do të thotë se ndalimi nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime nuk është qëllimi final i agjërimit, por shërben si mjet për të arritur deri te takvaja (devotshmërinë), e cila përfshin ndërtimin e vetëdijes së brendshme për Allahun dhe orientimin e sjelljes së individit drejt dobisë, drejtësisë dhe largimit nga e keqja. Nga kjo perspektivë, agjërime shfaqet jo vetëm si një praktikë fizike, por si një proces transformues dhe edukativ, ku përmbajtja formale shërben për realizimin e reformimit moral, edukativ dhe shpirtëror të njeriut.

Pejgamberi a.s., ka theksuar rëndësinë e agjërimit përtej ndalimit fizik kur tha: “Kush nuk ndalet nga fjalët e këqija dhe nga veprat e këqija, Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijet e tij.”⁴

Ky hadith e bën të qartë se fakti vetëm fizik i ndalimit nuk e realizon qëllimin e agjërimit nëse shoqërohet me sjellje të dobëta morale dhe sociale.

Po ashtu, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Agjërime është mburojë (kundër mëkateve).”⁵ Dhe në hadithe të tjera: “Agjërime është mburojë nga zjarri i Xhehenemit, ashtu si mburoja e një luftëtari në betejë.”⁶

Këto fjalë nënkuptojnë se agjërime është një mjet mbrojtës shpirtëror, jo vetëm një ndalim fizik; ai izolon njeriun nga dëshirat dhe veprat që e çojnë në humbje në këtë botë dhe në botën tjetër.

Së këndejmi, agjërime krijon një ndërprerje të qëllimshme nga rutina e zakonshme e jetës, duke i dhënë individit mundësinë të reflektojë mbi varësitë e tij, prioritetet dhe raportin me vetveten dhe të tjerët. Kjo ndërprerje, nëse shoqërohet me vetëdije dhe këmbëngulje në moral dhe devotshmëri, mund të shndërrohet në pikënisje të një transformimi të qëndrueshëm dhe të thellë shpirtëror dhe shoqëror.

ASPEKTET E TRANSFORMIMIT PËRMES AGJËRIMIT

Disiplinimi i vetes dhe vetëkontrolli

Agjërime kërkon kontroll të dëshirave të menjëhershme, si: uria, etja dhe impulset emocionale. Thuhet se, në psikologjinë moderne, aftësia për të moderuar kënaqësitë e menjëhershme lidhet ngushtë me suksesin personal, stabilitetin emocional dhe përmirësimin e marrëdhënieve sociale.

Në nivel sheriatik, Pejgamberi a.s., ka thënë: “Agjërime është mburojë (kundër mëkateve).”⁷

Kjo mburojë nuk është vetëm fizike; ajo ndalon njeriun të veprojë impulsivisht dhe të bie në mëkate, duke e disiplinuar

karakterin dhe forcimin e vullnetit. Po ashtu, hadithi: “Kush nuk ndalet nga fjalët e këqija, Allahu nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijet e tij”⁸, tregon se qëllimi i agjërimit shkon përtej trupit – ai synon disiplinimin moral dhe vetëkontrollin në çdo aspekt të jetës.

Për këtë arsye, shumë dijetarë e shpjegojnë se agjërimi i vërtetë është ai që ndalon ndër-lidhjen e sjelljeve të këqija, si: fyerjet, shpifjet, debatet pa arsye apo fjalët e pavlera, dhe jo vetëm trupin nga ushqimi dhe pijet.

Rritja e vetëdijes morale dhe shpirtërore

Agjërimi ndihmon në zhvillimin e ndërgjegjes morale, duke i bërë individët të reflektojnë mbi veprimet dhe pasojat e tyre. Allahu thotë: “O ju që besuat! Agjërimi ju është caktuar juve, sikurse u ishte caktuar atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.” (ElBekare, 183). Kjo devotshmëri nënkupton vetëdijen për praninë e Zotit dhe përgjegjësinë morale ndaj krijesave të Tij. Përmes agjërimit, njeriu mëson të vlerësojë pasojat e veprimeve të veta dhe të orientojë jetën e tij drejt së mirës dhe dobisë.

Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush agjëron në Ramazan, me bindje dhe shpresë (në pranim), do t’i falen mëkatet e kaluara.”⁹ Kështu ai ngjallë shpresë të madhe të agjëruesit për një shpërblim madhor duke krijuar mekanizmat për një transformim imanor dhe praktik. I Dërguari, përcolli nga Zoti hadithin kudsij kur tha: “Agjërimi është për Mua, dhe Unë do të shpërblej për të.”¹⁰

Kjo tregon se agjërimi është një mundësi për reflektim, vetëdisiplinë dhe lidhje të drejtpërdrejtë me Allahun, duke nxitur transformimin shpirtëror dhe thellimin e devotshmërisë, sepse shpërblimi për agjërimitin është një e drejtë

Përmes vetë-përmbajtjes, agjërimit formëson një karakter altruist dhe forcon solidaritetin shoqëror.

ekskluzive e Allahut dhe lidhet drejtpërdrejt me bujarinë e Tij të pakufishme.

Purifikimi shpirtëror dhe psikologjik

Në nivelin psikologjik dhe neuroshkencor, kufizimi i ushqimit dhe zakoneve të menjëhershme ka një efekt “detoksikues”, duke ulur stresin dhe rritur fokusin. I Dërguari a.s., ka thënë: “Agjërimi i muajit të durimit, dhe i tri ditëve të çdo muaji largojnë zemrën nga egoizmi dhe të ligat.”¹¹ Ky hadith thekson se agjërimi nuk ka vetëm një efekt fizik ose ritual, por shërben si një mjet për zhvillimin e vetëdisiplinës dhe rritjen e shpirtit moral dhe psikologjik, duke reduktuar ndikimet negative mbi karakterin dhe sjelljet e individit. Ai nxit durimin, vetëkontrollin dhe pastrimin e brendshëm të shpirtit, duke e orientuar njeriun drejt një jetese më etike dhe të qëndrueshme shpirtërore dhe psikologjike.

Empatia dhe dimensionin social

Agjërimi kontribuon në zhvillimin e empatisë dhe përgjegjesisë sociale duke e ekspozuar individin ndaj përvojës së drejtpërdrejtë të privimit fizik, si uria dhe etja. Kjo përvojë e vetëdijshme rrit ndjeshmërinë ndaj gjendjes së të tjerëve, veçanërisht ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, duke nxitur reflektim moral dhe zvogëluar prirjet egoiste. Përmes vetëpërmbajtjes, agjërimit formëson një karakter altruist dhe forcon solidaritetin shoqëror. Në këtë kontekst, i Dërguari i Allahut a.s., e ka theksuar qartë dimensionin social dhe solidar të Ramazanit përmes obligimit të sadekatul fitrit. Ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se: “I Dërguari i Allahut e bëri obligim sadekatul fitrin në Ramazan...”¹²

Ky obligim synon jo vetëm pastrimin shpirtëror të agjëruesit, por edhe forcimin e solidaritetit shoqëror, duke siguruar që edhe shtresat në nevojë të marrin pjesë me dinjitet në gëzimin e Bajramit. Në këtë mënyrë, Ramazani nuk mbetet një përvojë individuale e përmbajtjes, por shndërrohet në një projekt kolektiv të përkrahjes, ndjeshmërisë dhe përgjegjesisë sociale. Ai shndërrohet në një mjet edukativ që orienton individin drejt sjelljeve më të kujdesshme, më të drejta dhe më të përgjegjshme në marrëdhëniet shoqërore dhe etike.

Dimensionin transcendent dhe integrimi shpirtëror

Agjërimi harmonizon trupin, mendjen dhe shpirtin, duke i orientuar individët drejt përgjegjesisë morale për rolin e tyre para Zotit. Hadithi i Pejgamberit a.s. thotë: “Agjërimi është mburojë; prandaj kur dikush prej jush agjëron, le të mos flasë fjalë të turpshme, as të ngrejë zërin; e nëse dikush e ofendon, le të thotë: ‘Unë agjëroj.’”¹³

Ky hadith nënvizon se agjërimi është një mjet për vetëkontroll moral, reflektim shpirtëror dhe transformim të qëndrueshëm të personalitetit, gjë që përforcohet edhe nga



fjala profetike: “Vërtet, besimtari me moralin e tij të mirë arrin gradat e atij që falet natën dhe agjëron ditën”¹⁴, e cila tregon se besimtari, përmes edukatës së lartë, moralit dhe mirësjelljes që kultivon vazhdimisht, e veçanërisht përmes agjërimin, arrin gradat më të larta shpirtërore, duke e bërë këtë karakter një cilësi të përhershme të jetës së tij.

PSE NDËRPRITET EFEKTI I RAMAZANIT PAS PËRFUNDIMIT TË TIJ?

Një nga sfidat më të dukshme pas përfundimit të Ramazanit është se shumë besimtarë e përjetojnë këtë muaj si një periudhë të veçuar nga pjesa tjetër e vitit, duke mos e integruar atë në procesin e vazhdueshëm të vetëformimit dhe zhvillimit shpirtëror. Kjo qasje e kufizon ndikimin e tij, duke e bërë transformimin shpirtëror dhe moral të përkohshëm dhe jo të qëndrueshëm.

Diskursi fetar shpesh përqendrohet te shpërblimi për agjërimin, siç thotë Allahu i Lartësuar: “*Kush i përgjigjet Allahut me përlësi dhe besim, atëherë shpërblimi i tij është te Zoti i tij.*” (El Bekare, 112).

Ky fokus shpesh nxit një perceptim të Ramazanit si një periudhë shpërblyese e veçuar, pa u marrë parasysh nevoja për vazhdimësi në praktikën e virtyteve të zhvilluara gjatë muajit.

Për më tepër, mungesa e një metodologjie edukative, që shoqëron individin pas përfundimit të muajit, bën që transformimi shpirtëror të mbetet i papërfunduar. Hadithi i Pejgamberit a.s. nënvizon rëndësinë e qëndrueshmërisë në veprimet e mira: “Vërtet, ato veprime që janë të qëndrueshme, edhe nëse janë të vogla, janë më të dashura për Allahun.”¹⁵

Ky hadith tregon se ajo që ka vlerë është praktika e vazhdueshme e sjelljeve morale dhe fetare, jo vetëm përvoja intensive e një periudhe të shkurtër.

Fikhu i transformimit e sheh agjërimin dhe Ramazanin si pikënisje të një procesi të vazhdueshëm edukativ, ku reflektimi, vetëdisiplina dhe vetëkontrolli duhet të shndërrohen në zakone dhe praktika të përditshme. Në këtë mënyrë, njeriu arrin të realizojë kuptimin e vërtetë të robërisë ndaj Allahut të Lartësuar, duke u pajisur me një etikë të lartë njerëzore dhe shpirtërore, e cila reflektohet në sjelljen e tij individuale dhe shoqërore. Këta janë robërit e të Gjithëmëshirshmit për të cilët Kurani thotë: “*Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin me përlësi nëpër Tokë dhe, kur të paditurit u drejtohen me fjalë të ashpra, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’*” (El Furkan, 63).

Ky nivel i edukimit moral dhe vetëdijes shpirtërore e afron njeriun me Zotin e tij, duke e vendosur në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe të gjallë me Të. Prandaj, ata që i drejtohen Allahut me lutje e gjejnë Atë pranë tyre, ashtu siç është shpallur në fjalën e Tij: “*E kur robërit e Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër; i përgjigjem lutjes së lutësit kur ai më lutet.*” (El Bekare, 186).

Kështu, agjërimi dhe edukimi që ai prodhon nuk përfundojnë në përmbajtjen formale, por kulmojnë në

ndërtimin e një njeriu të ndërgjegjshëm, etikisht të formuar dhe shpirtërisht të afërt me Zotin, duke mishëruar në jetë vlerat e mëshirës, përlësisë dhe paqes.

Në këtë kuptim, ndërprerja e efektit të Ramazanit nuk është një dështim i muajit në vetvete, por pasojë e mungesës së ndërgjegjësimit për vazhdimësinë dhe përkthimit praktik të virtyteve të fituara në jetën e përditshme. Një qasje e tillë kërkon planifikim, reflektim dhe angazhim të qëndrueshëm, duke e bërë agjërimin dhe Ramazanin jo vetëm një përvojë periodike, por një mjet transformimi të qëndrueshëm moral, shpirtëror dhe shoqëror.

PËRFUNDIMI

Agjërimi nuk është qëllim në vetvete, por mjet për formimin e njeriut. Kufizimi i tij në përmbajtje fizike e zhvesh nga fuqia e tij transformuese dhe e redukton në ritual sezonal. Kalimi nga përmbajtja te transformimi përfaqëson një nevojë të domosdoshme për njeriun bashkëkohor, i cili përballet me krizë kuptimi dhe fragmentim të brendshëm.

Vetëm duke e kuptuar Ramazanin si projekt formimi dhe jo si detyrim kalendarik, agjërimi mund të shndërrohet në mjet real për rindërtimin e individit dhe shoqërisë.

- 1 Muhamed ibën ebi Bekr er Razi, Muhtar es Sihah, (Mektebet Lubnan, 1989), f. 328, لَئِمَّةٌ صَوْمٍ. El Fejruzabadi, El kamus el Muhit, (rec. Enes Muhamed esh Shami dhe Zekerija Xhabir Ahmed, Dar el Hadith, Kajro, 2008), f. 958.
- 2 Muhamed ibën ebi Bekr er Razi, *Muhtar es Sihah*, po aty, f. 328.
- 3 El Mevsili, Abdullah bin Mahmud, *El Ihtijar li ta' lil el Muhtar*, (rec. Mahmud abu Dekika, Dar el Kutub el Ilmije, Bejrut-Liban), 1/125. El Xhurxhani, *Et Ta'rifat*, (rec. Ibrahim el Ebjari, Dar er Rejjan li et Turath), f. 178.
- 4 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, (Dar et-Ta'sil, bot. 1, 2012), Kitab es Savm, 3/75, nr. 1914.
- 5 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab es Savm, 3/70, nr. 1905.
- 6 Ahmed b. Hanbel, *El Musned*, (rec. Shuajb Arnauti dhe Ibrahim ez Zejbek, bot. 1, Muesseset er Risale 1999), 26/202, nr. 16273, dhe të tjerë.
- 7 Po aty.
- 8 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab es Savm, 3/75, nr. 1914.
- 9 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab es Savm, 3/74, nr. 1912.
- 10 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab es Savm, 3/75, nr. 1915.
- 11 Ebu Xhafer et Tahavi, *Sherh Meani el Athar*, (rec. Dr. Jusuf Abdurrahman, bot. 1, Alem el Kutub 1994), Kitab vuxhuh el fej' ve hums el ganaim, 3/303, nr. 5429. Ahmed b. Hanbel, *El Musned*, po aty, 34/342, nr. 20738.
- 12 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab ez Zekat, 2/367-368, nr. 1516 dhe 1520.
- 13 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, Kitab es Savm, 3/70, nr. 1905.
- 14 Ahmed b. Hanbel, *El Musned*, po aty, 40/414, nr. 24355.
- 15 Muhamed b. Ismail, *Sahih el Buhari*, po aty, kapitulli: El kasd ve el Mudavemetu ala el Amel, ٤٧٢/٨, nr. ٣٧٤٧.

Agjëroni, do të jeni të shëndetshëm!*

Ismail Haveriq

“Çdo gjë ka diçka që e pastron atë. Ajo që e pastron trupin është agjërimi, dhe ai është gjysma e durimit.” (Ibën Maxhe).

Të gjitha ibadetet në Islam kanë qëllimin dhe synimin e tyre, pavarësisht nëse ne e njohim apo jo këtë synim. Ashtu siç Allahu i Lartësuar nuk ka krijuar asgjë pa qëllim, po ashtu Ai nuk ka caktuar asgjë pa qëllim. Çdo ibadet i urdhëruar në Islam ka të paktën dy aspekte: i pari është rregullimi i marrëdhënies sonë me Allahun e Lartësuar, dhe i dyti është përmirësimi i marrëdhënies tona me njëri-tjetrin. Sigurisht, Allahut të Lartësuar nuk i duhet ibadeti ynë, por ibadeti i duhet vetëm për veten tonë. Agjërimi i Ramazanit është një shkollë unike e rregullimit dhe rigjallërimit të cilësive morale dhe shëndetit të njeriut, në të cilën mësojmë si t'i frenojmë dhe t'i mposhtim epshet tona dhe si ta ruajmë e ta përmirësojmë shëndetin. Zbulimet bashkëkohore të ekspertëve të mjekësisë sot, konfirmojnë se agjërimi ndikon pozitivisht në shëndetin e njeriut. Ne, myslimanëve, na ka mësuar këtë mësuesi ynë, Muhamedi a.s., i cili ka thënë: “Agjëroni, do të jeni të shëndetshëm!” (Et Taberani).

Qëllimi themelor i agjëritit të Ramazanit është ta fisnikërojë zemrën dhe shpirtin, ta zgjojë vetëdijen e njeriut, por edhe të jetë ilaç për shumë sëmundje. Agjërimi është ilaç kundër sëmundjeve bashkëkohore të ngrënies së tepërt dhe obezitetit.

Muhamedi a.s., ka thënë: “Më së shumti në umetin tim frikësohem nga barqet e mëdha, përtacia dhe gjumi i gjatë.” Pastaj ka thënë: “Stomaku i mbushur është ena më e keqe.”

Nga aspekti shëndetësor, agjërimi i Ramazanit ka dy komponente: komponentën shpirtërore-mentale-psikike dhe komponentën somatike ose fizike.

AGJËRIMI DHE SHËNDETI SHPIRTËROR

Nga aspekti i shëndetit shpirtëror, agjërimi frenon kërkesat dhe pasionet e shpirtit, si dhe nxit kthjelltësinë mendore. Me agjërim forcojmë vullnetin dhe mësohemi me durimin. Agjëruesi duron urinë edhe kur përpara tij ka ushqime të shijshme, duron etjen edhe kur para tij ndodhet një limonadë e ftohtë, dhe në këtë e ndihmon vullneti i fortë. Agjërimi e çon njeriun drejt qetësisë dhe krijon dhe akumulon potencial





të ri psikik për t'u përballur me situatat stresuese të përditshme.

Agjërimi i Ramazanit paraqet një lloj psikoterapie. Psikoterapeuti dr. Martin Kojc, në librin e tij ka shkruar: "Agjërimi mundëson transformimin shpirtëror të njeriut, sepse e çliron atë nga lidhjet e imagjinuara materiale dhe kontribuon që njeriu të jetojë në harmoni me sferat shpirtërore."

Agjërimi i Ramazanit ndikon në forcimin e vullnetit të agjëruesit, e aftëson atë të kontrollojë dhe të sundojë pasionet e tij, forcon përkushtimin dhe zhvillon ndjenjën e disiplinës. Agjërimi, si metodë edukimi në zhvillimin e vetëpërmbytjes, të durimit dhe të qëndrueshmërisë, intensifikon mendimin e agjëruesit për Krijuesin dhe begatitë e Tij, për fuqinë dhe mëshirën e Tij ndaj besimtarëve. Agjërimi forcon dhe e kalit karakterin e agjëruesit, forcon shpirtin dhe vullnetin e tij..."

Agjërimi i Ramazanit ndikon pozitivisht edhe në shërimin e cilësive karakterit të agjëruesit. Ai përmbahet nga gënjeshtria, përgojimi, shpifja, zilia, kurdisja e planeve armiqësore, gjë që përmirëson marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe zhvillon forca kohezive që forcojnë lidhjet familjare, fqinjësore dhe lidhjet mes xhematit, dhe sjell në qetësimin ose ndërprerjen e konflikteve, sepse shejtanët e mallkuar janë të lidhur gjatë Ramazanit dhe ndikimi i tyre te njerëzit është i zvogëluar.

Megjithatë, edhe agjërimi më i ashpër nuk sjell sukses të qëndrueshëm nëse njëkohësisht shpirti i njeriut nuk është i drejtuar drejt suksesit dhe shërimit. Edhe po të pastrohej trupi plotësisht nga materiet e dëmshme, shkaktari i

sëmundjes nuk do të largohet nëse mbetet të sundonte qëndrimin e gabuar shpirtëror.

- Agjërimi i Ramazanit ka edhe aspekt social, sepse kujtojmë dhe bashkëndejmë me të gjithë të munduarit, të uriturit dhe të lodhurit, duke ndarë të njëjtat ndjenja me ta. Agjërimi e zbut zemrën e të pasurve dhe i nxit t'i ndihmojnë dhe t'u japin sadaka të varfërve dhe nevojtarëve.

AGJËRIMI DHE SHËNDETI FIZIK

Shëndeti është mirëqenie fizike, psikike dhe sociale, e jo vetëm mungesë e sëmundjes ose e dobësisë. Shëndeti është pasuria më e madhe e kësaj bote dhe një nga begatitë më të mëdha, që i janë dhuruar njeriut. Ai të cilit i është dhënë shëndet në trup dhe shpirt ka mundësi të mësojë, të punojë, të jetë i qëndrueshëm dhe të luftojë për fenë, familjen, pasurinë dhe atdheun e tij. Një i tillë mund t'i kryejë detyrat e kësaj bote në mënyrën më të mirë, ndërsa i sëmuri nuk është i aftë për këtë.

PËRFITIMET E AGJËRIMIT PËR SHËNDETI E NJERIUT

Nga aspekti i komponentës somatike ose fizike të agjërimit dhe ndikimit të tij në shëndetin fizik të agjëruesit, duhet të nisemi nga fakti se agjërimi është i destinuar për njerëzit e shëndetshëm dhe rekomandohet për ta.

Shkencëtarët pajtohen se, falë agjërimit, trupi drejton energjinë nga tretja e ushqimit drejt aktiviteteve të tjera të rëndësishme: shërimit të plagëve, punës intelektuale dhe luftimit të sëmundjeve.

Nga aspekti fizik, agjërimi ul sasinë e indit dhjamos, zvogëlon sipërfaqen ku depozitohen substancat toksike lipofile, të cilat në ushqimin e njeriut modern janë shumë të pranishme (ilaçe, pesticide, ushqim i përpunuar, konservues, ngjyra, etj.), dhe që shpesh janë shkaktarë të sëmundjeve malinje dhe të tjera. Ulet niveli i yndyrave në gjak, kolesterolit dhe triglicerideve, të cilat janë faktorët kryesorë të rrezikut për arterosklerozën – sëmundje e enëve të gjakut që paraqet shkaku për shfaqjen e infarktut, si atij të zemrës ashtu edhe të trurit. Gjatë agjërimit, kursen forcën e muskullit të zemrës, pasi ai nuk ka nevojë të pompojë gjakun përmes një rrjeti të madh kapilarësh në zorrë, të cilat, kanë sipërfaqe rreth 250 m².

Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha lëndët ushqyese të përthithura nga gjaku nga këto zgjatime të zorrëve tani shkojnë në mëlçi, e cila me hapësirat e saj të imëta të gjakut i përpunon këto substanca, duke përfaqësuar një fazë aktive të punës së mëlçisë.

Pushimi nga ushqimi dhe pijet gjatë agjërimit i sjell organizmit dobi të mëdha. Zemra gjatë agjërimit kursen rreth 14.000 rrahje brenda 24 orëve, çka ndikon pozitivisht në funksionimin e saj dhe përmirëson aftësitë intelektuale të agjëruesit. Shikimi mprehtësohet dhe pas agjërimit, njeriu sheh dy herë më mirë sesa para agjërimit.

Agjërimi është mënyra më e fuqishme për të përmirësuar autofagjinë në trup. Rezultate të shkëlqyera të agjërimit janë tretja e yndyrës dhe përmirësimi i qartësisë mendore. Për t'i bërë këto gjëra, trupi duhet të arrijë një gjendje autofagjie – metoda natyrore e trupit për t'u detoksuar. Autofagjia shthur organelet të dëmtuara, membranat qelizore dhe proteinat, dhe konsiderohet që autofagjia e pamjaftueshme është një nga arsyt kryesore për grumbullimin e qelizave të dëmtuara dhe plakjen. Autofagjia është mekanizëm i vetëruajtjes, me të cilin trupi mund të hejë qelizat jofunksionale, të dëmtuara dhe të sëmura dhe vepron në atë mënyrë që riciklon këto qeliza dhe pastron trupin nga toksinat. Drejtuesit kryesor të autofagjisë janë stresorët qelizorë siç është privimi i ushqyesve i sjellë nga mekanizma të ndryshëm, përfshirë agjërimin,



stërvitjen dhe ndryshimin e ndjeshëm të temperaturës, që makineria e ndërlikuar qelizore të mbetet në funksion, duhet të sigurohet që mbetjet, mbeturinat dhe qelizës të riciklohen. Kjo është pikërisht ajo që arrihet me autofagji. Shkencërisht është vërtetuar se, procesi i autofagjisë e ndihmon qelizën që të lirojë mbetjet, regjenerojë trupin, e kalimthi humben edhe kilogramët.

Gjatë agjërimit, funksionet e të gjitha organeve janë të zvogëluar. Organizmi praktikisht pushon, duke mbuluar energjinë e harxhuar nga rezervat. Stomaku pushon, qarkullimi i gjakut shpërndahet në mënyrë të rregullt, dhe kështu edhe truri merr sasinë e duhur të gjakut, sepse organet e tretjes nuk "vjedhin" më shumë gjak se sa kanë nevojë. Truri punon logjikisht, mendimet burojnë normalisht dhe arsyetimi është i kthjellët. Pasioneve u bie intensiteti dhe nxitjet i lënë vend arsyes. Natyra është kujdesur që sistemin e pastrimit dhe shtresimit të ndotjeve në organizëm të vihet në rregull, të kryejë një "rindërtim" të forcave të trupit. Me anë të agjërimit, organizmi detyrohet t'i përvishet këtij procesi.

*Marrë nga: <https://www.preporod.com/index.php/duhovnost/tradicija/item/3372-postite-bit-cete-zdravi>

Përktheu nga gjuha boshnjake: Shaban Basha

Pushimi nga ushqimi dhe pijet gjatë agjërimit i sjell organizmit dobi të mëdha. Zemra gjatë agjërimit kursen rreth 14.000 rrahje brenda 24 orëve, çka ndikon pozitivisht në funksionimin e saj dhe përmirëson aftësitë intelektuale të agjëruesit.

Namazi i teravive

Shjeh Vehbi Sulejman Gavoqi¹

Falja e namazit të teravive është sunet, prej suneteve të forta të Pejgamberit a.s., për burra dhe gra. Ky namaz është quajtur “teravi”, për shkak se në fund të çdo katër rekateve, bëhet pushim. Ibni Nuxhejmi në “El Bahr”, ka thënë: “Termi teravih është shumës i fjalës “tervihetun”, që është paskajore dhe që domethënë pushim-freskim.”

Ebu Hurejra r.a., transmeton se Pejgamberi a.s., i nxiste shokët e tij për faljen e namazit të teravive duke mos i urdhëruar prerazi (si obligative), dhe thoshte: “Kush falë namaz (natën) në Ramazan, me besim të plotë dhe me shpresë për shpërblim te Zoti, do t’i falen mëkatet (e vogla) të mëparshme.”

Ibën Shehabi ka thënë: “Ka vdekur Pejgamberi a.s. dhe çështja ka mbetur kështu edhe në kohën e Ebu Bekrit, dhe ka dalë në kohë të Omerit r.a.”²

Namazi i teravive quhet “kijamu-ramadan” dhe këtu nuk është fjala assesi për namazin e preferuar të natës gjatë ditëve të tjera të vitit, që e zbatonte Pejgamberi a.s., dhe i cili gjithashtu është një simbol i njerëzve të mirë dhe sidomos i atyre që janë të devotshëm.

Allahu xh.sh., duke i cilësuar ata, thotë: “*Ata qenë të cilët natën flinin pak. Dhe në syfy (nga mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet.*” (Edh Dharijat, 17-18).

“Kush falë namaz (natën) në Ramazan, me besim të plotë dhe me shpresë për shpërblim te Zoti, do t’i falen mëkatet (e vogla) të mëparshme.”

El Kermani (njëri prej komentuesve të Sahihut të Buhariut), ka thënë: “Dijetarët janë pajtuar se qëllimi (kuptimi) i “kijamu-ramadan” është namazi i teravive, dhe në këtë është bazuar Neveviu dhe të tjerët. Kurse El Baxhi el Malikij, ka thënë: “Gjithsesi ky namaz është i veçantë në Ramazan, dhe po të ishte namaz që përfshin tërë vitin, nuk do të ishte veçuar për Ramazanin dhe as që do të ishte quajtur kijamu-ramadan”. Kurse në “El Iknaë”, medhhebi hanbeli, kanë pëlqyer se qëllimi në thënien e Pejgamberit a.s. “men kame Ramadan - Kush bën ibadet në Ramazan”, është namazi i teravive.

Namazi i teravive përbëhet prej 20 rekatesh, ashtu si ishte vendosur në kohën e kalifatit të Omerit r.a. Pejgamberi a.s. namazin e teravive në xhemat e fali dy net, e pastaj nuk doli për ta falur me njerëz, dhe njerëzit vazhduan të faleshin në grupe të vogla, derisa i bashkoi emirul Muminin, Omeri r.a., me një imam për burra dhe me një tjetër imam për gra. Në fillim i falën me 8 rekate, ndërsa më vonë me 20 rekate; këtë traditë e vazhduan dy kalifët e ardhshëm pas tij dhe mbarë myslimanët e botës në Lindje dhe në Perëndim, deri më sot, dhe do të vazhdojë derisa të dëshirojë i Madhi Zot xh.sh..



Transmeton Aisheja r.a., se Muhamedi a.s., ka dalë për t'u falur në xhami, e me të u falën edhe një grup njerëzish; në natën e dytë u tubuan edhe më shumë njerëz dhe u falën pas tij; në natën e tretë në xhami u tubuan edhe më shumë njerëz, po Pejgamberi a.s. nuk doli për t'i falur *teravitë*, por doli pak para namazit të sabahut, dhe iu drejtua xhematit me këto fjalë: “E kam parë atë që keni bërë (mbrëmë në xhami) dhe mua nuk më pengoi gjë tjetër që të dilja te ju, përveçse u frikësova se mos po u bëhet ai (namazi i *teravive* në Ramazan) farz-obligim.”³

Abdurrahman ibën Ubejdi, ka thënë: “Dola me Omerin r.a. një natë Ramazani⁴ në xhami dhe njerëzit ishin të shpërndarë, dikush prej tyre falej vetë, dikush falej e pas tij faleshin një grup njerëzish. Omeri r.a., tha: “Për Zotin, po më duket, sikur t'i tuboja këta njerëz pas një imami, do të ishte më mirë.” Pastaj i tuboi (të faleshin prapa) Ubej ibën Kabit. Kur kemi dalë një natë tjetër, njerëzit faleshin me imam, e Omeri atëherë tha: “Sa bidat⁵-risi e mirë qenka kjo..”⁶

Transmeton Es Saib ibën Jezidi, se Omer ibën Hatabi, e ka udhëzuar Ubej ibën Kabin dhe Temim ed Dariun që të falnin me njerëz nga 11 rekate, dhe ka thënë se lexuesit kanë lexuar (në namaz të *teravive*) aq gjatë, saqë kishim nevojë të mbështeteshim në shkopinj për shkak të qëndrimit të gjatë, dhe nuk jemi shpërndarë deri para agimit të mëngjesit.”⁷

Ibën Abdulberri ka thënë: “Këtë hadith, përveç Malikut, e transmetojnë me 21 rekate dhe ky hadith është i kategorisë sahih (i vërtetë), dhe nuk e di që ka thënë dikush 11 rekate, përveç Malikut. Mund të jetë që kjo me 11 rekate ka qenë në fillim (ditët e para), dhe kur ka filluar shkurtimi i qëndrimit

(leximit të Kuranit) në namaz të *teravive*, ka kaluar në 21 rekate...”

Ndërsa Esh Sharanij, në librin “*Keshful Gumme*”, citon: “Në fillim të kohës së Omerit r.a. po faleshin nga 13 rekate, mandej Omeri r.a. porositi që të faleshin nga 23 rekate, tri prej tyre *vitër*, dhe çështja u vendos me këtë numër.”⁸

El Kastalanij, në “*Sherh el Buharij*”, ka thënë: “Bejhakui u bashkoi këto dy çështje: Ata në fillim falnin nga 11 rekate, mandej patën falur nga 20 rekate dhe 3 *vitër*, dhe atë që kishte ndodhur në kohën e Omerit r.a., e konsideruan si *ixhma* - koncensus të dijetarëve.”⁹

Sejid ibën Ubejdi, transmeton se Alij ibën Rebiah, së bashku me ta, në Ramazan, falte 5 herë nga katër rekate (gjithsej 20 rekate) dhe e mbyllte me tri rekate *vitër*.¹⁰

Ebi Abdurrahman es Semij, transmeton se Aliu r.a., i thërriste *kurratë* (lexuesit e Kuranit) në Ramazan dhe urdhëronte njërin prej tyre për faljen e *teravive* 20 rekate, ndërsa Aliu r.a. ua falte *namazin vitër*.¹¹

Ndërsa Urfexhetu eth Thekafij ka thënë: “Aliu r.a. i porosiste njerëzit për faljen e *teravive* në Ramazan dhe cakonte një imam për burra dhe një imam tjetër për gra. Unë isha imam i grave.”¹²

Ebu Jusufi ka thënë: “E kam pyetur Ebu Hanifen për teravi dhe për atë që bëri h. Omeri, e ai (Ebu Hanifa), ka thënë: “Teravitë janë sunet muekkede: dhe atë që ka bërë Omeri nuk e bëri vetvetiu dhe as që ka shpikur risi (në fe), dhe nuk e ka praktikuar atë përveçse duke pasur bazë dhe argument nga Pejgamberi a.s..”

Dijetari i famshëm Muhamed Jusuf el Benuri, ka thënë: “Kjo fjalë e Ebu Hanifes është përfundimtare, saqë shpirti pushon në të, ka arritur përfundim me saktësi dhe vërtetësi. Ebu Hanifes iu zbuluan shumë prej çështjeve të fikut, që për dijetarët e tjerë ishin të panjohura. Allahu qoftë i kënaqur me të dhe e mëshiroftë! Fjala e Ebu Hanifes tregon se ka mundësi që Omeri r.a. kishte argument nga Pejgamberi a.s.. Atëherë falja e 20 rekateve *teravi* ka argument *merfu`* të përcjellë (prej sahabëve nga Pejgamberi a.s.), edhe pse nuk është përcjellë deri te ne me një transmetim të fortë.”¹³

Në librin “*El Mugni*”, libër i medhhebit hanbeli, thuhet: “*Namaz* i *teravive* i muajit Ramazan është 20 rekate, këtë namaz së pari e ka filluar-bërë traditë Pejgamberi a.s.” Pastaj thuhet: “Tek Ahmed ibën Hanbeli është i preferuar numri 20 i rekateve *teravi*, këtë numër e mbështetin edhe Thevriu, Ebu Hanife dhe Shafu, kurse Maliku thotë se numri i *teravive* është 36 rekate.” Më pas thuhet: “Nga kjo mësohet se me të vërtetë asnjëri prej katër imamëve të medhhebeve në mendimet e tyre, nuk kanë thënë numër më të vogël se 20 rekate *teravi*.”¹⁴

Ndërsa shejh El Benuri ka thënë: “Argumentet e shumicës dërrmuese të dijetarëve për 20 rekate *teravi*, janë marrë prej traditës (sunetit) të Omerit r.a..”

Në librin “*Merakil felah*” të medhhebit hanefi, thuhet: “Vërtetimi i 20 rekateve të *teravive* është bërë në bazë të veprimit të *hulefai rashidinëve* (Omerit, Othmanit e Aliut) me përjashtim të Ebu Bekrit r.a..”

Shejh Muhamed Zekerija, ka thënë: “Pa dyshim, caktimi i 20 rekateve nuk është vërtetuar me transmetim *merfu*, që arrin te Pejgamberi a.s., ose me rrugë të drejtë në burimet e muhadithëve. Ndërsa, për sa i përket transmetimit të Ibni Abasit (se Pejgamberi a.s. ka falur 20 rekate *teravi*), kjo flet për burimet e tyre, por nuk mund t’i mohohet vërtetësia e tij. Andaj veprimi i Omerit dhe heshtja e sahabëve në këtë çështje, dhe bashkimi i tyre e pranimit i 20 rekateve *teravi*, radhitet në shkallën e argumentit, për shkak të kësaj baze që ka për ta.”

Kush u hedh një shikim veprimeve të sahabëve në lidhje me çështjet e Sheriatit, nuk dyshon se ata në çdo rast, kur vërenin ndonjë çështje të urryer, e kundërshtonin shumë.

Me një fjalë, ato janë traditë e Pejgamberit a.s., që na i ka porositur t’i veprojmë. Si jo kur Pejgamberi a.s., ka thënë: “Ju porosis t’i përmbaheni traditës (rrugës, sunetit) sime dhe

“Numri i 20 rekateve *teravi* është çështje e vërtetuar dhe e përcaktuar, dhe i popullarizuar prej sahabëve, tabiinëve dhe atyre që pasuan rrugën dhe traditën e tyre.”

traditës së *hulefai rashidinëve* pas meje (fjala është për Ebu Bekrin, Omerin, Othmanin dhe Aliun r.a., që kanë sunduar pas tij).”

Hafidhi transmeton prej Imam Ahmed ibën Hanbelit, të ketë thënë: “Ajo që ndodh prej *hulefai rashidinëve*, është sunet, e ajo që ndodh prej sahabëve të tjerë, për atë që thonë se është prej suneteve, nuk e refuzoj.” Është transmetuar se: “Allahu xh.sh. e ka bërë të vërtetën në gjuhën e Omerit dhe në zemrën e tij.” Sujutiu e ka cekur këtë në transmetimin e Ahmedit dhe Tirmidhiu nga Ibën Omeri e me transmetimin e Ahmedit, Ebu Davudit dhe Hakimit prej Ebu Dherrit, dhe me transmetimin e Ebu Jaëlas dhe të Hakimit nga Ebu Hurejre,... pastaj ka thënë: “Numri i 20 rekateve *teravi* është çështje e vërtetuar dhe e përcaktuar, dhe i popullarizuar prej sahabëve, tabiinëve dhe atyre që pasuan rrugën dhe traditën e tyre.”

Në librin “*Keshful Gummeh*”, autori i të cilit është Sharani nga medhhebi shafi, thuhet: “Pastaj Omeri r.a. urdhëroi që të falen 23 rekate *teravi*, tri prej tyre *vitër*, dhe çështja e numrit të *teravive* u vendos në bazë të kësaj.”¹⁵

Shejh Muhamed Jusuf el Benuri, në një fjalë ka thënë: “Veprimin e Omerit r.a. umeti e priti me pranim, caktimi i numrit të *teravive* u vendos në vitin e dytë të sundimit të tij.”

Ibni Seadi, në librin e “*Et Tabakat*” 202-3, ka thënë: “Ai është i pari që bëri traditë faljen e *teravive* në Ramazan dhe i tuboi njerëzit në to (pas një imami) e për këtë u shkroi edhe qyteteve të tjera, e tërë kjo ndodhi në Ramazanin e vitit 14 hixhri.”¹⁶

DEMANTIMI I DYSHIMEVE ME TË VËRTETA

Aisheja r.a., ka thënë se Pejgamberi a.s. nuk ka falur më shumë se 11 rekate as në Ramazan dhe as jashtë tij. “Një herë i falte katër rekate, mos pyet për rregullin dhe gjatësinë e tyre, pastaj katër të tjera, njësoj si katër rekatet e para, me rregullën dhe me gjatësinë e tyre, pastaj i ka falur tri rekate.”

Autori i broshurës “*Et Teravivih*”, ka thënë: “Shembulli i atij që shton më tepër se 13 rekate në *teravi*, është sikur ai që e fal namazin në kundërshtim me atë të Pejgamberit a.s. për nga numri dhe mënyra duke harruar porosinë e tij: “Faluni ashtu siç më keni parë mua.” Fjala vjen si ai që e fal farzin e drekës me pesë rekate dhe sunetin e sabahut me katër rekate...”

Muhadithi Ismail el Ensarij ka thënë: “Përgjigjja ndaj hadithit të Aishes r.a., se Pejgamberi a.s., nuk ka shtuar më shumë se 11 rekate në Ramazan dhe jashtë Ramazanit, është se ky hadith nuk argumenton ndalimin për të mos shtuar



rekate as në Ramazan dhe as jashtë tij.” Gjithashtu El Hafidh ibën el Irakij në *“Tarhut tethrib”* ka thënë: “Dijetarët janë në ujdi se namazi i natës nuk ka kufi të caktuar, por transmetimet kanë ndryshuar në varësi nga veprimi i Muhamedit a.s..”

El Kadij ka thënë: “Dijetarët, këto hadithe i llogarisin lajme të secilit transmetues, si Ibni Abasit, Zejdit, Aishes, në varësi se çfarë kanë dëshmuar.” Ai vazhdon dhe thotë: “Nuk dyshohet fare se nuk ka numër të caktuar rekatesh, që nuk shtohet as nuk pakësohet, dhe që namazi i natës është ibadet-adhurim, dhe sa më shumë që shtohet, aq më tepër edhe shpërblehet, mirëpo dallimet janë në vetë veprimin e Pejgamberit a.s., çfarë kishte zgjedhur për vetveten e tij. Allahu i di më së miri.” Këtë mendim të Kadiut e ka përcjellë dhe pëlqyer edhe En Neveviu.

Ndërsa shejh Shebir Ahmed el Uthmanij, në librin *“Fet`hul mulhim sherh sahih muslim”*, ka thënë: “Pejgamberi a.s. nuk e ka caktuar numrin e rekateve, i cili nuk bën të kalohet. Kjo argumentohet me fjalën e përgjithshme të Pejgamberit a.s.: “Namazi i natës 2 nga 2 rekate” apo me hadithin: “Namazi është gjëja më e mirë, e kush ka mundësi, le të shtojë namazin (le të falë sa më tepër namaz).” Këtë e transmeton Taberaniu në *“El Evsat”* nga Ebu Hurejre.

Ibën Tejmije, në pjesën e parë të librit të tij *“El Fetava”* (f. 191), vërteton se Ubej ibën Kabi falte nga 20 rekate *teravi* në Ramazan, e mandej i falte edhe tri rekate *vitër*. Shumë prej dijetarëve këtë e konsiderojnë sunet, duke pasur parasysh se ai veproi në mesin dhe praninë e muhaxhirëve dhe të ensarëve dhe askush prej tyre nuk e kundërshtoi dhe as mohoi. Ndërsa të tjerët e llogaritën mustehab për t’i falur 39 rekate *teravi*, me gjithë *salati-vitër*, duke u mbështetur në veprimin e hershëm të popullit të Medinës.

Ubej ibën Kabi, kur fali *teravitë*, e ata ishin me një grup dhe nuk kishte mundësi të zgjaste namazin e *teravive*, atëherë i

shtoi rekartet për të zëvendësuar gjatësinë e namazit. Ky ishte shkaku i shtimit të rekateve, duke e ditur se ai më parë kishte falur 11 apo 13 rekate, e kur njerëzit pas kësaj kohe në Medinë u dobësuan nga gjatësia e qëndrimit në namaz, u shtua numri i rekateve të *teravive* derisa arrit në 39 rekate.

Transmeton Imam el Hafidh el Bejhekiu në *“Es Sunen el Kubra”*, në kreun ku flitet për numrin e rekateve të *teravive* në Ramazan, 496/2, dhe thotë: “Na ka lajmëruar Ebu Abdullah el Husejn ibën Muhamed ibën el Hysejn ibën Fenxhevih el Dejnurij në Ed Damigan, na ka thënë Ahmed ibën Muhamed Is’hak es Sunnij, nga Abdullah ibën Abdulaziz el Begavi, nga Ali ibën el Xhevad nga Ibën ebi Dhiëb nga Jezid ibën Husajfe prej Saib ibën Jezidit, i cili ka thënë: “Në kohën e Omer ibën Hatabit, në Ramazan i kanë falur nga 20 rekate *teravi*.”

Këtë hadith e ka vërtetuar Neveviu në librin e tij *“El Hulase”* dhe në librin *“El Mexhmua”*. E ka pëlqyer Zejleiu në librin *“Nasbu err Rajeti”* dhe e vërtetoi Es Subkij në *“Sherh el Minhaxh”*, gjithashtu Ibën Irakij në *“Tarh et Tethrijb”* e vërtetoi El Ajni në *“Umdetu el Kariu”*, gjithashtu Sujutiu në librin *“El mesabih fi salati et teravivih”* dhe Ali el Karij në *“Sherh el Muveta”* dhe En Nimevij në *“Athar es Sunen”* dhe të tjerë.

Përkundër tërë kësaj, Nasirudin Albani në broshurën e tij për *teravitë* e mohon dhe nuk pranon shtimin mbi 11 rekate, duke imituar Mubarekfurin, autorin e *“Tuhfetul Ahfedhij”*, dhe hadithin e konsideron të dobët.

Albani kishte provuar t’u referohej disa fetvave, të cilat për lexuesit do t’i sqarojmë si vijon:

Se Maliku ka transmetuar në librin *“El Muveta”* prej Muhamed ibën Jusufit prej Es Saib ibën Jezidit se ai ka thënë: “Omeri r.a. ka urdhëruar Ubej ibën Kabin dhe Temim ed Dariun që të falen me xhemat nga 11 rekate.”



Albani konsideron se ky transmetim është më i pranuar sesa transmetimi Jezid ibën Husajfe. Duke pasur parasysh se Imam Ahmedi për transmetimin e Jezid ibën Husajfes ka thënë: “Është hadith munker (i panjohur).” Kurse Edh Dhehebiu, në librin “*El Mizan*”, ka cekur se në transmetimin e Jezid ibën Husajfes ka kontradikta, duke pasur parasysh se nganjëherë transmetohet për 21 rekate e nganjëherë për 23 rekate.

Për sa i përket çështjes se në hadithin e transmetuar nga Ibni Husajfe, ka kundërshti, sepse herë përmendet numri 21, herë 23 i rekateve, kjo ka të bëjë me salati-vitrin, që falet pas 20 rekateve *teravi*, i cili përbëhet prej një ose tri rekateve.

Ndërsa Shejh Abdullah ibën Muhamed ibën Abdulvehhabi, në veprën e tij “*Mexhmeatul fetava en Nexhdije*”, në përgjigjen e tij për numrin e rekateve të *teravive*, thotë: “Pasi Omeri r.a. i bashkoi njerëzit (të faleshin) me Ubej bin Kabin, namazi i tyre kishte 20 rekate.”

Tirmidhiu, në librin e tij “*Xhamiu*”, shprehet: “Shumica e dijetarëve janë për atë që është transmetuar nga Omeri r.a., Aliu dhe të tjerë nga sahabët e Pejgamberit a.s. rreth numrit të *teravive*, e ai është 20 rekate. Gjithashtu ky mendim është edhe i Sufjani Thevriut dhe i Ibën Mubarekut, kurse Shafiu ka thënë: “Këtë e kam takuar dhe përjetuar në qytetin tonë në Mekë, ku i falnin 20 rekate.”

Namazi i *teravive* me xhemat, me përjashtim të *nafileve* të tjera, është më i lavdëruar sesa falja vetmas në shtëpi, duke pasur shembull traditën e Pejgamberit a.s. dhe shokëve të tij dhe për shkak se disa njerëz nga pakujdesia, nëse nuk i falin *teravitë* me xhemat, shpeshherë nuk i falin fare. Është kirahet (e përbuzur) mos këndimi i *Subhanekës* pas tekbirit fillestar dhe në fillim të rekatit të tretë; të mjaftuarit me një ajet të shkurtër pas *Fatihës* dhe të mjaftuarit me thënien një herë: *Subhane rabbijel adhim* ose *subhane rabbijel a`la* në ruku dhe sexhde.

Duhet pasur kujdes nga ato gjëra që mund të shkaktojnë prishjen e namazit, siç është mosplotësimi i rukusë, i ngritjes prej saj, i sexhdes dhe i veprimeve të tjera.

Ai që nuk është hafëz i Kuranit nga imamët, falet duke lexuar atë që i vjen më së lehti nga Kurani. Pas *Fatihës*, lexon një ajet të gjatë ose tre të shkurtër, kurse shton sa të dojë, por të ketë kujdes ndaj atyre që i ka prapa, ndaj xhematit.

Rekomandohet falja e namazit të vitrit me xhemat pas *teravive*, me përjashtim të atyre që e shtyjnë deri para namazit të sabahut.

Përktheu: Ekrem Simnica

- 1 * (Marrë nga libri “Erkan el Islam - Shtyllat e Islamit”).
- 2 Transmetojnë Maliku, Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.
- 3 Transmeton Buhariu.
- 4 Vitit 14 siç ka cekur Sujuti në librin “*Tarih el hulefa*”.
- 5 *Bidat* (risi), është një çështje e paraqitur në fe pa pasur ndonjë shembull, dhe ajo është dy llojesh: Në qoftë se radhitet nën atë që është e mirë dhe e lavdëruar në legjislacionin – Sheriatin islam, ai është *bidat hasen* (risi e mirë), e në qoftë se radhitet në atë që është e keqe dhe e urreyer në Sheriat, ai është *bidat kabiha* – risi e keqe. Ajniu, në komentim të Buhariut, ka thënë: “Prej *bidatit* të mirë llogaritet shkrimi dhe shumëzimi i *mus-hafeve* në kohën e Uthmanit, dhe shpërndarja e tyre nëpër qendra (të vendeve myslimane), gjithashtu pikësimi dhe vokalizimi i tij, ngritja e minareve të xhamive, rregullat dhe programi i mësimin në xhami, shkolla dhe vende të tjera. Ndërsa prej *bidateve* jo të mira, konsiderohen – ajo që është shpikur nga salavatet mbi atë që nuk ka ardhur nga Pejgamberi a.s., çka është shpikur nga lutjet *duatë* – lutjet dhe salavatet për Pejgamberin a.s., si dhe dhënia më tepër rëndësi atyre se leximit të Kuranit.
- 6 Buhariu, Maliku dhe përmbledhësit e suneneve.
- 7 Transmeton Maliku.
- 8 *Athar es Sunenij*, 53/2.
- 9 Po aty.
- 10 Transmeton Ibën ebi Shejbe.
- 11 Transmeton Bejhekiu.
- 12 Transmeton Bejhekiu.
- 13 *Mearif es Sunen dhe sherh Tirmidhij*, 5/228.
- 14 *Evxhez el Mesalik*, 3/396.
- 15 *Evxhez el Mesalik*, 3/396.
- 16 *Mearif es Sunen*, 5/225.

Efekti i punëve të rënda fizike në prishjen e agjërimit

Mr. Ekrem Maqedonci

Agjërimi, si një nga shtyllat kryesore të Islamit, është një detyrë e qartë për çdo mysliman, i cili i plotëson kushtet. Ai ka për qëllim të forcojë lidhjen shpirtërore me Allahun, të zhvillojë durim dhe vetëdisiplinë, si dhe të edukojë agjëruesin dhe përgjegjësinë personale të tij. Megjithatë, Allahu i Mëshirshëm ka parashikuar situata kur agjërimi mund të lehtësohet, duke treguar se feja nuk është ngarkesë apo barrë e tepërt dhe e vështirë për njerëzit. Këtë çështje qartazi na e tregon Allahu në Kuran kur thotë: *“Allahu nuk ka vendosur për ju ndonjë vështirësi në fe.”* (El Haxh, 78).

Ky ajet tregon qartë se Islami ka natyrë të mëshirshme dhe është praktik, duke marrë parasysh kufijtë dhe mundësitë e njeriut. Në rastet kur agjërimi mund ta dëmtojë shëndetin, të shkaktojë lodhje të tepruar ose rrezik fizik, ai lejohet të ndërpritet dhe të kompensohet më vonë. Kjo nuk është një shkelle e normave të fesë, por është një tolerim i shpirtëruar, që ruan jetën dhe shëndetin e individit.

Një qasje e tillë tregon balancën e Islamit ndërmjet detyrimeve fetare dhe kujdesit për individin. Shpërblimi shpirtëror nuk humbet kur agjërimi ndërpritet për arsye të ligjshme, sepse ky është një veprim që buron nga

Në rastet kur agjërimi mund ta dëmtojë shëndetin, të shkaktojë lodhje të tepruar ose rrezik fizik, ai lejohet të ndërpritet dhe të kompensohet më vonë.

respekti për udhëzimet e Allahut dhe për ruajtjen e shëndetit.

Andaj, duhet ta kuptojmë se Islami nuk është fe që obligon vështirësi të panevojshme; ai në vetvete ngërthen një udhëzim dhe legjislacion të drejtë dhe të mëshirshëm, duke lejuar tolerime në situata ku individi përballet me nevoja reale, pa e llogaritur si mëkatar atë.

PUNËT E RËNDA FIZIKE DHE KLASIFIKIMI I TYRE

Punët e rënda fizike me të cilat zakonisht përballet agjëruesi, mund të klasifikohen ose ndahen në dy kategori:

PUNË TË RËNDA, POR JO TË DETYRUESHME OSE URGJENTE

Këto mund të përfshijnë aktivitete të cilat mund të shtyhen, të reduktohen apo të organizohen në një kohë tjetër, pa shkaktuar dëm serioz për agjëruesin ose shoqërinë. Në këtë kategori hyjnë disa punë dhe obligime shtëpiake, aktivitete sportive intensive, stërvitje fizike të panevojshme, si dhe punë apo angazhime që mund të kryhen pas iftari ose pas përfundimit të muajit Ramazan. Zakonisht këto punë nuk janë urgjente që të kryhen për të, ose aty për aty.



Rëndom, duke pasur parasysh vlerën dhe rëndësinë që ka agjërimi dhe muaji Ramazan për besimtarin, dhe duke ditur se agjërimi është një obligim madhor që ka përparësi ndaj veprimeve jo obligative, atëherë i jepet përparësi agjërimit ndaj punëve jo obligative.

Bazuar në këtë parim, dijetarët e fikhut theksojnë se: “Nuk lihet farzi për një punë që nuk është farz,” Imam el Kasani, shprehet se lodhja dhe përpjekja fizike e zakonshme nuk e justifikojnë prishjen e agjërimit, përderisa nuk ekziston frikë reale për dëmtim të trupit.¹

Po ashtu, edhe Imam Burhanuddin el Merginani thekson se, agjërimi nuk mund të prishet për shkak të punëve që vetë personi i zgjedh dhe që mund të shtyhen, sepse përgjegjësia fetare për atë person mbetet e plotë.²

Lodhja, djersitja dhe ndjenja e etjes, që vijnë si pasojë e punëve jo të detyrueshme, janë pjesë e natyrshme e agjërimit dhe nuk konsiderohen arsye për prishjen e tij. Për këtë arsye, Islami e nxit besimtarin që të riorganizojë kohën dhe të shtyjë punët e rënda jo të domosdoshme për orët e mbrëmjes ose pas Ramazanit.

Prandaj, për punët e rënda fizike që nuk janë të domosdoshme të kryhen gjatë kohës së agjërimit obligativ, nuk lejohet prishja e agjërimit, sepse agjërimi është obligim hyjnor dhe ka përparësi ndaj çdo aktiviteti që mund të shtyhet apo shmanget.

PUNË TË RËNDA, POR TË DOMOSDOSHME OSE URGJENTE

Punët e rënda fizike që janë të domosdoshme përfshijnë aktivitete që nuk mund të shtyhen pa pasoja serioze, si korrja e grurit në kohën e tij, ndërtimi i shtëpisë për strehim, puna në furra me temperatura shumë të larta, si dhe shërbimet publike të domosdoshme, si: shëndetësia, energjia, uji dhe siguria.

Këto punë kërkojnë përpjekje intensive fizike dhe shpesh shkaktojnë humbje të madhe të lëngjeve trupore dhe lodhje

ekstreme, gjë që mund të rrezikojë shëndetin ose jetën e punëtorit. Islami nuk e obligon njeriun të dëmtojë veten. Allahu i Madhëruar në Kuranin famëlartë thotë:

“Allahu nuk e ngarkon asnjë njeri përtej mundësive të tij.” (El Bekare, 286), dhe gjithashtu thotë: *“Mos u bëni shkaktar që ta mbytni veten tuaj, ngase Zoti për ju është Mëshirues i madh.”* (En Nisa, 29).

Po ashtu, i Dërguari ynë, Muhamedi a.s., ka thënë: “Nuk ka dëm dhe as shkaktim dëmi.”³

Duke u mbështetur në këto argumente, dijetarët e fikhut kanë sqaruar se nëse agjërimi gjatë kryerjes së një pune të domosdoshme sjell rrezik real për shëndetin, atëherë lejohet prishja e tij. Ibën Abidini shprehet qartë se, punëtori që frikësohet për jetën ose shëndetin e tij nga agjërimi, lejohet ta prishë atë dhe atë ditë obligohet ta bëjë kaza me ndonjë ditë tjetër më vonë.⁴

Edhe Ibën Kudame el Makdesij përmend se ruajtja e jetës ka përparësi ndaj vazhdimit të agjërimit kur ekziston rrezik real gjatë punës së domosdoshme.⁵

Të njëjtin qëndrim e gjejmë edhe tek Imam Neveviu, i cili sqaron se frika e dëmtimit serioz fizik e lejon ndërprerjen e agjërimit dhe kompensimin e tij më vonë.⁶

Ky lehtësim, po ashtu bazohet edhe në parimin e njohur të fikhut islam se “vështirësia sjell lehtësimin”⁷

Prandaj, duke u mbështetur në të gjitha këto referenca dhe mendime të dijetarëve eminentë të jurisprudencës islame, mund të konkludojmë se, për punët e rënda fizike që janë të domosdoshme dhe që rrezikojnë shëndetin e agjëruesit, lejohet prishja e agjërimit si lehtësim hyjnor, me kusht që ai të kompensohet më vonë.

KRITERI FETAR PËR PRISHJEN E AGJËRIMIT NGA LODHJA E SKAJSHME

Me rëndësi të veçantë duhet vënë theksi se dita e Ramazanit duhet të fillohet patjetër me nijet për agjërime, edhe nga ai person që parashikon se gjatë ditës mund të përballet me punë të rënda fizike. Parimi bazë në fikh është se obligimet

fetare realizohen sipas gjendjes aktuale dhe jo sipas supozimeve apo frikësimeve për atë që mund të ndodhë më vonë gjatë ditës. Për këtë arsye, nuk lejohet që agjërimi të lihet pa filluar, vetëm me arsyetimin se personi ka për të kryer punë të rënda fizike.

Agjëruesi është i obliguar që ditën ta nisë në gjendje agjërimi dhe të përpiqet ta ruajë atë sa të jetë e mundur. Vetëm nëse gjatë ditës paraqitet vështirësi reale dhe e padurueshme, apo shfaqet rrezik i vërtetë për shëndetin, si dobësi ekstreme, marramendje, dehidrim i rëndë apo frikë serioze për jetën, atëherë lejohet prishja e agjërimit si lehtësim fetar. Ky lehtësim nuk vjen si pasojë e rehatisë apo dëshirës personale, por si domosdoshmëri e diktuar nga ruajtja e shëndetit dhe jetës.

Në këtë kontekst, dijetarët theksojnë se nuk lejohet që njeriu ta parashikojë të ardhmen dhe mbi bazën e supozimeve ta braktisë obligimin e agjërimit. E ardhmja dhe ajo që do të ndodhë gjatë ditës janë në dijen e Allahut të Gjithëdijshëm, ndërsa njeriu është i ngarkuar vetëm me veprimin sipas gjendjes së tanishme dhe mundësive që ka në atë çast. Shpesh ndodh që personi e fillon ditën duke menduar se nuk do ta përballojë agjërimit, por me ndihmën e Allahut arrin ta përfundojë atë pa vështirësi të mëdha.

Prandaj, rregulli i drejtë fetar është që agjërimi të fillohet me nijet të sinqertë dhe përpjekje reale për ta ruajtur atë. Vetëm kur vështirësia bëhet e pashmangshme dhe rreziku për shëndetin i dukshëm, atëherë prishja e agjërimit lejohet dhe konsiderohet mëshirë dhe lehtësim nga Allahu, ndërsa dita e prishur kompensohet më vonë me agjërimit kaza.

PREFEROHET QË PRISHJA E AGJËRIMIT MOS TË BËHET HAPTAS

Dijetarët e fikhut kanë theksuar se ai që ka të drejtë ta prishë agjërimit në Ramazan për shkak të punëve të rënda dhe lodhjeve të tepërta e të pashmangshme, mundësisht duhet ta bëjë këtë në mënyrë të fshehtë dhe jo të dukshme. Kjo preferencë bëhet për disa arsye të rëndësishme:

1. Parandalimi i keqkuptimeve nga të tjerët: Nëse dikush e bën publike prishjen e agjërimit, të tjerët mund të mendojnë se ai e ka ndërprerë agjërimit pa arsye të vlefshme. Kjo mund të shkaktojë dyshim në komunitet dhe të ndikojë negativisht në imazhin moral të individit.

2. Parandalimi i ndëshkimeve të mundshme: Në disa kontekste historike ose në disa shoqëri, shfaqja publike e prishjes së agjërimit mund të shkaktojë reagime nga autoritetet fetare ose politike, duke rrezikuar personin që agjëron për arsye të ligjshme.

3. Mos inkurajimi i të tjerëve në shkelje të normave fetare: Prishja publike e agjërimit mund të inkurajojë individë që nuk kanë arsye të ligjshme të ndërpresin agjërimit, duke krijuar precedent të gabuar. Kjo mund të ndikojë negativisht

në disiplinën dhe respektin ndaj Ramazanit në shoqëritë islame.

Dijetarët theksojnë se fshehtësia e prishjes së agjërimit nuk është vetëm një këshillë praktike, por edhe një mënyrë e mirë për ta ruajtur moralin dhe respektin ndaj rregullave islame, duke siguruar që shpërblimi i Allahut të mbetet i plotë dhe i papenguar.⁸

PREFEROHET QË TË MOS FILLOHET NDONJË PUNË E RËNDË FIZIKE PA NEVOJË

Të fillosh një punë të rëndë fizike, që nuk është e domosdoshme, gjatë kohës së agjërimit është e urryer ose mekruh, sepse mund të dobësojë trupin dhe të rrezikojë vazhdimin e agjërimit.

Kjo përfshin punë të vështira fizike, ngritje peshe, lojëra të lodhshme ose aktivitete të tjera që shkaktojnë lodhje të madhe pa nevojë, dhënia gjak pa nevojë, etj.. Transmetohet nga Buhariu se Enes ibën Maliku r.a., e kishte pyetur Pejgamberin a.s.: “A e konsideroni hixhamen (dhënien e gjakut) të urryer për agjëruesin?” Ai tha: “Jo, përveç atëherë kur dobëson agjëruesin.”⁹

Nga ky hadith mund të mësohet se çdo veprim që e dobëson agjëruesin, që e rrezikon agjërimit, që shkakton dobësim ose lodhje të panevojshme gjatë agjërimit, është i urryer, dhe është më mirë të shmanget për ta ruajtur forcën dhe zbatimin e agjërimit.

PËRFUNDIM

Punët e rënda fizike nuk e prishin automatikisht agjërimit, por lejohet ndërprerja e agjërimit në raste dëmi ose rreziku për shëndetin, duke respektuar më pastaj normën e kazasë (kompensimit). Kjo për faktin se Islami është fe e mëshirës dhe e lehtësisë, dhe shpërblimi për durimin është i garantuar. “Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë së tij.” (El Bekare, 286).

1 Bedaiu Senai fi Tertibi Sherai, Alauddin el Kasani, 2/ 92–94, Dar el Kutub el Ilmijje, Bejrut, 1986.

2 El Hidajeh fi Sherh Bidajeti'l-Mubtedi, El Merginani, 1/207–208, Dar Ihja et Turath el Arabi, Bejrut.

3 Ibën Maxheh me nr. 2340.

4 Reddul Muhtar ala Durr el Muhtar, Ibën Abidin, 2/418–420, Dar el Fikër, Bejrut, 1992.

5 El Mugni, Ibën Kudame, 3/35–37, Dar el Fikër, Bejrut.

6 El Mexhmu Sherh el Muhedheb, Imam Nevevi, 6/261–263, Dar el Fikër, Bejrut.

7 El Eshbah ven Nedhair, Xhelaluddin es Sujuti, f. 87–89, Dar el Kutub el Ilmijje.

8 Për më hollësisht shiko: El Fikh el Mujeser, grup autorësh, 1/464, Dar al Ma'ali.

9 Transmeton Buhariu, me nr. 1940.

Shfrytëzimi i dhjetëshit të fundit të Ramazanit

Mr. Vedat Shabani

Besimtari duhet t'i shfrytëzojë momentet e veçanta dhe ta investojë kohën e tij në atë që e kënaq Allahun xh.sh., sepse nëpërmjet tyre zbret mëshira, shumëfishohen veprat e mira, fshihen mëkatet dhe ngrihen gradat. Për shkak të vlerës dhe rëndësisë së tyre, Pejgamberi a.s., bëri thirrje për shfrytëzimin e këtyre mundësive. Transmeton Enes ibën Maliku r.a., se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Bëni mirë gjatë gjithë jetës suaj dhe ekspozohuni ndaj flladit të mëshirës së Zotit, sepse Zoti i Plotfuqishëm ka momente të mëshirës së Tij që ia dhuron kujtdo që dëshiron nga robërit e Tij. Kërkoni nga Zoti i Plotfuqishëm t'i fshehtë të metat tuaja dhe t'ju japë siguri nga gjërat të cilat ju frikësojnë.”¹

Së këndejmi, një ndër momentet dhe rastet më ideale dhe më të pasura janë dhjetë ditët/netët e fundit të Ramazanit.



Prandaj, meqë jemi në përfundim të këtij muaji të begatë, përmes këtij punimi jam munduar të zgjedh dhe të paraqes para lexuesit të revistës sonë përfitimet që ndihmojnë në shfrytëzimin maksimal të këtyre netëve.

PËRKUSHTIMI I PEJGAMBERIT A.S. DHE FAMILJES SË TIJ NË DHJETËSHIN E FUNDIT

Pejgamberi ynë i dashur ishte më i përkushtuar në dhjetë ditët/netët e fundit të Ramazanit dhe më i etur për të kaluar natën dhe ditën në adhurim dhe përkushtim ndaj Zotit xh.sh.. Gjatë kësaj kohe ai nuk shihte asgjë më të mirë sesa izolimin (itikafin) në xhami për të përmbushur ambicien, për të ushqyer shpirtin dhe për të gëzuar zemrën. Sepse ky veprim është një braktisje e gjithçkaje që e largon njeriun nga Zoti xh.sh..

Lidhur me vlerën e këtyre ditëve/netëve, Aisheja r.a., ka thënë: “I Dërguari i Zotit a.s. përkushtohej në adhurim gjatë dhjetë netëve të fundit të Ramazanit më shumë se në çdo kohë tjetër.”² Gjithashtu, Aisheja r.a., ka thënë se: “Pejgamberi a.s. izolohej (bënte itikaf) në dhjetë ditëshin e fundit të Ramazanit deri në fundin e jetës së tij, më pastaj kështu kanë vepruar edhe bashkëshortet e tij.”³

Lidhur me arsyen se përse Pejgamberi a.s. e intensifikonte përkushtimin e tij në dhjetëshin e fundit, Imam El Ajniu ka thënë: “Ai e rriste përkushtimin gjatë dhjetë ditëve të fundit për dy arsye, e para: me shpresën e nxënies së Natës së Kadrit, e dyta: sepse kjo periudhë është fundi i përkushtimit të tij, dhe ai dëshironte që përfundimi i veprave të tij të jetë në mënyrën më të përsosur.”⁴

Duke pasur parasysh vlerën dhe rëndësinë e këtyre netëve, Pejgamberi a.s., i bashkëngjiste edhe familjarët e tij në arritjen e vlerës së këtyre netëve të Ramazanit, me shpresën se edhe ata do ta arrijnë vlerën e Natës së Kadrit. Transmeton Aliu r.a., i cili thotë: “I Dërguari i Allahut a.s. i zgjonte familjarët e tij në dhjetë netëshin e fundit të Ramazanit; çdo të rritur dhe fëmijë të cilët kishin mundësi për t’u falur namaz.”⁵ Gjithashtu edhe Aisheja r.a., ka transmetuar dhe ka thënë: “Kur hynte dhjetësi i fundit i Ramazanit, Pejgamberi a.s., shtrëngonte rrobat, e ngjallte natën dhe i zgjonte familjarët e tij.”⁶

Dijetari, Nuruddin es Sindij, lidhur me domethënien e ‘ngjalljes së natës’, ka thënë: “Ngjallja e natës realizohet përmes namazit dhe leximit të Kuranit, sikur aludon në atë se koha e kaluar pa adhurim-ibadet është sikur me qenë i vdekur, ndërsa përmes adhurimit-ibadetit ajo bëhet e gjallë, e nëse kjo ka të bëjë me kohën, atëherë si mund të jetë çështja me zemrën?!”⁷

Ndërsa Imam Neveviu ka thënë: “Bazuar në këtë hadith, preferohet që në dhjetëshin e fundit të Ramazanit të intensifikohen edhe më shumë punët e mira (ibadetet), gjithashtu preferohet që netët e dhjetëshit të fundit të ngjallen me adhurime të ndryshme.”⁸

Lidhur me këtë, Imam Shevkaniu, ka thënë: “Në këtë ka argument për lejueshmërinë e përkushtimit të vazhdueshmërisë së faljes së namazit të natës në dhjetëshin e fundit të Ramazanit, në ngjalljes e netëve me adhurime, në largimin nga gratë dhe në urdhërimin e anëtarëve të familjes që të jenë më të përkushtuar gjatë këtyre netëve.”⁹

NATA E KADRIT NË DHJETËSHIN E FUNDIT

Sipas transmetimeve të shumë haditheve, aludohet se Nata e Kadrit është në dhjetëshin e fundit të Ramazanit. Në këtë frymë, është edhe transmetimi i Ebu Seid el Hudrijut, i cili tregon se Pejgamberi a.s., fillimisht është izoluar (ka bërë itikaf) në dhjetëshin e parë, më pastaj në dhjetëshin e mesëm, në një tendë turke, dera e së cilës ishte e mbuluar me një bez/hasër, ku sipas transmetuesit ai një ditë e largoi me dorën e tij dhe e

zhvendosni në njëren anë të tendës, pastaj e nxori kokën dhe iu drejtua njerëzve, të cilët iu afruan, dhe ju tha: “Unë u izolova (bëra itikaf) në dhjetëshin e parë, duke e kërkuar këtë natë, më pastaj u izolova (bëra itikaf) në dhjetëshin e mesëm, më pastaj dikush më erdhi dhe më tha: “Ajo është në dhjetëshin e fundit”, prandaj kush dëshiron që të izolohet (të bëjë itikaf) le të bëjë. Si rezultat, njerëzit hynë në itikaf me të, pastaj Pejgamberi a.s., vazhdoi e tha: “Më është thënë se është në netët tek dhe mëngjesin e saj sikur bëja sexhde mbi ujë dhe lloç.”¹⁰

Pejgamberi a.s. në vazhdimësi i nxiste njerëzit që ta hulumtojnë Natën e Kadrit dhe ta kërkojnë atë në dhjetëshin e fundit. Ai a.s., ka thënë: “Kërkojeni atë në dhjetëshin e fundit – fjalën e ka pas për Natën e Kadrit – e nëse dikush lodhet e moliset, atëherë të ketë kujdes në shtatëshen e fundit.”¹¹

Aisheja r.a., transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Hulumtojeni Natën e Kadrit në netët tek, në dhjetëshin e fundit të Ramazanit.”¹²

Lidhur me këto transmetime dhe domethënien e kërimit të Natës së Kadrit, Ibën Hazmi, ka thënë: “Nata e Kadrit gjurmohet dhe hulumtohet përmes veprave të mira, e jo se ajo ka ndonjë formë apo përmbajtje të caktuar, që e dallon prej netëve të tjera, siç mendojnë shumë njerëz, të cilët nuk kanë njohuri. Zoti xh.sh., ka thënë: “*Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmëruar. Në atë (natë të zbritjes së Kuranit) vendoset çdo punë e urtë.*” (Ed Duhan, 3-4), ndërsa në një vend tjetër ka thënë: “*Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. Paqë është ajo deri në lindjen e agimit.*” (El Kadër, 3-5), prandaj me këtë ajo është dalluar nga netët tjera.”¹³

VLERA E NATËS SË KADRIT

Vlera e parë: Allahu xh.sh., në këtë natë e ka zbritur Kuranin, në të cilin njerëzit e gjejnë udhëzimin dhe lumturinë e tyre në këtë dhe botën tjetër. Allahu xh.sh., në Kuran, thotë: “*Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.*” (El Kadër, 1), ajeti tjetër: “*Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmëruar. Në atë (natë të zbritjes së Kuranit) vendoset çdo punë e urtë.*” (Ed Duhan,

“Ngjallja e natës realizohet përmes namazit dhe leximit të Kuranit, sikur aludon në atë se koha e kaluar pa adhurim-ibadet është sikur me qenë i vdekur, ndërsa përmes adhurimit-ibadetit ajo bëhet e gjallë.



3-4). Që nënkupton se Kuranin si tërësi dhe përnjëherë është zbritur nga Levhi Mahfudhi në qiellin e kësaj bote në natën e vlefshme dhe të begatshme, natën në të cilën përcaktohen gjërat.

Vlera e dytë: Kjo natë është më me vlerë se sa një mijë muaj. Allahu xh.sh., në Kuran, thotë: *“Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.”* (El Kadër, 3), që nënkupton në virtyte, vlerë dhe shpërblime të shumta.

Lidhur me këtë, Imam Maliku, ka thënë se: *“Të Dërguarit të Allahut a.s., iu tregua jetëgjatësia e njerëzve para tij, ose atyre që Allahu dëshironte t’i tregonte. Me këtë rast sikur Pejgamberi a.s. e konsideronte jetëgjatësinë e popullit të tij shumë të shkurtër për të arritur në vepra të njëjtës masë si ata që jetuan më gjatë, kështu që Allahu xh.sh., ia dhuroi atij Natën e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj.”*¹⁴

Vlera e tretë: Engjëjt në këtë natë zbresin me rahmet/ mëshirë dhe lutje për besimtarët myslimanë. Allahu xh.sh., në Kuran, thotë: *“Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.”* (El Kadër, 4). Engjëjt në këtë natë, të cilët zbresin në tokë, janë më shumë në numër se sa guralecët të cilët janë në tokë. Transmeton Ebu Hurejre r.a., se i Dërguari i Allahut xh.sh., ka thënë: *“Ajo është në natën e njëzetë e shtatë ose të njëzetë e nëntë, dhe engjëjt në atë natë në tokë janë më shumë në numër sesa guralecët.”*¹⁵

Vlera e katërt: Nata e Kadrit është e qetë dhe natë e paqes për arsye të adhurimeve të shumta, të cilat i bën rob i dhe të cilat ndikojnë në largimin e tij nga zjarri i Xhehenemit. Allahu xh.sh., në Kuran, thotë: *“Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”* (El Kadër, 5). Abdullah ibën Abasi ka thënë: *“Në atë natë largohen rebelët e xhinëve dhe të djajve, hapen të gjitha*

dyert e qiejve dhe Zoti xh.sh. e pranon pendimin e çdo personi i cili pendohet, për këtë arsye ka thënë: *“Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”*¹⁶ Ndërsa Mensur ibën Zadhani, ka thënë: *“Engjëjt zbresin nga momenti i perëndimit të diellit e qëndrojnë deri në agim. Ats përsëhendetin dhe i japin selam çdo besimtar duke i thënë: Es selamu alejke o besimtar.”*¹⁷

Vlera e pestë: Allahu xh.sh. e ka zbritur një kaptinë të tërë të Kurani, e cila lexohet deri në Ditën e Kiametit, e ajo është pikërisht kaptina Kadër.

ARSYEJA E EMËRTIMIT ME EMRIN NATA E KADRIT

Dijetarët, në bazë të studimeve të tyre, kanë përmendur tri arsye pse është emërtuar me këtë emër.

E para: Për arsye se në këtë natë caktohen gjërat që do të ndodhin në atë vit. Në këtë natë shkruhen ato që do të ndodhin atë vit. Kjo tregon për urtësinë e Zotit dhe dijen gjithëpërfshirëse të Tij. Këtë e mbështesin në ajetin kuranor, në të cilin Allahu xh.sh., thotë: *“Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar. Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues. Në atë (natë të zbritjes së Kuranit) vendoset çdo punë e urtë.”* (Ed Duhan, 3-4).

E dyta: Është emërtuar me këtë emër për arsye se Kurani ka zbritur në këtë natë dhe si rezultat ju është dhënë vlera kësaj nate për shkak të vlerës së Kuranit, i cili është një mrekulli e përhershme. Abdullah ibën Abasi ka thënë: *“Kurani ka zbritur si tërësi dhe është vendosur në vendin e quajtur ‘Bejtu-l-Izzeti’ në qiellin e kësaj bote. E më pastaj Xhibrili a.s., e ka zbritur te Muhamedi a.s. sipas rrethanave dhe veprave të njerëzve.”*¹⁸

Pejgamberi a.s., ka thënë: “Ju erdhi Ramazani, muaj i bekuar, agjërimitin e të cilit ua obligoi Allahu i Madhëruar. Në të hapen dyert e qiejve dhe mbyllen ato të Xhehenemit, ndërsa djajtë e tërbuar lidhen në zinxhirë. Allahu ka një natë në këtë muaj, e cila është më e mirë se një mijë muaj; kush privohet nga mirësia e saj, ai vërtet është i privuar.”

E treta: Për arsye se adhurimet dhe përkushtimet në këtë natë kanë një vlerë shumë të madhe, sepse Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush falet në Natën e Kadrit me bindje dhe shpresë, atij do t'i falen mëkatet deri në atë moment.”¹⁹

URTËSIA E FSHEHJES SË NATËS SË KADRIT

Urtësia që fshihet pas paqartësisë së Natës së Kadrit është inkurajimi i njerëzve në kërkimin e saj gjatë gjithë netëve të Ramazanit. Transmeton Zirr ibën Hubejshi, i cili thotë se e kam pyetur Ubej ibën Kabit, duke i thënë se Abdullah ibën Mesudi po thotë: “Kush e kërkon gjatë tërë vitit me siguri do ta gjej atë!” Ubej ibën Kabi tha: “Zoti e ruajt atë, qëllimi i tij është që njerëzit të mos bëhen dembelë, sepse ai e dinë se ajo është në muajin Ramazan, në dhjetëshin e fundit dhe pikërisht nata e njëzetë e shtatë.”²⁰

Dijetarët thonë se Allahu xh.sh., nga mëshira e Tij ndaj robërve të Tij, e ka fshehur këtë natë, për arsye që ata të përkushtohen në mënyrë maksimale përmes adhurimit, namazit, lutjeve dhe formave të tjera për ta arritur vlerën e kësaj nate. Gjithashtu kjo është edhe një lloj sprove për njerëzit, në mënyrë që të bëhet dallimi mes atij që është i sinqertë dhe i përkushtuar që me çdo kusht ta arrijë këtë natë dhe mes atij që është dembel dhe nuk shfaq asnjë orvatje apo mund për ta arritur këtë natë dhe vlerën e saj. Sepse ai që dëshiron të arrijë një gjë me siguri që derdh mund për ta arritur atë, dhe çdo vështirësi në këtë rrugë i lehtësohet, sepse qëllimi është shumë fisnik.

Prandaj, ju të nderuar agjërues! Mos u bëni prej atyre që privohen nga mirësitë e kësaj nate, sepse ai që privohet nga mirësitë e kësaj nate, në realitet ai ka humbur shumë. Transmeton Ebu Hurejre r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Ju erdhi Ramazani, muaj i bekuar, agjërimitin e të cilit ua obligoi Allahu i Madhëruar. Në të hapen dyert e qiejve dhe mbyllen ato të Xhehenemit, ndërsa djajtë e tërbuar lidhen në zinxhirë. Allahu ka një natë në këtë muaj, e cila është më e mirë se një mijë muaj; kush privohet nga mirësia e saj, ai vërtet është i privuar.”²¹

Angazhimi më i mirë gjatë këtyre netëve është falja e namazeve, me përkushtim dhe bindje të thellë. Gjithashtu preferohet leximi i Kuranit, dhënia e sadakave dhe lutjet e vazhdueshme. E lutja më e mirë është ajo që tregon Aisheja r.a., e cila e ka pyetur Pejgamberin a.s., se çfarë lutje të thotë nëse e arrin Natën e Kadrit, e Pejgamberi a.s., i ka thënë se lutja më e mirë është kjo: “Allahumme in-neke Afuv-vun, tuhib-bu el Afve, Fa’fu an-ni / Zoti im! Ti je Falës, e donë faljen, prandaj më fal edhe mua.”

Lusim Allahun Fuqplotë që të na pranojë agjërimitin e muajit të bekuar, të na mundësojë arritjen e vlerës së Natës së Kadrit, të na bëjë prej atyre që janë të falur në këtë muaj dhe të mos jemi nga të privuarit e mirësive fizike dhe shpirtërore të këtij muaji! Amin!

- 1 Transmeton Taberaniu në Librin e Lutjeve, 26, f. 29.
- 2 Transmeton Imam Muslimi, Kapitulli i itikafit, vëll. 4, f. 8.
- 3 Transmeton Imam Buhariu, Kapitulli i itikafit, vëll. 3, f. 47.
- 4 Bedruddin el Ajni, *Sherhu Sunen Ebi Davud*, versioni PDF, vëll. 5, f. 253.
- 5 Transmeton Taberaniu në *El Muxhem el Evsat*, vëll. 7, f. 253.
- 6 Transmeton Imam Buhariu në Librin e vlerës së Natës së Kadrit, vëll. 3, f. 47.
- 7 Nuruddin es Sindij, *Hashijet es Sindij ala Sunen ibën Maxheh*, vëll. 1, f. 537.
- 8 Muhjiddin en Nevevij, *Sahihu Muslim*, vëll. 8, f. 71.
- 9 Muhamed ibën Alij ibën Muhamed esh Shevkanij, *Nejlul-Evtar*, vëll. 4, f. 319-320.
- 10 Transmeton Imam Muslimi, Libri i agjërimit, Kapitulli i vlerës së Natës së Kadrit, vëll. 3, f. 171.
- 11 Transmeton Imam Muslimi, Libri i agjërimit, Kapitulli i vlerës së Natës së Kadrit, vëll. 3, f. 170.
- 12 Transmeton Imam Buhariu, Libri i vlerës së Natës së Kadrit, vëll. 3, f. 46.
- 13 Ebu Muhamed ibën Hazëm el Endelusij, *El Muhala bil Athar*, vëll. 4, f. 459-460.
- 14 Muvata Imam Malik, vëll. 1, f. 342.
- 15 Transmeton Imam Ahmedi në Musned, vëll. 16, f. 427.
- 16 Xhelaluddin es Sujutij, *Ed Durru-l-Menthur fi Tefsiri bi-l-Methur*, vëll. 8, f. 570.
- 17 Po aty.
- 18 Transmeton Bezari në Musnedin e tij, vëll. 11, f. 236.
- 19 Transmeton Imam Buhariu, Libri i agjërimit, vëll. 3, f. 26.
- 20 Transmeton Imam Muslimi, Libri i agjërimit, Kapitulli i vlerës së Natës së Kadrit, vëll. 3, f. 173.
- 21 Transmeton Imam Nesaiu në Sunenin e tij, vëll. 4, f. 128.

Sadekatul fitri – nga tradita profetike te praktika bashkëkohore

Dr. Ejup Haziri

HYRJE

Sadekatul fitri është një obligim fetar i përcaktuar për çdo mysliman që ka mundësi ekonomike, i cili lidhet ngushtë me agjërimin e Ramazanit dhe gëzimin e Bajramit. Ky akt bamirësie dhe solidariteti social ka për qëllim pastrimin e agjërit nga mangësitë dhe gabimet e vogla, si dhe sigurimin e ndihmës dhe gëzimit për të varfrit. Praktika e dhënies së sadekatul fitrit, e cila në kohën e Pejgamberit a.s., siç do ta elaborojmë, ishte organizuar edhe përmes institucionit të Bejtu-l Malit, lidh adhurimin personal me përgjegjësinë shoqërore, duke reflektuar një Islam që kujdeset jo vetëm për individin, por edhe për komunitetin. Sot, dhënia e sadekatul fitrit vazhdon të ketë rëndësi të veçantë, duke u administruar përmes institucionit fetar, që në rastin tonë është Bashkësia Islame e Kosovës, e cila këtë ndihmë e adreson në institucionet arsimore dhe edukative islame, siç janë medresetë dhe Fakulteti i Studimeve Islame. Por, në këtë kuadër mund të hyjë lirshëm edhe Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, e cila aktivitetin e saj e ka në çdo cep të vendit.

Sadekatul fitri përfaqëson një akt solidariteti dhe dhembshurie sociale, duke ndihmuar të varfrit dhe duke plotësuar adhurimin e agjërit.

NORMA E SADEKATUL FITRIT

Sadekatul fitri është vaxhib, një obligim që kërkohet brenda muajit Ramazan.¹ Si rrjedhojë, sadekatul fitri është obligim dhe duhet të jepet gjatë Ramazanit, gjegjësisht para faljes së namazit të bajramit. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Sadekatul fitri është pastrim për agjëruenin nga shkarjet dhe gabimet e vogla dhe ushqim për të varfrit. Kush e jep sadekatul fitrin para namazit të bajramit, është zekat i pranuar tek Allahu, e ai i cili e jep atë pas namazit të bajramit, është lëmshë prej lëmshave të zakonshme.”²

Sadekatul fitri përfaqëson një akt solidariteti dhe dhembshurie sociale, duke ndihmuar të varfrit dhe duke plotësuar adhurimin e agjërit.

Sadekatul fitri është një shtyllë e rëndësishme e solidaritetit islam, e cila e lidh adhurimin me drejtësinë sociale. Realisht kjo gjë na mëson se gëzimi i bajramit është i plotë vetëm atëherë kur ndahet me të tjerët dhe atëherë kur gëzimi është i përbashkët, e jo parcial.

Sadekatul fitri është obligim për çdo mysliman, që ka mundësi financiare, për veten dhe për ata që i ka nën përgjegjësi, si fëmijët dhe familjarët. Pra, jepet për secilin anëtar, pa

marrë parasysh e ka agjëruar Ramazanin apo jo. Ajo duhet të jepet para namazit të bajramit, në mënyrë që të varfrit të mund të përfitojnë prej saj në ditën e festës.

QËLLIMI NGA SADEKATUL FITRI

Qëllimi kryesor i sadekatul fitrit është pastrimi i agjërimit nga mangësitë dhe gabimet që mund të kenë ndodhur gjatë Ramazanit, si dhe sigurimi i gëzimit të bajramit për të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht për ata në nevojë. Kjo tregon më së miri se Islami nuk është vetëm fe që rregullon raportin e adhurimit individual, por edhe fe e drejtësisë dhe barazisë shoqërore.

KUR JEPET SADEKATUL FITRI?

Sadekatul fitri zakonisht jepet nga Nata e Kadrit e deri para faljes së namazit të bajramit. Mirëpo, lejohet edhe para Natës së Kadrit dhe kurdo që jepet gjatë tërë Ramazanit, veç është arritur synimi i tij.

E rëndësishme është të jepet gjatë Ramazanit, ngase nëse jepet pas faljes së namazit të bajramit, atëherë fetarisht është e qortueshme, e sidomos kur bëhet pa ndonjë arsye.

Si organizohej sadekatul fitri në kohën e Pejgamberit a.s.?

Në kohën e të Dërguarit të Allahut, zekati jepej i organizuar përmes autoritetit islam, e jo në mënyrë individuale, e as sipas tekeve të dikujt. Zakonisht i Dërguari i Allahut caktonte disa njerëz që e mbledhnin dhe e tubonin atë, e më pas e sillnin në thesarin e myslimanëve që njiheshin si *Bejtu-l Mal*. Nga aty, i Dërguari i Allahut e bënte shpërndarjen të kategoritë e përcaktuara në Kuran. Pra, zekati nuk jepej ku donte individ, po ai dorëzohej në thesarin e myslimanëve, të cilin e kishte themeluar i Dërguari i Allahut dhe e mbikëqyrte rreptë. Kjo tregon qartë se zekati ishte institucion në vete ku merrej nga institucioni dhe shpërndahej nga institucioni. Këtë praktikë e ndoqën edhe shokët e të Dërguarit, ku vlen të përmendet se Ebu Bekri i luftoi ata që refuzuan ta japin zekatin në institucionin e *Bejtu-l Mal-it*, ngase këtë e kishte parë si cenim ndaj rendit islam.

Sadekatul fitri, për dallim nga zekati, nuk kishte gjithnjë një tubim qendror, shpeshherë ai shpërndahej edhe direkt të kategoritë përfituese, mirëpo në kohë nevoje, ky adhurim organizohej për t'u shpërndarë nga përgjegjësit kryesorë. Pra, edhe në rastet kur shpërndarja e sadekatul fitrit bëhej në mënyrë individuale, ajo mbikëqyrej nga institucioni. Kjo bëhej me qëllim, ngase sadekatul fitri është më tepër një obligim social i ndërlidhur me Bajramin, dhe koha e tubimit dhe shpërndarjes ishte shumë e shkurtër, për dallim nga zekati që konsiderohet shtyllë financiare.

Zekati dhe sadekatul fitri të jepet për Medrese dhe Fakultetin e Studimeve Islame!

Aktet, thirrjet dhe fetvatë, që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e jetës fetare të myslimanëve në vendin tonë kanë qenë dhe mbeten kompetencë e Bashkësisë Islame të Republikës së




Kosovës (BIRK), si institucioni kryesor fetar. BIRK-u kujdeset vazhdimisht për komunitetin mysliman dhe, në këtë kuadër, ka bërë thirrje që zekati dhe sadekatul fitri të jepet përmes saj, me qëllim të mbështetjes së medreseve dhe Fakultetit të Studimeve Islame. Ky veprim është plotësisht i ligjshëm dhe i bazuar në argumente, duke u mbështetur në ajetin e grupeve të zekatit, konkretisht në kategorinë “*në rrugë të Allahut*”, ku përfshihen edhe institucionet fetare që kontribuojnë në ngritjen arsimore, edukative dhe kulturore të myslimanëve. Kjo nuk nënkupton përjashtimin e grupeve apo fondacioneve të tjera, por përcaktimin e prioriteteve sipas rrethanave dhe nevojave aktuale.

Kërkesa e Kryesisë së BIRK-ut që zekati dhe sadekatul fitri të dedikohen për ruajtjen e qendrave të dijes është e drejtë dhe e domosdoshme, pasi roli i medreseve dhe Fakultetit ka qenë historikisht vendimtar në ruajtjen e identitetit fetar, unitetit të myslimanëve dhe imazhit të Islamit. Falë ndihmës së besimtarëve, këto institucione kanë arritur të formojnë kuadro profesionale në shërbim të shoqërisë, qoftë në aspektin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar, ngase kur ishte nevoja, dyert e Medresesë ishin të hapura për të gjithë dhe nga gjiri i saj iu bashkëngjitën Luftës Çlirimtare të Kosovës qindra nxënës, e dhjetëra prej tyre edhe ranë dëshmorë në mbrojtje të atdheut.

Në mungesë të mbështetjes shtetërore për komunitetin mysliman, ndihma e shoqërisë përmes zekatit, sadekatul fitrit dhe formave të tjera të bamirësisë mbetet thelbësore për mbijetesën dhe funksionimin e institucionit fetar. Duke iu përgjigjur kësaj thirrjeje, besimtarët jo vetëm që kryejnë obligimin e tyre fetar, por njëkohësisht kontribuojnë drejtpërdrejt në forcimin e Islamit dhe të komunitetit mysliman në vend.

Në rrethanat e sotme, ku komuniteti mysliman vepron brenda sistemeve laike, institucioni fetar zë vendin e autoritetit organizues, duke marrë përgjegjësinë e mbledhjes, administrimit dhe shpërndarjes së këtyre fondeve. Kjo praktikë nuk bie ndesh me tekstet fetare, përkundrazi, përmbush frymën e saj, sepse siguron rregull, transparencë dhe priorizim të nevojave reale të komunitetit.



SADEKATUL FITRI NË PRODUKTE BUJQËSORE APO NË PARA

Nuk ka diskutim se sadekatul fitri në kohën profetike është dhënë në produkte bujqësore, e kjo bëhej për faktin se paraja nuk kishte qarkullim të madh. Në bazë të haditheve që na janë përcjellë në lidhje me produktet bazike të sadekatul fitrit në kohën e të Dërguarit të Allahut, kryesisht janë dy hadithe më të njohura, ku i pari është transmetimi i përcjellë nga Ibën Omeri, i cili thotë: “Na obligoi i Dërguari i Allahut me dhënien e sadekatul Fitrit nga Ramazani një sa’ nga hurmat apo një sa’ nga elbi...”³

Ndërsa i dyti përcillet nga Ebu Seid el Hudriu, i cili thotë: “Në ditën e Bajramit gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut e jepnim një sa’ nga ushqimi (grurë), e ushqimi ynë ishte elbi, rrushi i thatë, djathi i tharë dhe hurmat.”⁴ Në disa transmetime përmendet gruri, e në pjesën më të madhe të tyre përmendet elbi. Elbi ishte produkt më i lirë, më i përhapur dhe ushqimi i përditshëm i shumicës së njerëzve, për dallim nga gruri, që ishte më i shtrenjtë dhe përdorej më rrallë, zakonisht nga ata që kishin më shumë mundësi. Pra, hadithet pasqyrojnë praktikën reale të asaj kohe.

Sidoqoftë, këto ishin produktet kryesore që njerëzit e asaj kohe ushqeheshin prej tyre, andaj edhe ato produkte i jepnin për sadaka.

Për një kohë vazhdoi të jepej në produkte bujqësore, kryesisht në produkte që ishin kryesore dhe më të zakonshmet në tryezat e myslimanëve. Ndërsa më vonë tekstet u interpretuan edhe ndryshe, ku u lejua të jepej edhe kundërvlera e produkteve të tilla, apo thënë ndryshe u lejua edhe në para. Prej të parëve që lejuan ishte Omer ibën Abdulazizi, Hasan el Basriu dhe Ebu Hanife. Më vonë hanefitë e zgjeruan shpjegimin dhe arsyetimin që sadekatul fitri të jepej në para të gatshme, ngase një gjë e tillë u pa më e nevojshme për të varfrit, plotësonte më mirë nevojat e nevojtarit dhe se përmes

parasë në masë të madhe përmbushje qëllimi më mirë se ushqimi.

Që nga ajo kohë e deri në ditët tona, sadekatul fitri vazhdon të jepet në të holla dhe kjo është më e arsyeshme, më e logjikshme dhe më afër synimit që përmban fitri. Produkti bazë të ne është gruri/mielli, e nëse ne e shpërndajmë miellin nëpër banesa kolektive ku shumica nuk kanë mundësi as ta përdorin për gatimin e bukëve, atëherë ku po mbetet synimi nga dhënia e sadekatul fitrit? Dhënia e sadekatul fitrit në të holla është shumë më e arsyeshme se sa dhënia e produkteve bujqësore, ngase kryefamiljari e di më së miri se çka i mungon në shtëpi dhe çfarë i duhet të blejë.

KATEGORITË TË CILAVE NUK U JEPET SADEKATUL FITRI

Të pasurit

E, përderisa të varfrit dhe të ngratët janë pjesëmarrës thuajse të paevitueshëm në pasurinë e sadekatul fitrit, për shkak të nevojave të tyre jetike, të pasurit përjashtohen nga kjo, ngase ata në realitet nuk kanë nevojë për një gjë të tillë dhe nuk mund të futen në asnjë mënyrë nën kategorinë përfituese të zekatit e as sadekatul fitrit. Kjo mund të dëshmohet edhe me tekste të prera, siç është hadithi i Muadhrit, ku i Dërguari i Allahut, e kishte porositur atë me fjalët: “...lajmëroi ata se Allahu ua ka bërë detyrim zekatin për të pasurit, i cili u kthehet skamnorëve të tyre...”⁵. Në një hadith tjetër thuhet: “Nuk lejohet sadakaja për të pasurin.”⁶

Të rinjtë me potencial pune

Në këtë kontekst, i Dërguari i Allahut, ka thënë: “Nuk do të hajë ushqim më të mirë askush sesa ai që e fiton me dorën e vet, Pejgamberi i Zotit, Davudi a.s., ka ngrënë vetëm nga ajo që e ka fituar me dorën e vet.”⁷ Njeriu nuk duhet të bëjë jetë parazitë, të presë gjithnjë nga të tjerët, por duhet të zbatojë metoda të ndryshme të përfitimit. Më i vlefshëm është fitimi që e bën njeriu vetë sesa kur kërkon lëmshën nga të tjerët. Transmetohet nga Ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, më mirë është që ndonjëri nga ju ta marrë litarin e të bartë mbi shpinën e tij dru sesa të vijë e të kërkojë (lëmshë) nga ndokush, pavarësisht nëse i jep apo jo.”⁸ Në këtë kontekst, është e rëndësishme të përmendet një ngjarje nga periudha e ndritshme e Omerit, të birit të Hatabit, ku gjersa kalonte pranë një rruge, pa një të ri që kishte shtrirë dorën dhe kërkonte lëmshë nga njerëzit. I habitur nga gjesti i tij dhe i zemëruar tejmasë, mori kamxhikun dhe filloi ta godasë atë, e më pas i tha: “O djalosh, mos na e shëmto fenë!” Mesazhi i Omerit nënkupton se të rinjtë me mundësi dhe potencial

pune, duhet të angazhohen e të punojnë, e jo të bredhin rrugëve duke kërkuar lëmshë nga të tjerët. Në këtë kontekst, disa nga malikitë janë të mendimit se personi që ka mundësi të punojë, e që është i varfër, nuk i lejohet dikujt që t'ia dedikojë zekatin e as sadekatul fitrin atij, për shkak se ai ka mundësi për punë, por është neglizhent dhe nuk punon, ndonëse ka potencial dhe mundësi për të gjetur punë.⁹ Ky mendim nuk mund të thuhet që është ekstrem, madje tekstet fetare dhe rregullat e fesë qëndrojnë në të njëjtën vijë, për shkak se Islami, është fe që nxit dhe inkurajon punën dhe lufton "fitimin" duke shtrirë duart në pritje të mëshirës nga të tjerët. Islami qartë porositi në angazhim dhe punë, ku përmes gjuhës së të Dërguarit të Allahut thotë: "Nuk lejohet sadakaja obligative (zekati dhe sadekatul fitri) për të pasurin dhe për të fuqishmin me trup të shëndoshë (atë që ka mundësi të punojë)." (Transmetojnë të gjitha koleksionet).

Afërsia familjare

(fëmijët për prindër dhe anasjelltas)

Në parim, nuk lejohet që fëmijët t'ua japin zekatin e as sadekatul fitrin prindërve të tyre, gjyshit, gjyshes e më lart (nëse ekziston), sikurse që nuk u lejohet prindërve ta japin zekatin për fëmijët e tyre, vajzave apo djemve, e as nipit e mbesës.

Kur themi se nuk lejohet dhënia e tyre për prindër dhe fëmijë, kjo për faktin se prindërit duhet të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t'i mirëmbajnë ata, sikurse edhe fëmijët që e kanë obligim t'i mirëmbajnë prindërit e tyre. Një beduin erdhni tek i Dërguari i Allahut dhe i tha: "Unë kam pasuri dhe një fëmijë, e babai im dëshiron ta merr mallin-pasurinë time." Atëherë i Dërguari i Allahut i tha: "Ti dhe pasuria jote janë të babait tënd."¹⁰

Parimisht, dhënia e sadekatul fitrit dhe zekatit, edhe po të lejohej për prindër dhe fëmijë, nuk do të ishte zgjidhje adekuate për ta, sepse nuk do të ofronte ndonjë alternativë për mënjanimin e varfërisë së tyre, kur dihet se dhënia e tij është një herë në vit, prandaj, si do ta mënjanonin ata varfërinë e tyre me një shumë simbolike një herë gjatë një viti. Mirëpo, i Madhërishmi kërkoi që prindërit të kujdesen për fëmijët e tyre dhe t'i mirëmbajnë ata, sikurse që kërkoi edhe nga fëmijët që mos t'i harrojnë mirësitë e prindërve të tyre dhe të jenë në shërbimin e tyre sipas nevojave të tyre, e jo të bëhen mosmirënjohës dhe mos të kujdesen për ta.

Ibën Mundhiri, në lidhje me sadekatul fitrin dhe zekatin për prindër ka thënë: "Dijetarët janë të një mendimi (ixhma) se ai nuk lejohet të jepet për prindër, ndaj të cilëve kërkohet furnizimi (e jo zekati), ngase dhënia e zekatit të tij për ta largon furnizimin prej tij, e në këtë kontekst dhënia e zekatit për ta llogaritet sikurse dhënia e zekatit ndaj vetes, e kjo assesi nuk lejohet..."¹¹

Përderisa zekati dhe as sadekatul fitri nuk lejohet për prindër nga fëmijët e tyre, nuk lejohet as anasjelltas, ngase edhe këta të fundit janë pjesë përbërëse e tyre dhe se juristët

e kanë konsideruar dhënien për bijtë nga baballarët, sikurse njeriu për vetveten, gjë e cila nuk lejohet.

Ndërsa në rastet e tjera, kur dikush dëshiron të jap zekatin apo sadekatul fitrin për vëllain, motrën, dajën, hallën e të ngjashme, është një temë ku jepen mendime të ndryshme, disa e ndalojnë ngase e llogarisin si familje që nevojitet një përkujdesje dhe ndihmë e vazhdueshme ndaj tyre e jo vetëm një ndihmë simbolike si sadekatul fitri, përderisa disa të tjerë e lejojnë. Mirëpo një gjë nuk duhet neglizhuar këtu, kur vëllai e jep qoftë sadekatul fitrin apo edhe zekatin për motrën e vet, a nuk është nënçmim që anëtari më i afërt i familjes së tij të mbetet nën mëshirën e fitrave, kur dihet se ajo shumë është simbolike dhe nuk e zgjidh problemin e dertëve të tij. Atij me këtë ndihmë mund t'i bëhet një zgjidhje për Bajram, por jo më tepër. Vëllai e ka obligim të kujdeset për anëtarët e tjerë të familjes, e jo t'i lë ata nën "mëshirën" e fitrave dhe zekatit.

Bashkëshorti për bashkëshorten dhe anasjelltas

Parimisht, burri e ka për obligim të kujdeset për gruan e tij. Ai është përgjegjës në mirëmbajtjen dhe furnizimin e saj. Ai njëherësh edhe konsiderohet kujdestar për të dhe atij i takon t'ia sigurojë dhe plotësojë kushtet ekonomike. Në këtë aspekt, gruaja nuk e ka obligim të punojë dhe të fitojë për mirëmbajtjen e familjes, ngase ky obligim i takon burrit dhe është nën përgjegjësinë e tij, mirëpo nëse ajo punon, atëherë nuk ka gjë të keqe dhe mund t'i ndihmojë bashkëshortit të saj në sigurimin e kushteve materiale. Islami, dy bashkëshortët i trajton si një tërësi e pandashme, ashtu siç i trajton fëmijët me prindër.

Këto ishin disa kategori që nuk u jepet sadekatul fitri, edhe pse në praktikë te ne ky obligim jepet edhe për anëtarët më të ngushtë. Sidoqoftë, është mirë që familjarët të kujdesen për njëri-tjetrin vazhdimisht gjatë tërë vitit e të mos e kujtojnë njëri-tjetrin gjatë Ramazanit apo gjatë Bajramit, ngase edhe ajo ndihmë nuk ua zgjidh problemet atyre.

- 1 Mejdani, El Lubab fi sherhi l kitab, me recensim nga Said Bekdash, Daru-s Siraxh, Medine, bot. I, 2010, v. II, f. 365.
- 2 Ebu Davudi në Sunen, nr. 1609.
- 3 Buhariu në Sahih, nr. 1503; Muslimi në Sahih, nr. 984.
- 4 Buhariu në Sahih, nr. 1510; Muslimi në Sahih, nr. 985.
- 5 Buhariu në Sahih, nr. 1458.
- 6 Transmetojnë të gjithë, me përjashtim të Ibën Maxhes dhe Nesaiut.
- 7 Buhariu në Sahih, nr. 2072.
- 8 Buhariu në Sahih, nr. 1377; Maliku në Muvetta, nr. 1588.
- 9 Dusuki, Hashijetu'd Dusuki ale'sh Sherhi'l Kebir, vëll. I, f. 1494.
- 10 Bejhëkiu në Sunen el Kubra.
- 11 Ibën Kudame, El Mugni, bot. i III, Dar el Menareh, Kajro-Egjipt, vëll. II, f. 647.

E drejta e institucioneve fetare në përcaktimin e prioriteteve brenda fondeve të zekatit

Flurim Krasniqi

Kategoritë përfituese të zekatit janë të përcaktuara në mënyrë ekskluzive nga Allahu xh.sh. në ajetin e 60-të të sures Et Teube, ku thuhet: *“Allahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’u takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të mjerëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhet përfituar zemrat (të dobëtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. Allahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet.”* (Et Tevbe, 60).

Ky ajet tregon se një përcaktim i tillë është i prerë, i padiskutueshëm, i pandryshueshëm dhe se zekati duhet të jepet vetëm brenda këtyre kategorive të përcaktuara nga Allahu xh.sh., dhe nuk lejohet që të ndahet jashtë tyre. Për këtë çështje ka konsensus të dijetarëve të të gjitha kohërave. Ajo që ka nxitur diskutime mes dijetarëve ka qenë çështja se a është obligim që zekati të ndahet në të gjitha kategoritë e

përmendura në Kuran apo lejohet që të caktohen prioritete në mes të këtyre kategorive.

Sa i përket kësaj çështje, dijetarët ndahen në dy grupe: grupi i parë, e që është mendimi i shumicës (xhumhurit) së dijetarëve të shkollave juridike, është se lejohet që të caktohen prioritete mes grupeve dhe se grupet e përmendura në Kuran janë potencuar si kategori të mundshme përfituese të zekatit, por jo si obligative që zekati të ndahet në të gjitha kategoritë. Grupi i dytë, e që është mendimi i shkollës juridike të Imam Shafiut, thekson se është obligim që zekati të ndahet në të gjitha kategoritë dhe nuk lejohet që të eliminohet ndonjëra nga këto kategori gjatë shpërndarjes së zekatit.

Lidhur me këtë çështje, dijetari bashkëkohor, dr. Jusuf Kardavi, ka thënë: *“Nuk është obligative që ndarja të bëhet e barabartë për të gjitha grupet, por nëse ekzistojnë të gjitha grupet e përmendura në Kuran dhe nevojat e të gjitha grupeve janë të njëjta, atëherë nuk lejohet që të eliminohet ndonjëra prej tyre. Përveç kësaj, lejohet që t’i ndahet vetëm një kategori nëse ekziston ndonjë arsye për realizimin e ndonjë qëllimi apo interesi të përgjithshëm fetar.”*¹

Cilido nga mendimet të pranohet, rrjedhimisht shtrohet një pyetje: Kush është përgjegjës që të realizojë këtë shpërndarje, individ apo institucioni? Nëse e pranojmë qëndrimin e parë, që të përzgjidhen në mes kategorive duke caktuar prioritete, përsëri shtrohet pyetja: Kush është përgjegjës që të caktojë se cila prej atyre kategorive, një apo më shumë prej tyre, është pikërisht ajo që cilës duhet ndihmuar me zekat? Ndërsa, nëse e pranojmë qëndrimin e dytë, që secilës kategori t’i jepet një pjesë e zekatit, atëherë si të



realizohet, sepse të kërkohej prej individëve të cilët e japin zekatin që t'i kërkojnë të gjitha tetë kategoritë, nëse asgjë tjetër, të paktën është e paarsyeshme. Sido që të jetë, në të dyja rastet nënkuptohet ekzistimi i udhëheqjes organizative të aksionit të grumbullimit dhe distribuimit të zekatit, dhe se individi nuk mund ta bëjë një gjë të tillë.²

Lidhur me këtë çështje, dr. Jusuf Kardavi, ka thënë: “Zekati nuk duhet të shpërndahet vetëm te të varfërit, por ka edhe kategori të tjera të interesit të përgjithshëm e që individi nuk mund të bëjë një verifikim dhe vlerësim të këtyre kategorive, por këtë duhet ta bëjë shteti (institucioni).”³ Mbështetur në këto që u thanë më lart, mund të përfundojmë se për përparësinë e një kategorie ndaj tjetrës duhet të kujdeset pushteti islam kompetent. Në shtetet islame këtë e bën qeveria, kurse atje ku nuk ka shtet islam, këtë përcaktim e bën institucioni legjitim fetar që është përgjegjës për organizimin e jetës fetare në vend dhe i cili është bartës i drejtpërdrejtë i prerogativave të halifes.⁴

Kjo e drejtë e institucioneve fetare në përcaktimin e prioriteteve është legjitime, e mbështetur në parime të përgjithshme islame dhe assesi nuk paraqet shkelje apo devijim nga parimet shariatike. Kështu kishte vepruar edhe Omeri r.a. në kohën e tij, duke vendosur që të ndalohej dhënia e zekatit kategorisë “për përfitimin e zemrave”, duke vlerësuar se një veprim i tillë nuk është i nevojshëm, pasi shteti islam ishte forcuar dhe nuk kishte nevojë për njerëz të tillë.

BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS - INSTITUCIONI I VETËM LEGJITIM PËR MBLEDHJE, SHPËRNDARJE DHE ÇAKTIMIN E PRIORITETEVE TË ZEKATIT

Gjatë shtjellimit dhe elaborimit që i bëme deri këtu çështjes së zekatit, u kuptua qartë se mbledhja, shpërndarja, përcaktimi i prioriteteve dhe definimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me zekatin është e drejtë e shtetit islam. Në mungesë të përkujdesjes shtetërore, përgjegjësia për organizimin e çështjeve fetare, përfshirë edhe zekatin, është e drejtë ekskluzive e autoritetit fetar legjitim në vend.

Kjo e drejtë nuk është vetëm morale, por është e nxjerrë nga parimet kuranore, suneti dhe praktika e Pejgamberit a.s., si dhe e mbështetur nga mendimet e dijetarëve islam.⁵ Ajeti kuranor: “Merr prej pasurisë së tyre zekat...”, definon qartë se mbledhja e zekatit

është një funksion institucional publik dhe nuk bën të lihet në dorë të individëve apo grupeve të caktuara të interesit.

Në vendin tonë, kjo e drejtë dhe përgjegjësi i takon ekskluzivisht Bashkësisë Islame të Kosovës, si autoriteti i vetëm legjitim për organizimin dhe mbikëqyrjen e jetës fetare në vend. Ky institucion, gjatë gjithë historisë sonë, ka qenë faktor kyç në organizimin dhe koordinimin e jetës fetare në vend, duke kontribuar në ruajtjen e identitetit tonë fetar dhe kombëtar.

Përmes organizimit të centralizuar të mbledhjes së zekatit, Bashkësia Islame e Kosovës arriti që të themelojë dhe mirëmbajë institucionet arsimore fetare si: Medreseja “Alauddin” në Prishtinë dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë. Nga këto institucione të dijes dhe edukimit dolën shumë kuadro fetarë dhe intelektualë të përgatitur, që kontribuan në vetëdijesimin fetar dhe kombëtar, si dhe në orientimin e drejtë dhe të duhur të popullit tonë.

Medreseja e mesme “Alauddin” ka qenë vatër strehimi dhe vatër shkencore në periudhën e paraluftës, si dhe gjatë okupimit serb. Kjo vatër ka qenë gjithashtu edhe një lloj universiteti i dytë pas Universitetit të Prishtinës, ku studentët shqiptarë nga të gjitha viset shqiptare kanë ndjekur ligjëratat në mungesë të objektit të universitetit, dhe ka qenë strehë dhe objekt për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të tyre.⁶

Prandaj, edhe sot, për ta përmbushur këtë obligim sipas udhëzimeve kuranore dhe mësimëve të sunetit, si dhe për të garantuar dhe siguruar që ky aksion të menaxhohet drejt dhe të shkojë në vendin e duhur, rruga e vetme dhe legjitime është që kjo të bëhet përmes institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Aktivizimi i disa individëve dhe shoqatave për ta mbledhur zekatin në mënyrë të pavarur dhe pa një bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës bie ndesh me parimet dhe udhëzimet fetare dhe praktikisht krijon pasiguri, mungesë të transparencës dhe mundësi për keqpërdorim të këtyre fondeve.

Sa i përket pretendimit se kinse këto shoqata bamirëse janë prej kategorisë “vel amilune alejha”, kjo nuk është korrekte, ngase mbledhësi është vaxhib të autorizohet nga prijësi (udhëheqësi), e pastaj ky i fundit i jep hisen që i takon.⁷ Lidhur me këtë, Imam Neveviu, ka thënë: “Juristët e kanë trajtuar këtë tematikë dhe ata kanë konstatuar se udhëheqësi (halifja) i shtetit duhet t'i caktojë njerëzit për

“Zekati nuk duhet të shpërndahet vetëm te të varfërit, por ka edhe kategori të tjera të interesit të përgjithshëm e që individi nuk mund të bëjë një verifikim dhe vlerësim të këtyre kategorive, por këtë duhet ta bëjë shteti (institucioni).”



mbledhjen e zekatit, ngase vetë i Dërguari i Allahut i kishte caktuar dhe dërguar shokët e tij për mbledhjen e zekatit. Kështu vepruan edhe kalifët që erdhën pas tij, dhe kjo gjë është shumë e njohur.”⁸

Kësaj duhet shtuar edhe faktin se, nga paslufta, shumë organizata dhe shoqata të ndryshme që kanë mbledhur zekat dhe para nga xhemati në emër të ndihmës dhe aktiviteteve fetare, sot nuk ekzistojnë dhe askush nga ne nuk e di se çfarë ka ndodhur dhe ku kanë përfunduar ato mjete.

Prandaj, është obligim për të gjithë xhematin, e posaçërisht për strukturat udhëheqëse dhe të gjithë nëpunësit e Bashkësisë Islame të Kosovës që të punojmë me një përkushtim të madh në vetëdijesimin e xhematit për dhënien e zekatit përmes institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Dijetari Husein ef. Gjoza ka thënë: “Ne nuk kemi autoritet të mbledhim me forcë zekatin dhe sadekatul fitrin, por duam t’ua shpjegojmë myslimanëve se Bashkësia Islame, nga pikëpamja e Sheriatit, ka të drejtën ekskluzive për të organizuar mbledhjen e këtij donacioni fetar dhe për të përcaktuar përparësinë e fondeve për qëllimet për të cilat duhet dhënë dhe shpenzuar.”⁹

FONDI “FI SEBILILAH – NË RRUGËN E ALLAHUT” – PRIORITETI I KOHËS NË KOSOVË

Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, në kuadër të përgjegjësisë dhe detyrimeve fetare për organizimin dhe menaxhimin e fondit të zekatit dhe pasurisë së përgjithshme që besimtarët myslimanë japin për hir të Zotit, prej shumë vitesh ka përcaktuar që prioritet për destinimin e këtyre fondeve të jetë fondi “Fi sebililah – në rrugën e Allahut”, me theks të veçantë në mbështetje të institucioneve arsimore fetare në Kosovë si: Medresesë “Alauddin” dhe Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, por edhe ndihmë ndaj të varfërve si dhe mbështetje në organizimin dhe menaxhimin e jetës fetare në vend.

Ky përcaktim i Bashkësisë Islame të Kosovës ka qenë dhe mbetet një vendim strategjik, i mbështetur në nevojat dhe rrethanat e kohës, duke synuar ruajtjen dhe forcimin e jetës edukative, arsimore dhe fetare në vend.

Institucione arsimore fetare në vend si: Medreseja, Fakulteti i Studimeve Islame, Instituti i Hifz-it, nuk kanë ndonjë përkrahje të qëndrueshme nga fondi shtetëror apo ndonjë fond tjetër, por që nga themelimi i tyre kanë mbijetuar dhe vazhdojnë të funksionojnë falë mbështetjes së xhematit tonë që ka dhuruar zekatin, sadakatul fitrin dhe ndihmat e tjera në mbështetje të këtyre institucioneve. Pra, duke pasur parasysh mungesën e burimeve të qëndrueshme financiare dhe sfidat me të cilat po përballen këto institucione, dhënia e zekatit dhe ndihmave të tjera në mbështetje të këtyre institucioneve është prioritet dhe domosdoshmëri e kohës sonë.

Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës kërkon që zekati dhe sadakatul fitri të derdhen në mbështetje të këtyre institucioneve, që janë burim i jetës fetare dhe i ngritjes arsimore dhe edukative të myslimanëve. Andaj, myslimanët në Kosovë dhe në diasporë janë të obliguar të bashkohen në këtë aksion unik të mbledhjes së zekatit dhe sadakatul fitrit, të udhëhequr nga Bashkësia Islame e Kosovës.¹⁰

Ky aksion në këtë moment duhet të jetë obligimi ynë më i madh karshi të ardhmes sonë, në të cilën duhet të kemi familje të shëndoshë, xhemat kompakt, institucion të organizuar, punë të ndërgjegjshme dhe edukim e arsimim të mirë. Nëse nuk e bëjmë këtë, ne nuk mund të mbijetojmë, pasi nuk kemi ndihmë tjetër për financimin dhe mirëmbajtjen e këtyre institucioneve.¹¹

- 1 Beytullah Aktas, *Kur'ana Gore Zekatin Harcama Kalemeleri*, (Doktora tezi), f.173.
- 2 Ahmeti, Muhidin, *Rëndësia e organizimit dhe e menaxhimit të aksionit për grumbullimin dhe distribuimin e zekatit (zakatul fitrit)* <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=9490>
- 3 Jusuf Kardavi, *Adhurimet në Islam*, f. 274.
- 4 Grup autorësh, *Zeqati dhe Sadekatul fitri*, f. 31-32.
- 5 Sinani, Ajni, *Zekati dhe sadekatul fitri të jepen në fondin e Bashkësisë Islame të Kosovës*, Dituria Islame, nr. 341, f. 4.
- 6 Bahtiri, Kenan, *Roli i institucionit të Bashkësisë Islame dikur dhe sot*, Dituria Islame, nr. 287, f. 52.
- 7 Muhamed Maxhid Itri, *Fikhu Hanefi, Agjërimi, Zeqati dhe Haxhi*, f. 83-86.
- 8 Haziri, Ejup, *Zekati ndaj mbledhësve të tij*, Dituria Islame, nr. 269, f. 37
- 9 Husein Djoza, *Izabrana djela, “Islam – Zekat”*, 1/377, <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=3439>, përktheu dhe përshtati N. Ibrahim nga Burimi: *Dr. Senad Čeman, Problem parainstitucionalnog zekata*, në: <https://www.medzlisrijepolje.org/2020/05/08/problem-parainstitucionalnog-zekata/>.
- 10 Sinani, Ajni, *Zekati dhe sadakatul-fitri të jepen në fondin e Bashkësisë Islame, Dituria Islame*, nr. 365, f. 4.
- 11 Ahmeti, Muhidin, *Rëndësia e organizimit dhe e menaxhimit të aksionit për grumbullimin dhe distribuimin e zekatit (zakatul-fitrit)* në <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=9490>

Kuptimi i kaderit në akiden islame

Dr. Bahri Hoxha

Ç'ËSHTË KADAJA DHE KADERI

Kada është shprehje nga gjuha arabe, që ka kuptimin e përcaktimit, veprimt, gjykimit etj.. Në akiden islame, ky term tregon vendimin e Zotit në Ezel (pafillimësi) për të shfaqur diçka në ekzistencë.¹ Ose siç e përkufizon Imam el Xhurxhani: “Vendimi i Zotit xh.sh. në pafillimësi, për gjendjen e krijesave deri në përjetësi.”² Kurse fjala kader në gjuhën arabe, po ashtu ka kuptimin e përcaktimit, matjes, kufizimit etj.. Përderisa në terminologjinë e akides islame tregon për realizimin e ngjarjeve në praktikë, sipas vendimit të Zotit xh.sh. në Ezel (kadasë).³ Pra, përderisa shprehja kada, tregon për vendimin e Zotit në Ezel⁴ që diçka të krijohet, nocioni kader, tregon për realizimin në aspektin vend-kohë të atij vendimi.

ARGUMENTET TEKSTUALE RRETH KADERIT

Në Kuranin famëlartë gjenden shumë ajete që flasin për kadanë dhe kaderin, siç është ajeti: “Ne, çdo gjë e kemi krijuar në masë të caktuar (kader).” (Kamer, 49); “Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë dhe as te vetvetja juaj, pa qenë e shënuar në Librin (Leuhi Mahfudh), para se Ne ta sjellim atë në ekzistencë. Kjo është shumë e lehtë për Allahun.” (El Hadid, 22); “Kur përcakton diçka (kada), vetëm i thotë bëhu dhe ajo bëhet.” (Merjem, 35); “Ju nuk mund të dëshironi (veproni) përveç nëse do Allahu Zoti i botëve.” (Tekvir, 29).

Kurse në Sunetin e Muhamedit a.s., po ashtu është përmendur kaderi në shumë hadithe. Në hadithin e njohur si hadithi i Xhibrilit, të cilin e transmeton Omeri r.a.,

Pejgamberi a.s., thotë: “Imani është të besosh Allahun, melaqet e Tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, Ditën e Fundit dhe në kaderin, qoftë i mirë apo i keq, e gjitha është prej Allahut të Lartësuar.”⁵

Transmeton Muslimi nga Hudhejfe ibën Usejdi, se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Katërdhjetë ditë pasi të formohet embrioni, melaqja e Zotit i ofrohet embrionit dhe thotë: O Zot, besimtar (do të jetë), apo jobesimtar?! Dhe shkruhet. Femër, apo mashkull?! Dhe shkruhet. Po ashtu shkruhet edhe vepra e tij, ndikimi i veprës, jetëgjatësia dhe resku (furnizimi). Pastaj mbyllet libri i tij dhe as nuk shtohet përtej saj dhe as nuk pakësohet.”⁶

Transmeton Imam Ahmedi dhe Ebu Davudi nga Ubade ibën Samiti t'i ketë thënë djalit të tij: “O biri im, nuk do ta gesh ëmbëlsinë e besimit, derisa ta dish se ajo që të ka ndodhur, nuk ka mund të të mos ndodh, por edhe ajo që nuk



të ka ndodhur, nuk ka mund të të ndodh. E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: “Krijesën e parë që e ka krijuar Allahu ishte lapsi, Zoti i tha: “Shkruaj! O Zot, çfarë të shkruaj? Tha: “Shkruaj përcaktimet e çdo gjëje derisa të ndodh Kiameti!”. O biri im, e kam dëgjuar të Dërguarin a.s. të thoshte: “Kush vdes me besim tjetër përveç kësaj, nuk është prej meje.”⁷

Po ashtu Pejgamberi a.s. i drejtohet Ibni Abasit, duke i thënë: “O djalosh! Do të të mësoj disa fjalë: Ruaje (të drejtën e) Allahut që edhe Ai të ruajë ty! Ruaje (të drejtën e) Allahut që ta kesh gjithnjë afër! Kur të kërkosh, kërkije prej Allahut. Kur të kërkosh ndihmë, kërkije prej Allahut. Duhet ta dish që sikur mbarë gjithësia të mblidhet për të të bërë një të mirë, mund ta bëjnë atë vetëm nëse e ka shkruar Allahu. Gjithashtu, nëse mbarë gjithësia mblidhet për të të dëmtuar, mund ta bëjnë këtë vetëm nëse e ka shkruar Allahu. Lapsat janë ngritur (është dhënë vendimi) dhe fletët janë tharë (ka përfunduar çështja).”⁸

Gjithashtu thotë: “Allahu i ka shkruar masat e çdo gjëje – kaderin, pesëdhjetë mijë vjet pra se të krijonte qiejt dhe Tokën.”⁹

SI TA KUPTOJMË DREJT KADERIN

Rruga më e lehtë për ta kuptuar kaderin – përcaktimin e veprave, është rruga e cila çon në definimin e kuptimit real me të cilin tekstet islame e përdorin nocionin kader. Tekstet islame, përmes besimit në kader kanë për qëllim të japin shenjë në dy gjëra kryesore:

E para: Se njeriu dhe kushdo nga krijesat nuk mundet të veprojë asgjë, përveçse brenda kufijve të realizimit të cilët ia ka mundësuar Allahu xh.sh., sepse nuk ka pushtet real, përveç pushtetit të Allahut xh.sh.. Dhe pjesë e atij pushteti është edhe vendi dhe koha e veprimit njerëzor. Prandaj veprimi njerëzor nuk e ka autonominë e të realizuarit përtej kufijve të përcaktuar nga Allahu xh.sh..

E dyta: Se Allahu xh.sh., ka ditur me saktësi absolute çdo veprim të çdo krijese ende pa i krijuar ato. Kjo është e thjeshtë për t’u kuptuar kur kemi parasysh se krijesat janë të Tija dhe veprimet që burojnë nga to, janë po ashtu krijim i Tij xh.sh.. Prandaj themi se kaderi ka

Zoti xh.sh.,
përmes kaderit
dëshiron të na
mësojë për
saktësinë e
Dijes së Tij, e
jo të na
imponojë në
veprimet tona.
Nuk ka asnjë
shenjë
imponimi në
tekstet e
kadasë dhe
kaderit, por ka
shfaqje të
Madhështisë
hyjnore dhe
informim për
precizitetin e
Dijes së Zotit
në Pushtetin e
Tij xh.sh..
Përndryshe,
ku do të gjente
njeriu një vend
të vepronte
diçka, e të
supozohej se ai
vend nuk është
pjesë e
pushtetit të
Allahut
xh.sh.?!
?

qëllim që njeriut t’i dëshmojë madhështinë e Allahut xh.sh. përmes dijes së Tij absolute.

Nga këtu themi se rruga për ta kuptuar kaderin e Zotit xh.sh. është përmes kuptimit të asaj se çdo gjë është në Dijen e Zotit xh.sh. para se të krijohet.¹⁰ Atë Dije absolutisht të saktë, Zoti xh.sh., e ka urdhëruar lapsin ta shkruaj, po ashtu ende para se të krijonte qiejt dhe tokën siç e dëshmuam tekstet fetare sipër. Dhe rezultati, nuk mund të dal ndryshe, përveçse realizimi i gjërave do të jetë i përputhshëm në çdo detaj me Dijen paraprake të Allahut xh.sh.. Nga këtu themi se kaderi i Zotit, i përmendur në tekstet fetare islame, qenka realizimi i gjërave dhe fenomeneve, pikërisht siç i ka shkruar Allahu xh.sh. para se t’i krijonte krijesat, shkrim ky i cili është i bazuar në Dijen Absolute të Krijuesit. E tërë kjo si shenjë për madhështinë e Krijuesit xh.sh., i Cili, kur thotë se diçka do të realizohet në një formë të caktuar, nuk ka mundësi assesi që Dija e Tij, të mos jetë e saktë. Përkundrazi, vetëm Dija e Tij është dije reale, përderisa njohuritë e krijesave të Tij konsiderohen dije parciale dhe jo gjithëpërfshirëse.

Me një fjalë, sikur Zoti xh.sh., përmes kaderit dëshiron të na mësojë për saktësinë e Dijes së Tij, e jo të na imponojë në veprimet tona. Nuk ka asnjë shenjë imponimi në tekstet e kadasë dhe kaderit, por ka shfaqje të Madhështisë hyjnore dhe informim për precizitetin e Dijes së Zotit në Pushtetin e Tij xh.sh.. Përndryshe, ku do të gjente njeriu një vend të vepronte diçka, e të supozohej se ai vend nuk është pjesë e pushtetit të Allahut xh.sh.?! A do mund të vepronte ndonjë vepër pa dijeninë e Allahut xh.sh.?! Apo mos vallë do të kishte forcë të pavarur robi, me të cilën vepron jashtë pushtetit të Zotit Fuqiptotë?! Kurrsesi, njeriu vepron gjithnjë i varur nga forca që Zoti i dhuron. Është vetëm Allahu krijuesi i çdo gjëje, përfshirë edhe i veprave të njeriut.

LUTJA PËR NDRYSHIM TË KADERIT DHE ANGAZHIMI

Kaderin ne njerëzit nuk mund ta dimë, derisa gjërat të ndodhin dhe ngjarjet të realizohen. Atëherë kur ndodhitë të kenë ngjarë, vetëm atëherë njeriu ka mundësi ta “lexojë” kaderin. Sepse, për ne njerëzit, kader

është gjithë çfarë ka ndodhur tashmë. Por njeriu ka mundësi ta pres një kader të dëmshëm për të, në këtë rast shprehja “kader” përdoret si alegori për të treguar frikën për një kader të rëndë. Sindiu, në shpjegimin e tij ndaj Sunenit të Ibën Maxhes, përcjell fjalët e Imam Gazalit se besimtari përmes lutjes e cila po ashtu është pjesë e kaderit, krijon raport të mirë me Zotin e tij dhe kjo i bën që mos ta ndiejë peshën e kaderit (të rëndë).¹¹ Kjo është për qëllim kur përmendet në hadith se duaja e ndryshon kaderin, d.m.th. duaja e ndryshon atë e cila i ka shanset shumë të larta që të ndodhë dhe jo ta ndryshojë kaderin që tashmë ka ndodh, sepse nuk ka kuptim të lutemi që të ndryshojnë ndodhitë e mëparshme, përderisa ato tashmë janë realizuar dhe nuk mbetet vend për ndryshim. Hadithi që përmend ndryshimin e kaderit, përmban një dozë të madhe shprese për të formësuar te besimtari një personalitet pozitiv, që mos të dorëzohet asnjëherë para të keqes dhe dështimit, në mënyrë që t'i lutet Zotit për mirë, kurse vetë lutja vendin e ka pas angazhimit, sepse ajo s'ka kuptim pa angazhim, kështu që del se, përmes besimit në kader, ruhet vazhdimësia e përpjekjes dhe lutjes për mirë. Pra, besimi në kader është shtytës për veprim, angazhim e punë dhe assesi neglizhim e dembelizëm.

KRIJIMI I VEPRAVE DHE AUTORËSIA E VEPRIMIT

Në rrafshin doktrinar, duhet të dimë të bëjmë bashkimin në mes dy realiteteve, të cilat te disa njerëz perceptohen si të kundërta, por ato nuk janë të tilla:

E para: Veprimi njerëzor është derivat i krijesës njeri dhe derivati i krijesës patjetër që është i krijuar. Në këtë kontekst cilësohet si krijesë e Allahut xh.sh. në kuptimin e ekzistencës dhe shpikjes.

E dyta: Autorësia e veprës njerëzore i përket vetë njeriut. Njeriu është ai që ndërmerr dhe vepron veprën.

Atëherë, si do të bëhej unifikimi real dhe logjik, në mes këtyre dy perceptimeve? Kjo, në fakt, ka shpërqendruar një masë të madhe autorësh të cilët kanë shkruar në lëmin e akaidit përgjatë historisë së shkencës. Sepse njerëzit e kishin bukur të vështirë të definojnë vijën ndarëse në mes të krijimit hyjnor dhe autorësisë njerëzore, për të njëjtin veprim. Siç e kemi thënë edhe në shkrime të tjera, sa herë që kontakton hyjnorja me njerëzoren shfaqen vështirësi për kuptimin e vijës ndarëse në mes të dy aspekteve. Dhe kjo, jo për faktin se nuk e kuptojmë njerëzoren, por pikërisht për faktin se nuk kemi kapacitet të perceptojmë realitetin hyjnor.

KEKUPTIMET RRETH KADERIT (XHEBRIJE¹² DHE KADERIJE¹³)

Nga moskuptimi i drejtë i kësaj shfaqen dy fraksione kryesore, njëri pretendon se ne nuk kemi liri në të vepruar, porse në çdo gjë jemi të imponuar sikurse lëviz fleta në ajër,

pa pasur fare liri zgjedhjeje në veprimet tona. Ky fraksion quhet xhebrije (imponuesit). Dhe grupi tjetër, i cili mban ekstremin e kundërt të grupit të parë, i cili pretendon se ne jemi të lirë plotësisht në veprimet tona, deri në atë masë sa që njeriu “krijon” veprat e veta dhe jo Zoti. Kjo rrymë ideologjike quhej kaderije (mohues të kaderit). Të dyja këto ekstreme konsiderohen tek Ehli Suneti si fraksione të devijuara dhe qëndrimet e tyre si të papjekura shkencërisht dhe fetarisht, pikërisht për faktin se qasja e tyre ndaj leximit të teksteve fetare, ishte shumë selektive dhe jo e plotë. Merrnin disa tekste dhe lenin disa të tjera. Xhebritët u argumentuan vetëm me argumentet që flasin për kaderin dhe lanë anash argumentet që flasin për lirinë njerëzore, kurse kaderitë bënë të kundërtën.

QËNDRIMI I EHLI SUNETIT

Dijetarët e tri shkollave të Ehli Sunetit, asaj maturidite¹⁴, esharite¹⁵ dhe hanbelite¹⁶, mbajnë qëndrim të arsyeshëm dhe mesatar, duke përfshirë të gjitha tekstet fetare në shpjegimin e lirisë njerëzore në relacion me përcaktimin hyjnor. Ky qëndrim përfshin konfirmimin e kaderit ashtu siç e përshkruajnë tekstet fetare, duke mos e mohuar as lirinë njerëzore në kryerjen e veprave. Pra, njeriu ka liri për të zgjedhur veprimin dhe për këtë shpërblehet dhe ndëshkohet, varësisht prej llojit të veprës. Por kurdo që njeriu vepron, veprimi i tij, nuk konsiderohet krijim për veprën, por vetëm veprim, ose siç e quajtën në terminologjinë kelamiste (el kesb), që do të thotë: përfitim, ndërmarrje e veprimit. Këtë e thanë duke bazuar në një mori ajetesh kuranore: *“Allahu nuk ngarkon asnjë njeri përtej mundësive të tij, atij i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo (e keqe) që meritoi.”* (El Bekare, 286); *“Çfarëdo e keqe që ju godet ajo është pasojë e veprave tuaja.”* (Shura, 30).

Ky shpjegim u përmend nga Imam Ebu Hanife r.a.¹⁷ dhe u shpjegua më vonë nga Imam Eshariu dhe Imam Maturidiu më në detaje dhe sot paraqet shpjegimin autentik të Ehli Sunetit.

KADERI PËRFSHIN TË MIRËN DHE TË KEQEN

Disa njerëz menduan se prej Zotit vjen vetëm ajo që është e përshtatshme dhe e mirë për njeriun, kurse e keqja dhe ajo që nuk i përshtatet dëshirave njerëzore nuk është prej Zotit. Dhe një mendim i tillë është shumë i gabueshëm dhe tepër i rrezikshëm në rrafshin fetar, sepse natyrshëm shtrohet pyetja: Kush do ta krijonte të keqen? Nga kjo pikë, disa besime të shtrembëruara siç janë manevitet (thenevije-dysitët),¹⁸ pretenduan se ekzistojnë dy zota të pavarur; njëri është zoti i të mirës, kurse tjetri zoti i të keqes. Një pretendim i tillë politeist erdhi si pasojë e ndërlikohjes në mes të së keqes dhe Zotit, duke u munduar ta bëjnë shkëputjen e të keqes nga Zoti. Kështu ata ranë në diçka më të rrezikshme. Ide të



përafërta u shfaqen edhe brenda mendimit islam, sepse disa nga mutezilinjtë pretenduan se Zoti krijon vetëm të mirën, përderisa të keqen e krijojnë njerëzit vetë.

Përderisa sipas Ehli Sunetit vetëm Allahu është krijues dhe vetëm Ai krijon të mirën dhe të keqen. Krijon të mirën, udhëzimin, dritën, qetësinë, por krijon po ashtu edhe të keqen, humbjen, errësirën dhe trazimin që t'u njihet vlera të parave, përmes këtyre të fundmeve. Është pëlqimi i Tij kur robërit zgjedhin të mirën dhe nuk është pëlqimi i Tij kur njerëzit zgjedhin të keqen, ani pse të dyja i krijon vetëm Ai.

DOBIA DHE URTËSITË E BESIMIT NË KADA DHE KADER

Është e drejtë e secilit studiues të pyes, përse tekstet fetare i dhanë një rëndësi kaq të madhe besimit në kader, deri në atë masë sa besimin në kader, Pejgamberi a.s., e vendosi në mesin e shtyllave kryesore të imanit. Kjo kthehet pikërisht për shkak të përfitimit direkt të besimtarit si në aspektin e njohjes, po ashtu edhe në ndikimin pozitiv që ka besimi në kada dhe kader në aspektin psikik dhe emocional. Të besuarit në kada dhe kader është realizim i mëshirës së Zotit për besimtarin, sepse lidh ngjarjet në jetë me faktin se ato të gjitha janë me dijen e Zotit dhe me lejen e Tij. Përveç kësaj, çdo gjë që Allahu ka paraparë për ne, s'ka dyshim se është e mirë për ne, pa marrë parasysh nëse përshtatet me dëshirat tona apo nuk u përshtatet. Askush nuk do dikë më shumë se sa Allahu robin e tij besimtar, andaj çfarëdo që Ai ka paraparë

për robin e vet, robi mundohet të pajtohet në saje të besimit se kaderi i Allahut është vendimi më i duhur për të.

“Thuaj: “Nuk na ndodh neve asgjë, përveç asaj që Allahu ka përcaktuar për ne, Ai është Zoti jonë.” (Et Tevbe, 51).

Kur robi arrin në këtë nivel të raportit të tij me Zotin e vet, jeta e tij shndërrohet në një përjetim pozitiv, në të cilën ngjarjet përjetohen me një shije të veçantë.

PËRFUNDIMI

Nga ajo që u tha në temën e kaderit, kuptohet qartë se nga mëshira e Allahut për besimtarin është përfshirja e besimit në kader, në mesin e mësimave kryesore të cilat kërkohen për t'u realizuar besimi i drejtë. Përfitimet nga kjo përfshin aspekte të ndryshme në jetën e besimtarit. Kuptimi i drejtë në kada dhe kader çon në një besim të fortë dhe në një përjetim të bukur të ngjarjeve që ndodhin në jetë, e cila pastaj qetëson shpirtin e besimtarit dhe qetëson emocionet dhe psikikën e tij.

- 1 Te shkolla maturidite, kuptimi i këtyre termave është i kundërt, d.m.th: ajo që është kader te esharitë quhet kada tek maturiditë dhe anasjelltas. Kjo për shkak se tekstet fetare dhe gjuha arabe lejojnë të dy versionet e terminologjisë. Dallimi në mes dy shkollave është vetëm emërtimi dhe jo kuptimi i nocioneve. E kemi shpjeguar këtu sipas shkollës esharite për shkak se konsiderojmë që ky shpjegim në këtë temë, në vendin tonë, më shumë përdoret sipas kësaj shkolle.
- 2 El Xhurxhani, Sejjid esh Sherif, *Muxhemu Tarifat*, Darul Fedileh, Kajro, f.149.
- 3 Muxhemu tarifit, f. 146.
- 4 Shprehja “ezel”, është shprehje që tregon për Pafillimësinë, e cila i atribuohet vetëm Zotit.
- 5 Mutefekun alejhi.
- 6 Muslimi, nr. 2644.
- 7 Ahmedi, nr. 21990; Ebu Davudi, nr.4700.
- 8 Tirmidhiu nr. 2516; Ahmedi nr. 293; Bejhëkiu në *Shuab el Iman*, nr. 192.
- 9 Muslimi, nr. 2653.
- 10 Kështu e shpjegon Ebu Hanife ndër lidhur me Dijen e Zotit. Shih: El Bukharij, Alaudin, *Sherhul fikhil ekber*, Mektebetul Ganim, botim i parë, Aman, 2024, f. 135.
- 11 Shih: Sindi, Ebul Hasen el Hanefij, *Sherh Sunen ibën Maxheh*, pj.1, Darul Xhil, Bejrut, f. 46.
- 12 Rrymë apo fraksion islam që pretendonte se njeriu është i imponuar në veprimet e tij.
- 13 Rrymë apo fraksion islam, që mohonin përcaktimin e veprave (kaderin) në tërësi.
- 14 Neseffi, Mejmun, *Tebisiretul edile fi usuli din*, pj.1, El Mektebetul Ez'herije li turath, bot.1, Egjipt, 2011, f.102.
- 15 Shih: Lekani, Ibrahim, *Tuhfetul murid sherh xhevheretit Tevhid*, pj. 2, bot.1, Dar nurul mubin, Aman, 2016, f. 714-715.
- 16 Edhe hanbelitët kanë të njëjtin shpjegim sikur të dy shkollat kryesore të Ehli Sunetit: esharitët dhe maturiditët. Shih: Ibën Hamdan, Ahmed, *Nihajetul mubtediin fi usuli din*, Mektebet rrushd, bot 1, Riad, 2004, f. 40. Shih po ashtu: Sefarini, Muhamed bin Ahmed, *Levamiul envar el behije, ve sevatiul esrar el etherije*, pj.1, f. 292.
- 17 Shih: *Sherhul Fikhil Ekber*, f. 71.
- 18 Politeistët që besojnë se ekzistojnë dy zota të pafillimtë, zoti i dritës (të mirës) dhe zoti i errësirës (të keqes). Shih Shihristani, Muhamed ibën Abdulkerim, *El Milel ven Nihal*, bot.1, Mektebet Fejjad, Mensureh, 2013, f. 305-308.

Përulu që të lartësohesh!

Dr. Afrim Jusufi

Njeriu, kjo krijesa më e privilegjuar nën këtë nënqiell, është i vetëdijshëm se është krijuar për një qëllim të caktuar dhe se ka një objektiv dhe perspektivë para vetes, e jo të sillet vërdallë, të jetojë kot, pa qëllim, t'i nënshtrohet rastësisë, të veprojë çfarë të shohë e të dëgjojë dhe të imitojë pa vetëdije.

Në Librin e shenjtë thuhet: *“Nuk i krijova njerëzit dhe xhindet për asgjë tjetër, përveçse që të Më adhurojnë.”* (Kurani)

Sa të privilegjuar jemi ne sot, në këtë shekull, ngase e dimë arsyen pse jetojmë dhe pse frymojmë. Ne e kemi formulën se si të jetojmë me dinjitet në këtë gjithësi. Të gjitha i kemi të përgatitura dhe të gatshme nga të urtët, nga të dërguarit dhe pejgamberët, nga ata që bartën mesazhet hyjnore për t'i transmetuar te ne, të cilët jetuan për të na udhëzuar, për të na rëfyer dhe për të na orientuar drejt qëllimit.

Oj krijesa më e bukur, çfarë je duke kërkuar dhe kah je duke vrapuar? Mos vallë po përpiqesh të gjesh qetësinë, lumturinë, freskinë shpirtërore dhe materiale? Nëse po, eja pas meje dhe udhëto përmes këtij grumbulli shkronjash, përmes këtyre vargjeve, të cilat do të të shpien drejt paqes, lumturisë dhe kënaqësisë shpirtërore e materiale, atje ku lind drita në fund të tunelit, sado e errët të duket rruga.

Rruga që të shpie drejt paqes me veten tënde, me Krijuesin tënd dhe me të tjerët që të rrethojnë, është pikërisht ajo që qëndron në ballë të këtij titulli, qëndron në këtë material si në krye të oxhakut, në kryerresht: PËRULJA.

Eja të përulemi së bashku, sepse vetëm aty është shpëtimi; vetëm aty është qetësimi, relaksimi, pastrimi dhe çlirimi nga llumi që mban emrin dynja, e cila paraqitet si diçka e përhershme, e paprekshme dhe besnike, por a e di se ajo të tradhton dhe të lë në baltë pikërisht atëherë kur ke më së shumti nevojë? Të braktisë në momentet më kulminante, në çastet kur ndihesh më i fortë dhe më i sigurt. Prandaj mbështetu tek Ai që i ka krijuar të gjitha, sepse vetëm aty është siguria, qetësia, paqja dhe përjetësia.

Përulu që të lartësohesh!

Si të përulemi, kur artikulimi i kësaj fjale shpeshherë perceptohet si simbol i shembjes, dobësimit, nënçmimit dhe shkatërrimit?

E vërteta është se kjo frazë i drejtohet të përkohshmes, të kufizuarës, asaj që ka fillim dhe një ditë e pret fundi, sado i gjatë të jetë. Është përulje që i përket njerëzores, krijesës dhe krijaturës. Por jo, kjo nuk është esenca për të cilën po të thërras dhe po trajtoj, sepse qëllimi im është të të orientoj



drejt shpëtimit, lartësimit, fisnikërisë dhe arritjes së kuptimit se pse ecën mbi këtë tokë dhe cila është esenca e frymëmarrjes sate nën këtë nënqiell.

Jo, kjo përlulje për të cilën po të ftoj nuk i drejtohet të përkohshmes, por të përhershmes; nuk nënkupton të kufizuarën, por të pakufizuarën; jo krijesës, por vetëm Krijuesit.

Përlulu Atij që është pa fillim dhe pa fund; Atij që është i Madhi, Mëshiruesi, Furnizuesi, Mëshirëploti; Atij që nuk ka lindur dhe nuk është i lindur; Atij që është i Pari dhe i Fundit; Atij që është Ehadi, Samedit, Rrezaku, dhe ky varg vazhdon me më shumë se nëntëdhjetë e nëntë emra.

I përluluri, i leckosuri, flokëshprishuri dhe i papastërti janë cilësi që i atribuohen përluljes ndaj krijesës, të përkohshmes dhe të kufizuarës. Por ai që i përkulet të Përlulshmit, të Madhit dhe Krijuesit është i devotshëm, i lumtur, kuptimplotë, i zellshëm, i pasur shpirtërisht, përparimtar dhe i karakterit të lartë. Ai i përkulet vetëm Krijuesit, jo krijesës, por ka respekt për çdo të krijuar.

Krijesa më e bukur dhe më e lartësuar! Ti që Krijuesi të zgjodhi mbi shumë të tjera, edhe pse ka krijesa më të fuqishme se ti. Tërë krijaturën e Tij Ai e vuri në shërbimin tënd, që ti ta shfrytëzosh për nevojat dhe forcimin tënd. Dhe dije, o njeri, se pikërisht ty të emëroi mëkëmbës në tokë.

“Kujto kur Zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj në tokë një zëvendës.” (El Bekare, 30).

Krijesa më e bukur, vishu bukur, parfumohu, le të përshkojë uji i kthjellët duart, fytyrën, fjetet e flokëve e deri te këmbët tua, dhe drejtohu kah Meka e bekuar. Ashtu siç e drejtojmë fytyrën dhe qenien tonë kah ajo, le t'i lidhim fuqishëm edhe shpirtat tanë me të dhe shqipto fjalën Allahu Ekber, fjalë për të cilën je krijuar ta dëshmosh, dhe të cilën e dëshmon çdo krijesë, madje edhe guri e druri, secili në formën e vet.

Kjo përlulje duhet të të lartësojë drejt idealeve të larta të moralit, i cili sot është mjaft i brishtë, në një kohë kur kemi gjithçka, por na mungon pikërisht ai.

Krijuesi yt të thërret: *“...dhe fale namazin, sepse namazi largon nga veprat e shëmtuara dhe të këqijat.”* (El Ankebut, 45).

Pra, përlulja jote realisht duhet të të largojë nga e neveritura, nga amoralia, nga e shëmtuara, nga çnjerëzorja dhe nga dukuritë degjeneruese. A të ka larguar përlulja jote nga këto dukuri negative?

Kjo përlulje duhet të jetë frymëzim për tejkalimin e përditshmërisë së zymtë, për kapërcimin e vështirësive, stresit dhe padrejtësive të kësaj kohe. I Dërguari i Allahut a.s., kur ndihej i rënduar emocionalisht, i thoshte shokut të tij të bekuar Bilalit: “O Bilal, na qetëso me namaz.”

Përlulja ndaj Krijuesit është burim qetësie, force dhe suksesi. Ajo largon stresin, sjell paqe në zemër dhe të lidh drejtpërdrejt me Zotin.

Kjo përlulje duhet të shërbejë si frymëzim për arritje shkencore dhe avancime në sfera të ndryshme, veçanërisht në ato akademike, sepse të parët tanë, ata që shkruan historinë dhe vunë themelet e shumë shkencave që sot ekzistojnë, mbështetjen dhe inspirimin e gjenin pikërisht në përlulje ndaj Krijuesit, pra në namaz. Shembuj të tillë janë Ebu Hanifeja, Gazaliu, Ibën Sina dhe shumë të tjerë.

Përlulja jote të sjell qetësinë që sot mungon më së shumti; të largon stresin dhe ankthin, të çliron nga energjitë negative, sepse ti i përlulesh Atij që është Krijuesi i gjithçkaje dhe Ai të merr në përkujdesje.

A e di se kur përkulesh me ballë në tokë, realisht ngrihesh lart, deri në Sidretul Munteha, dhe në këtë përlulje je i lidhur drejtpërdrejt me Krijuesin e Tokës dhe të Qiellit?

Përlulu me gjithë shpirtin, qenien dhe dimensionin tënd shpirtëror Atij që të bëri të nuhasësh aromën, të dëgjosh tingujt dhe të shohësh ngjyrat, ndërkohë që dikush tjetër i ka të privuara këto begati.

Thuaj me gjithë qenien tënde: Elhamdulillah-Falënderimi i takon Zotit të botëve. *“Dhe thuaj: Falënderuar qoftë Zoti!”* (En Neml, 93).

Përlulja jote nënkupton falënderim, adhurim dhe respekt vetëm ndaj Atij që të solli në ekzistencë nga hiç gjëja.

Përlulu Atij dhe Ai do të të japë lumturinë e përjetshme.

Përlulu në pikën kulmore, aty ku balli yt prek tokën në sexhde, dhe shqipto: I Lartëmadhëruar je, o Krijues i Gjithësisë.

Dije se aty, në atë gjendje përluljeje, je më lart se në qiejt e lartë. Nëse aty, ku balli yt prek tokën, nuk ke gjetur qetësinë, mos e kërko askund tjetër, sepse gjithçka tjetër është kotësi.

Përlulu që të lartësohesh!

Në vend të përfundimit: nëse balli yt nuk gjen vend në sexhade, kërko çfarë të duash, por mos e kërko diku tjetër lumturinë, qetësinë dhe qëllimin e krijimit tënd, sepse nuk do t'i gesh.

Nëse e pranon dhe e zbaton këtë këshillë, ti po ndjek veprimin që e ka zanafillën te krijimi i babait tënd, Ademit, dhe që u konkretizua nga krijesat e dritës. Por nëse e refuzon këtë përlulje, rrezikon të ndjekësh rrugën e të mallkuarit, i cili refuzoi të përlulej dhe u largua përjetësisht nga mëshira, falja dhe begatia e Tij.

Përlulu, se do të lartësohesh!

Përfitimet e faljes së namazit

Sead Ahmetaj

Feja është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në jetën e njeriut. Përmes besimit dhe praktikave që përmban, feja udhëzon të gjitha sjelljet e individit dhe i jep kuptim jetës së tij, ndërsa gjithashtu kontribuon ndjeshëm që personi të përballet me vështirësitë dhe të ruajë mirëqenien e tij shpirtërore. Për këtë arsye, një ndër çështjet kryesore të psikologjisë së fesë është pyetja nëse praktikatat fetare dhe adhurimet ndikojnë në mënyrën e përballimit fetar të individëve dhe në mirëqenien e tyre psikologjike, dhe nëse po, në çfarë drejtimi ndodh kjo.

Kaosi i jetës së përditshme, stresi intensiv që sjell bota moderne dhe lodhja mendore ndikojnë ndjeshëm në shëndetin shpirtëror dhe mendor të njeriut. Në këtë ritëm të shpejtë, bëhet i pashmangshëm kërkimi i një strehe ku individ mund të rikuperohet, të gjejë qetësinë e brendshme dhe ta rregullojë mendjen e tij. Pikërisht në këtë pikë, falja e namazit, si një detyrim fetar, është një praktikë jashtëzakonisht e vlefshme për shëndetin mendor të individit. Namazi është një formë adhurimi e rregullt dhe e disiplinuar që kryhet në kohë të caktuara, dhe kjo disiplinë krijon ndikime pozitive si në botën shpirtërore ashtu edhe në atë mendore. Në këtë tekst trajtohet se si falja e rregullt e namazit ndikon pozitivisht në aspektin mendor, duke u mbështetur në të dhëna shkencore dhe përvoja shpirtërore.

SHËNDETI MENDOR DHE FALJA E RREGULLT E NAMAZIT

Shëndeti mendor nënkupton aftësinë e individit për të mbajtur në ekuilibër mendimet, emocionet dhe sjelljet, si dhe

për t'u përballur me stresin dhe vështirësitë e jetës së përditshme. Kaosi i jetës moderne dhe bombardimi i vazhdueshëm me informacione nga teknologjia e vështirësojnë ruajtjen e shëndetit mendor. Kthimi drejt praktikës së faljes së namazit sjell ekuilibër dhe stabilitet psikologjik.



Namazi nuk ofron vetëm qetësi të momentit, por forcon edhe shëndetin mendor në afat të gjatë. Kur kryhet rregullisht, ai sjell disiplinë, ekuilibër dhe qetësi të brendshme. Në këtë mënyrë, parandalon kronifikimin e stresit dhe lodhjen mendore.

NDIKIMI I NAMAZIT NË PËRQENDRIMIN MENDOR

Në çdo rekat të namazit kërkohet fokus i caktuar në lëvizje dhe lutje. Kjo gjendje përqendrimi parandalon shpërndarjen mendore dhe forcon aftësinë e fokusimit. Ashtu si meditimi, namazi e shkëput njeriun nga bota përreth dhe e drejton atë vetëm tek adhurimi që po kryen. Gjatë këtij procesi, mendja çlirohet nga pendimet e së shkuarës dhe shqetësimet e së ardhmes, duke u përqendruar vetëm në momentin aktual. Forcimi i përqendrimit mendor çon në vendimmarrje më të shpejtë dhe më të qartë në jetën e përditshme, përballje më të qetë me problemet dhe rritje të performancës mendore.

Ulja e stresit dhe rritja e qetësisë

Stresi sot, është një nga problemet më të përhapura të shëndetit mendor. Stresi afatgjatë ndikon negativisht si në shëndetin fizik ashtu edhe në atë psikologjik. Ndikimi i namazit në uljen e stresit është mbështetur nga shumë studime shkencore. Gjatë namazit, frymëmarrja e thellë dhe ritmike ndihmon trupin të çlirohet, ndërsa ritualet e namazit e bëjnë individin të ndihet më i mbrojtur dhe më i sigurt. Lutja funksionon si një mekanizëm mbështetës shpirtëror, ku njeriu gjen ngushëllim dhe qetësi të brendshme, duke ulur nivelin e hormoneve të stresit.

Forcimi i qëndrueshmërisë mendore dhe disiplinës

Namazi është një adhurim që duhet kryer në kohë të caktuara dhe në mënyrë të rregullt. Kjo rregullsi e ndihmon individin të ndërtojë një rutinë të fortë ditore. Qëndrueshmëria mendore lidhet ngushtë me disiplinën, dhe kjo disiplinë reflektohet edhe në fusha të tjera të jetës, duke rritur durimin dhe qëndrueshmërinë përballë vështirësive.

Shëndeti mendor dhe lidhjet sociale

Namazi herë kryhet individualisht e herë në xhami me xhemat. Namazi me xhemat forcon lidhjet sociale. Mbështetja sociale ka ndikim shumë pozitiv në shëndetin mendor. Kur njeriu ndihet i lidhur me të tjerët, ai ndihet më mirë dhe më i sigurt. Namazi me xhemat rrit ndjenjën e përkatësisë, duke ulur problemet që vijnë nga vetmia dhe izolimi,

dhe duke mbështetur shëndetin social dhe mendor.

Pastrimi dhe rinovimi mendor

Namazi mund të shihet si një praktikë që pastron shpirtin dhe mendjen. Mendimet negative, shqetësimet dhe stresi i ditës pas-trohen përmes njetit, lutjes dhe praktikave të ngjashme me meditimin gjatë namazit. Kjo sjell një ndjenjë rigjallërimi dhe lehtësimi.

STUDIMET SHKENCORE DHE EFEKTET MENDORE TË NAMAZIT

Kërkimet në psikologji dhe neuroshkencë tregojnë se praktikatat e rregullta të adhurimit, përfshirë namazin, ndikojnë pozitivisht në disa zona të trurit. Lëvizjet ritmike dhe kontrolli i frymëmarrjes gjatë namazit aktivizojnë sistemin nervor parasimpatik, duke shkaktuar relaksim. Po ashtu, është vërtetuar se individët që falen rregullisht shfaqin nivele më të ulëta të ankthit dhe depresionit, si dhe përmirësim të cilësisë së gjumit, duke përkrahur shëndetin mendor në mënyrë të përgjithshme.

Efektet afatgjata të namazit në shëndetin mendor

Namazi nuk ofron vetëm qetësi të momentit, por forcon edhe shëndetin mendor në afat të gjatë. Kur kryhet rregullisht, ai sjell disiplinë, ekuilibër dhe qetësi të brendshme. Në këtë mënyrë, parandalon kronifikimin e stresit dhe lodhjen mendore. Me kalimin e kohës, namazi rrit cilësinë e jetës, sjell mendime më pozitive, rrit rezistencën ndaj vështirësive dhe nivelin e lumturisë.

PËRFITIMET E NAMAZIT PËR SHËNDETIN E NJERIUT

Psikologjike

Shumë pacientë përjetojnë shqetësime psikologjike dhe emocionale përballë sëmundjes dhe mundësisë së vdekjes. Nivelet e larta të ankthit mund të përkeqësojnë gjendjen e tyre fizike. Raportet në psikoterapi, që lidhen me faljen e namazit, tregojnë rezultate pozitive te personat që shfaqin simptoma patologjike si tension, ankth, depresion dhe prirje antisociale (Majeed 2016). Një studim me mbi gjashtëdhjetë të rritur myslimanë të moshës 18–85 vjeç në spitalin “Brigham and Women’s”, tregoi se namazi rrit çlodhjen psikologjike dhe

shpresën, ndërsa redukton stresin dhe depresionin. Lidhja mes mendjes dhe trupit gjatë namazit, duke u mbështetur në ndihmë dhe udhëzimi hyjnor, mund ta lehtësojë përbalimin e vështirësive të jetës dhe të ulë ankthin dhe depresionin.

Meditimi

Meditimi është fokusimi i mendjes në një objekt. Shumë studime raportojnë përfitimet e meditimit. Kërkimet tregojnë se namazi aktivizon sistemin nervor parasimpatik dhe ul aktivitetin simpatik (Doufesh et al. 2014), duke e konsideruar atë si një formë meditimi.

Neurologjike

Përveç aspektit shpirtëror dhe fetar, namazi është një aktivitet i përsëritur dhe stimulues mendërisht, që përfshin komponentë njohës dhe motorikë. Pozita e sexhdes, ku koka është më poshtë se zemra dhe merr më shumë qarkullim gjaku, ka efekte pozitive mbi kujtesën, përqendrimin, gjendjen shpirtërore dhe funksionin njohës (Al Ghazal 2006; Saniotis 2018). Pozicionet e rukusë dhe sexhdes lejojnë qarkullimin e lëngut cerebrospinal në bazën e trurit dhe lehtësojnë ftohjen e tij (Irmak et al. 2004; Binhammer 1997). Përkulja e shpeshtë, si gjatë namazit (rreth 120 herë në ditë), mund të ndihmojë në ftohjen e plotë të trurit.

Sistemi kardiovaskular

Devotshmëria fetare lidhet me më pak sëmundje kardiovaskulare (Mueller et al. 2001). Namazi përfshin qëndrimin në këmbë, rukunë, sexhden dhe uljen, lëvizje që vlejnë sa një aktivitet fizik i lehtë. Lëvizjet e përsëritura gjatë ditës mund të ulin rrezikun për trombozë të venave të thella (Chamsi-Pasha 2013). Doufesh et al. (2013) treguan se gjatë namazit, ritmi kardiak është më i lartë në qëndrimin në këmbë dhe më i ulët në sexhde, ndërsa tensioni i gjakut bie ngadalë pas namazit. Pjesëmarrja fetare lidhet me tension më të ulët të gjakut (Al Kandari 2003).

Sistemi muskuloskeletal

Shumica e muskujve dhe nyjave aktivizohen gjatë namazit. Lëvizjet janë të lehta, fleksibile dhe të përshtatshme për të gjitha moshat. Namazi përfshin qindra lëvizje posturale në ditë, rreth 119 në ditë, 3,570 në muaj dhe mbi 42,840 në vit. Një mysliman që falet nga mosha e pubertetit deri në 60 vjeç kryen mbi 1,927,800 lëvizje gjatë jetës (Imamoglu 2016). Namazi mund të mbrojë ekuilibrin postural, tonusin e muskujve, qarkullimin dhe të ulë rrezikun për osteoartrit (Al Barzinjy 2009; Osama & Malik 2019).

Rehabilitimi

Aktivitetet me intensitet të moderuar, kur kryhen rregullisht, kanë përfitime shëndetësore afatgjata. Lëvizjet e namazit aktivizojnë pothuajse të gjitha nyjat e trupit. Namazi mund të rrisë mirëqenien psikologjike, vetëvlerësimin, kondicionin muskuloskeletal dhe qarkullimin cerebral, duke



e bërë të dobishëm në rehabilitimin e pacientëve geriatrikë dhe me aftësi të kufizuara (Reza et al. 2002; Ghous & Malik 2016). Lëvizjet e qafës në mbylljen e namazit (selam) mund të përmirësojnë zhdërvjelltësinë neuromuskulare. Namazi mund të përfshihet si një formë e lehtë ushtrimi në terapi (Chamsi-Pasha & Chamsi-Pasha 2021).

PIKAT KRYESORE

- Namazi është një aktivitet shpirtëror dhe fizik, ku pothuajse të gjithë muskujt aktivizohen pa shkaktuar lodhje muskulore. Ai nxit qetësi mendore dhe fizike.
- Ndërveprimi midis sistemit nervor qendror dhe atij autonom gjatë namazit shkakton çlodhje dhe ul ankthin tek individët që falen rregullisht.
- Përfitimet mendore dhe fizike të namazit mund të ndihmojnë në parandalimin e çrregullimeve kronike të sistemit muskuloskeletal dhe në lehtësimin e simptomave të tyre.
- Lëvizjet fizike gjatë namazit mund të përmirësojnë qarkullimin, kondicionin muskuloskeletal dhe të ndihmojnë pacientët geriatrikë dhe me aftësi të kufizuara në rehabilitim.

REFERENCAT:

- Al Ghazal, S. K. 2006. *Medical Miracles of the Qur'an*. Leicester: The Islamic Foundation. Al Barzinjy, A. 2009. (Studim mbi efektet e namazit). Al Kandari, F. 2003. (Studim mbi tensionin e gjakut dhe faljen). Binhammer, L. 1997. (Studim mbi qarkullimin e lëngut cerebrospinal). Chamsi-Pasha, H. 2013. *Islam and the cardiovascular patient – pragmatism in practice*. Br J Cardiol 20(3): 1–2. Chamsi-Pasha, H., dhe A. Chamsi-Pasha. 2021. (Studim mbi namazin dhe ushtrimin në terapi). Doufesh, H., et al. 2013. (Studim mbi efektet neurologjike dhe kardiovaskulare të namazit). Ghous, A., dhe S. Malik. 2016. (Studim mbi rehabilitimin e pacientëve me namaz). Imamoglu, S. 2016. (Statistika mbi lëvizjet gjatë jetës së një myslimani). Irmak, M. K., et al. 2004. (Medical aspects of ablution and prayer). *J Exp Integr Med* 4(2): 143. Levin, J. S. 1996. *How religion influences morbidity and health: reflections on natural history, salutogenesis and host resistance*. *Soc Sci Med* 43: 849–64. Majeed, A. 2016. *Salat offset the negative health effect of stress*. *Inter J Adv Res* 4(2): 339–43. Osama, M., dhe S. Malik. 2019. (Studim mbi efektet muskuloskeletale të namazit). Saniotis, A. 2018. *Understanding mind/body medicine from Muslim religious practices of salat and dhikr*. *J Relig Health* 57(3): 849–57.
- Nurbaki, H. 1986. *Namazın surları*. İstanbul: Damla Yayınevi.

Ngrohtësia e syfyrit të varfër

Bajram Zeqiri

Një dëshirë e madhe e një djaloshi po piquej në heshtje. Çdo Ramazan, teksa e shihte të gjithë familjen e tij duke agjëruar, në zemrën e njomë i lindte një ndjenjë e ëmbël, nuk donte të mbetej i vetëm, donte që edhe ai të agjëronte. Herë pas here, me zërin e butë dhe të ëmbël, i lutej nënës: “Nanë, sivjet edhe unë dua të agjëroj.”

Viteve të mëparshme agjëronte vetëm tri ditë Ramazani: ditën e parë, Natën e Kadrit dhe Natën e Bajramit. Që të tria kishin simbolikën e tyre. Të parën e mbante me krenari, sikur e ndiente veten se kishte hyrë në një botë të re, në një botë ku ishte i barabartë me të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Për Natën e Kadrit kishte dëgjuar se kishte vlerë shumë të madhe, ani pse mendja e tij, nuk arrinte dot ta kuptonte edhe mirë madhështinë e saj. E Natën e Bajramit e priste me një gëzim të veçantë. Atë ditë e agjëronte me plot zemër, ngase e dinte

se nesër, në ditën e Bajramit, në derën e shtëpisë së tyre të varfër, dikush do të trokiste e do t’u sillte ndonjë ëmbëlsirë për ta festuar agjërimin e tij. Ky gëzim, djaloshin e mbante gjallë gjithë ditën.

Megjithatë, këtë herë, këmbëngulja e tij ishte ndryshe. Nuk donte më vetëm disa ditë. Donte ta agjëronte tërë Ramazanin. Donte ta provonte urinë si të tjerët, ani pse kjo gjë ishte tashmë e njohur për të; donte ta priste ezanin rreth sofrës së bashkuar si gjithë të rriturit, e ta ndiente veten pjesë të plotë të familjes.

Agjërimi i parë i djaloshit filloi. Por, ai nuk nisi me bollëk, ashtu siç do ta kishte ëndërruar çdokush. Nisi me mungesë; në një kohë të ftohtë, e me një shtëpi që muret e saj mbanin erën e varfërisë. Por, ato mure mbanin edhe diçka që nuk çahet kurrë, dashurinë për njëri-tjetrin. Syfyri u shtrua..., bukë të gatuar me dashurinë e nënës, pak djathë dhe një filxhan çaj... Ani pse nuk ishte e mbushur me ushqime, ajo sofër ishte e mbushur me ngrohtësinë e zemrave.

“Çohu djali im, syfyri është gati” – e zgjonte nëna me një zë të ultë, sikur kishte frikën se bashkë me të do të zgjoheshin edhe hallet. Syfyri është bereqet, edhe kur është pak.

Djaloshi fërkonte sytë dhe shikonte duart e nënës të çara nga puna e rëndë; duar të cilat e kishin gatuar jetën me plot sakrificë.

Babai rrinte i qetë në krye të sofrës, vetë prania e tij e mbante shtëpinë në këmbë. Para kafshatës së parë, zinte vend *Bismilahi* dhe një lutje e heshtur e nënës. Aty, në atë çast, edhe varfëria dukej e përrulur. Djaloshi aty kuptonte se syfyri nuk ishte vetëm një sofër ushqimi, por një përfaqim i padukshëm, i cili do ta mbante gjallë dhe të fortë gjithë ditën.



Në fundin e tij, vinte edhe porosia e nanës: “Bëje nijet djali im! Zoti na ndihmoftë e na e pranofhtë!”

Iftari kishte një magji tjetër. Kur niste të errësohej, shtëpia mbushej me gjallëri. Nëna fillonte me shtrimin e sofrës, sikur po shtronte për një festë përrallore e mbretërore. Por, ashtu sikurse syfyri, edhe iftari pothuajse ishte i njëjtë në sasinë e ushqimit. Shpresa, pritja dhe dashuria, e mbulonin atë.

Një ilahi e njëjtë përsëritej çdo natë, sikur ishte bërë himn i fillimit të iftareve.

Dhe ja, erdhi çasti i madh. Nga larg, nga minarja e xhamisë dëgjohej ezani. Një ezan që përhapej aq fort, ndoshta për shkak të qetësisë që mbretëronte në atë kohë; një ezan që, para se të dëgjohej me veshë, depërtonte thellë në zemra; një ezan që bashkonte të gjithë.

Këtë qetësi e “prishnin” zërat e njomë të fëmijëve, që përziheshin me zhurmën e hapave të vrapimit. “U kallën kandilat! U kallën kandilat!” – brohorisnin me zërin e ëmbël.

Këtë, djaloshi nuk do ta harronte kurrë. Zemra e tij po përjetonte diçka që kurrë më parë s’e kishte përjetuar.

Ditë e para ishin më të vështira; uria e rëndonte e etja i thahej në buzë. Çdo ditë, kur lodhja e kaplonte, mendja i rrinte krenare se ishte duke bërë diçka të madhe. Shpeshherë e shikonte orën, por më shpesh numëronte minutat.

Gëzimi i iftareve ishte më i papërshkrueshëm, sikur e bënte të ndihej më i madh, më i fortë e më i lumtur.

Kështu e jetoi djaloshi për disa vite Ramazanin.

Vitet kaluan e kaluan... Djaloshi me zemrën e njomë e me duart e vogla u rrit. Varfëria nisi të zbehej, për t’u zhdukur një ditë tërësisht, falë Zotit. Shtëpia tanimë u bë e madhe. Tani muret e saj nuk mbanin erën e varfërisë. Por, ajo që nuk ishte zhdukur kurrë ishte dashuria dhe kujdesi për njëri-tjetrin. Ajo u mbush përplot me nipër dhe mbesa, që mbushnin edhe muret e shtëpisë me të qeshura. Prindërit, që kishin sakrifikuar gjithçka, tanimë po shihni gjallërinë e shtëpisë, falënderonin vazhdimisht Zotin e Madh për mirësitë e shumta.

Syfyri tani kishte gjithçka, e iftari njëmend kishte marrë pamjen mbretërore. Tanimë,

fëmijët, si dikur djaloshi e prisnin ezanin me të qeshura e me lutje, veçse sofrë e tyre tani ishte ndryshe. Djaloshi e ndiente se tani ishte plotësuar me gjithçka. Zotin falënderonte për familjen, fëmijët, e të mirat e shumta që kishte.

Por, koha nuk ndalet për askënd. Ditë pas ditësh, prindërit kaluan në botën tjetër, njëri pas tjetrit, ashtu qetë dhe pa zhurmë, siç edhe e kishin kaluar jetën. Shtëpia e madhe u bë e heshtur. Tryeza e pasur u bë e ftohtë. Djaloshi, tashmë burrë, u gjend i vetëm në një iftar plot bollëk, por bosh. Asgjë nuk kishte shije.

Ilahia nuk dëgjohej më... Ezani humbiste mes zhurmës, e brohoritja e fëmijëve nuk dëgjohej më.

E mori lugën, por dora iu dridh. Mendja iu kthye pas, tek ajo sofrë e vogël, e me pak ushqim; te zani i nanës në syfyri; te buka e gatuar me dashuri; tek ilahia e iftarit; tek ezani që çante qiellin, e te brohoritjet e fëmijëve në rrugë.

“Nanë, a është ky bereqet?!”, pyeti me vete, por përgjigje nuk mori.

Malli u bë i padurueshëm dhe i rëndë. Do të jepte gjithçka vetëm për t’u kthyer qoftë edhe në një ditë të vetme në atë kohë. Jo për varfërinë, por për ngrohtësinë dhe dashurinë që nuk blihen.

Në një natë Ramazani, ai u ul për syfyri i vetëm. Asgjë, përveç një cope buke, një copë djathi dhe një filxhan çaji, nuk mori për të ngrënë. Sikur donte të kthehej edhe një herë në kohë.

Mbylli sytë dhe pëshpëriti: “Nanë, jam çu në syfyri...”

Lotët e tradhtuan dhe i rrëshqitën në heshtje. Nuk kthehej dot në kohë, por u kthye në ndjenja. Dhe, për herë të parë pas shumë kohësh, në atë syfyri të thjeshtë, zemra iu ngroh. Aty e kuptoi se pasuria më e madhe kishte qenë ajo sofër e varfër, e mbushur me dashuri, ajo ilahi e përsëritur, ai ezan dhe ai zë fëmijësh rrugëve.

Aty e kuptoi se Ramazani kurrë më nuk do të jetë i njëjtë, kur në sofrën e syfyrit dhe të iftarit mungojnë ata që këtë muaj dikur e bënë madhështor.

“Ja Allah! Ashtu siç prindërit kujdeseshin për ne, që me dashurinë e tyre na e shtronin sofrën e munguar nga ushqimet, ashtu dhe Ti o Zot, mbushua sofrat e bekuara në Xhenetin Firdevs!”

Babai rrinte i qetë në krye të sofrës, vetë prania e tij e mbante shtëpinë në këmbë. Para kafshatës së parë, zinte vend Bismilahi dhe një lutje e heshtur e nënës. Aty, në atë çast, edhe varfëria dukej e përlulur. Djaloshi aty kuptonte se syfyri nuk ishte vetëm një sofër ushqimi, por një përqaftim i padukshëm, i cili do ta mbante gjallë dhe të fortë gjithë ditën.

Histori e shkruar me laps të huaj

Besnik Jaha, phd

Historitë e para për shqiptarët nuk i Hkanë shkruar shqiptarët. Paradoksalisht, historia e shqiptarëve ka nisur të shkruhet prej të huajve. E, siç thotë populli ynë, *rrobat që t'i pret tjetri nuk t'i pret tamam*. Prandaj, edhe historia jonë, për shumë kohë, i ka veshur rrobat e qepura nga duar të huaja. Kjo sepse, para se ta merrnim lapsin në dorë ne, para se të kishim guximin institucional e vetëdije kombëtare për të ndërtuar narrativën tonë, për ne kanë folur e vendosur të huajt (paradoksalisht, në këtë aspak as sot nuk jemi për mashalla), qoftë udhëtarë, diplomatë, klerikë, kronistë perandorish, e më vonë edhe historianë akademikë e akademi të popujve “të fortë”. Kështu, historitë e para për shqiptarët nuk janë shkruar prej shqiptarëve, madje as historia e Shqipërisë si hapësirë gjeopolitike, pastaj as historia kombëtare si vetëdije nacionale, e madje as historia letrare si kujtesë shpirtërore e këtij populli.

Ky nuk është një fakt i thjeshtë që tregon për një mungesë të rastit e teknike, apo për një rastësi historike. Para së gjithash, kjo dëshmon një pasojë-fatalitet të drejtpërdrejtë të pozitës së shqiptarëve në histori; për shekuj me radhë Shqipëria, shqiptarët, gjuha dhe letërsia shqipe qenë objekt studimi, dhe jo subjekt. Për ironi, ne ishim temë për të tjerët, mirëpo jo zë

Edhe historia letrare shqiptare nuk shpëton nga ky fat. Kanonet e para, klasifikimet, vlerësimet dhe hierarkitë u ndërtuan nën syrin e huaj, sipas kriterëve që nuk lindën nga brendia e kulturës shqiptare, por nga modele të importuara.

për veten. Dhe kështu, të tjerët na përshkruan, na matën, na kategorizuan, na romantizuan ose na demonizuan, gjithmonë sipas interesave të tyre politike, shkencore, ideologjike a fetare. Dhe kështu, shqiptari në këto tekste rrallë flet, sepse zakonisht për të flitet. Dhe kështu, kur për ty flasin të tjerët, nuk është gjithmonë për të të kuptuar, por shpesh për të të përdorur.

Edhe historia letrare shqiptare nuk shpëton nga ky fat. Kanonet e para, klasifikimet, vlerësimet dhe hierarkitë u ndërtuan nën syrin e huaj, sipas kriterëve që nuk lindën nga brendia e kulturës shqiptare, por nga modele të importuara. Si shembuj mund të përmendim faktin se albanologët më të hershëm që u morën më seriozisht me gjuhën dhe letërsinë shqipe ishin të huaj, mes të cilëve po i përmendim disa gjermanfonë: Gotfrid Vilhelm Lajbnic (1646-1716), Johan Gotfrid fon Herder (1744-1803)¹, Johan Erih Tuman (1746-1776)², Franc Bop (1791-1867)³, Jozef Riter fon Ksilander (1794-1854)⁴, Johann Georg fon Hahn (1811-1869)⁵, Jakob Filip Falmerajer (1790-1860)⁶, Paul Kreçmer (1866-1956)⁷, Gustav Majer (1850-1900)⁸, Maksimilian Lamperc (1882-1963). Pastaj, edhe provat e mëvonshme dhe më serioze, individuale e institucionale të historive të

letërsisë shqipe, prapë më të hershme ishin të huaja. Për shembull, Alberto Stratico (*Manuale di Letteratura albanese*) – 1896; Gaetano Petrotta (*Popolo, Lingua e Letteratura albanese*) – 1931, dhe (*Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*) – 1950; Stuart E. Man (*Albanian literature an Outline of Prose, Poetry, and Drama*) – 1955; Giuseppe Schiro - i Riu (*Storia della Letteratura albanese*) – 1959; Agniya Vasilyevna Desnitskaya (*Historia e letërsisë shqipe*) – 1987.



Dhe, në shumicën e këtyre historive, letërsia jonë, në kontekst të klasifikimit e periodizimit nëpër histori, u lexua si ekzotike, periferike, e vonuar, dhe vetëm më pas, shumë më vonë, si një traditë që meriton të lexohet në kontekstin e vet historik, gjuhësor dhe kulturor. Sepse, kur historia nuk shkruhet vetë, ajo rrallëherë i shërben vetes. Dhe, kur për dekada të tëra mësohesh ta shohësh veten përmes syrit të tjetrit, fillon të vuash e ta marrësh për të mirëqenë edhe keqkuptimin, edhe keqdashjen e keqbërjen (në mos edhe të vuash nga sindromi i Stokholmit). Pra, historia shqiptare ka nisur si rrëfim i huaj për një popull dhe një kulturë që ende nuk kishte hyrë në rolin e narratorit të vet. Dhe pikërisht këtu fillon problemi ynë më i madh, por edhe nevoja urgjente për t'u zgjuar nga letargjia akademike *soi generis* shqiptare.

Le t'i shohim disa dëshmi tronditëse!

Shqiptarët nuk kishin një tekst të mirëfilltë, zyrtar dhe të unifikuar të historisë së tyre deri pas vitit 1944. Jo se nuk kishin histori e ekzistencë, përkundrazi, kishin më shumë se çduhej, por sepse historia, si zakonisht, nuk i pyet popujt e vegjël kur vjen puna për ta shkruar historinë zyrtare. Në këtë zbraçëti të *tharm* ideologjia, dhe bashkë me të edhe “miqtë e fortë”, që gjithmonë e dinë më mirë historinë e tjetrit sesa vetë populli që i shkruhet ajo histori. Kështu ndodhi që, para se shqiptarët të mund (të guxonin) ta shkruanin historinë e Shqipërisë me dorën e tyre, atë e shkruan disa autorë sovjetikë (gjithsesi me laps ideologjik), me sy gjeopolitik dhe me një ndjenjë të një vëllazërie sllave që të bën të ndihesh mirë vetëm deri sa ta shohësh faturën.

Nina Smirnova⁹, Agniya Vasilyevna Desnitskaya¹⁰ Grigorij (Grigory) Lvoviç Arsh¹¹ dhe disa emra të tjerë të “qarkut” akademik sovjetik, që sot mezi i gjen në raftet e bibliotekave, por jo edhe në tekstet tona shkollore, u morën seriozisht me historinë shqiptare. Aq seriozisht, saqë ia dhanë formën, kornizën dhe shpirtin sipas modelit sovjetik: luftë klasash,

popull i shtypur, fe reaksionare, Perandori Osmane baras me errësirë mesjetare, dhe sllavët... pothuajse fqinj të padukshëm, në mos të mirë. Kjo histori ishte një model i një historie të shkruar me buzëqeshje ideologjike dhe me dhëmbë të shtrënguar politikisht.

Kur më në fund, në vitin 1959, doli teksti i parë i historisë me autorë shqiptarë, punim kolektiv i Institutit të Historisë¹², ai nuk lindi si një fëmijë i lirë, por si një fëmijë që kalon më parë në kontroll mjekësor ideologjik. Drafti, para botimit, shëtiti në akademi të huaja (Bullgari), mori vërejtje, u “përmirësua”, u rregullua, u krasit aty ku nuk duhej të rritej shumë identiteti kombëtar dhe u ujit mirë aty ku duhej të forcohej narrativa sllavo-komuniste. Nacionalizmat sllavë u futën në tekst jo me çizme, por me pantofla akademike, dhe pikërisht për këtë arsye u pranuan pa zhurmë.

Kulmi erdhi më vonë, në vitin 1974, kur ky model historiografik u eksportua edhe në Kosovë. Aty u prit si e vërtetë shkencore; dhe, jo sepse ishte bindëse (po edhe se vinte nga Shqipëria, pa u “kuptuar” se aty kishte shkruar nga Bullgaria, në fakt, Rusia), por sepse u përsërit mjaftueshëm herë. Kështu rriti rrënjë e trup një histori e ndërtuar mbi sharjen rituale të Perandorisë Osmane dhe mbi demonizimin sistematik të gjithçkaje islame, jo domosdoshmërisht për hir të së vërtetës historike, por për të zhvendosur vëmendjen. Sepse, nëse armiku mbetet “turku i largët”, atëherë fqinji i afërt sllav mbetet më pak fajtor, më pak pushtues, madje ndonjëherë edhe “çlirimtar” e “vëlla” (madje kishte edhe vëllazërim-bashkim). Një iluzion i bukur, por i rrezikshëm.

Dhe ja ku jemi sot, ende duke e vuajtur këtë defekt historiko-gjenetik: një histori që na është mësuar më shumë si refleks ideologjik sesa si kërkim i së vërtetës; një histori ku urrejtja është e trashëguar, po edhe e drejtuar gabim; ku e shkuara osmane shërben si kosh për gjithçka që nuk kuptohet, ndërsa dhuna sllave relativizohet, harrohet ose, në rastin më



të mirë, përmendet me gjysmë zëri e me arsytim për nevojën harresë, ashtu që të vazhdohet përpara pa hipoteka të së kaluarës. Si të thuash, kemi mësuar ta lexojmë historinë me syze që nuk janë tonat. Dhe, pastaj çuditimi pse na dhemb koka.

Ironia më e madhe është se kjo histori u pranua masivisht jo për shkak të argumentit, por për shkak të lodhjes mendore: kur diçka përsëritet për dekada, ajo pushon së qeni teze, dhe shndërrohet në një “të vërtetë”. Dhe kështu, një popull me kujtesë të gjatë, por me histori të shkruar shkurt, keq e me gjënjeshtra, vazhdon të jetojë me pasoja që nuk janë thjesht akademike, por identitare; sot, për fat të keq, shqiptarët në Kosovë dhe kudo jashtë Shqipërisë janë duke kaluar nëpër një krizë të thellë identitare, cytur nga tendencat për ridefinim të kriterëve për identitet kombëtar e shtetëror¹³. Historia, në fund të fundit, nuk është vetëm ajo që ka ndodhur, por ajo që na është mësuar të besojmë se ka ndodhur. Dhe, kur besimi ndërtohet mbi shtylla të huaja, shtëpia, herët a vonë, fillon të lëkundet.

- 1 Për më shumë shih librin e tij: “Ide për historinë e njerëzimit”, Leipzig, 1868, vëll. III, f. 99!
- 2 Për më shumë shih librin e tij: “Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore”, Leipzig, 1774!
- 3 Për më shumë shih librin e tij: “Për shqipen dhe lidhjet e saj të prejardhjes”, Berlin, 1855!
- 4 Për më shumë shih librin e tij: “Gjuha e albanezëve ose e shqiptarëve”, Frankfurt am Main, 1835!
- 5 Për më shumë shih: “Studime shqiptare”, Vjenë, 1854! Po ashtu shih edhe librin: “Udhëtim nga Beogradi në Selanik”, Vjenë, 1861!
- 6 Për më shumë shih librin e tij: “Elementi shqiptar në Greqi”, Pjesa e parë, München, 1857!
- 7 Për më shumë shih librin e tij: “Prehistoria gjuhësore e Ballkanit”, vëllimi II, 1935, f. 41-48!
- 8 Ky albanolog njihet sidomos për përpilimin e veprës “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”, 1891.
- 9 Historiane e njohur ruse, e cila në librin “Historia e Shqipërisë në shekullin XX”, ka paraqitur historinë e Shqipërisë përmes dëshmive të panjohura më parë, nga arkivat perëndimore dhe ruse në veçanti, si dhe ka shprehur interpretime mbi personalitetet, personazhet, faktet dhe realitetet e shekullit më të trazuar në historinë e shqiptarëve.
- 10 Agniya Vasilyevna Desnitskaya (1912-1992) lingviste dhe albanologe sovjetike/ruse, e njohur për punën e saj mbi gjuhën shqipe, letërsinë dhe folklorin, si dhe si një nga themelueset e albanologjisë moderne në Rusi. Edhe pse fokusi i saj kryesor është gjuhësor dhe letrar, puna e saj ndihmon edhe në kuptimin historik dhe kulturor të shqiptarëve. Vepra e saj kryesore konsiderohet libri “Historia e letërsisë shqipe”, e botuar në vitin 1987.
- 11 Arsh (ka qenë historian sovjetik, i specializuar në historinë e Ballkanit dhe një nga autorët rusë që është marrë drejtpërdrejt me historinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, sidomos në kontekstin politik të shekullit XX. Arsh ka shkruar për: Shqipërinë pas Luftës së Dytë Botërore, zhvillimet politike dhe shoqërore, vendosjen e pushtetit komunist dhe për raportet e Shqipërisë me kampin socialist. Punimet e tij janë shkruar brenda paradigmes marksiste-leniniste, pra jo si histori neutral, por si histori ideologjike, sipas modelit sovjetik. Pikërisht për këtë arsye, Arsh ka qenë referencë “e pranueshme” për historiografinë shqiptare të viteve ’90, sidomos në fazën kur po ndërtohej teksti zyrtar i historisë.
- 12 Teksti i parë zyrtar shkencor i historisë së Shqipërisë i hartuar prej autorëve shqiptarë u botua në vitin 1959 nga Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë i Universitetit Shtetëror të Tiranës, si vëllimi i parë i veprës së përbashkët të titulluar Historia e Shqipërisë. Ky vëllim përfaqëson përpjekjen e parë serioze akademike shqiptare për të përmbledhur kronologjinë e historisë nga periudhat e lashta deri të mesjeta e hershme dhe më tej, duke u bazuar në kërkime dhe burime historike sistematike. Vëllimi i parë i *Historisë së Shqipërisë* i botuar më 1959 u ndiq nga një vëllim i dytë në 1965, dhe më vonë, më 1974, këto dy vëllime u ribotuan dhe përdorën edhe në Kosovë nën titullin *Historia e Popullit Shqiptar*.
- 13 Në Kosovë po zhvillohet një krizë identitare: po përpiqen të na shohin jo si shqiptarë, por vetëm si kosovarë, duke zëvendësuar identitetin kombëtar me atë shtetëror, madje edhe në aspektin e gjuhës. Kjo pasojë e historisë së shkruar keq dhe e edukimit të filtruar e ka bërë popullin më lehtë të manipulueshëm. Po na shtynjë të mendojmë se identiteti kombëtar është si një pallto që hiqet sipas stinës. Ky debat nuk është thjesht terminologjik; është ekzistencial. Ai lind nga një trashëgimi deformimi historiografik dhe psikologjik që e mësoi popullin të dyshojë në vetvete dhe në historinë e vet. Problemi shtrihet deri te gjuha: po flitet për një “shqipe kosovare”-kosovarishte, sikur ndarja gjuhësore në këtë rast të jepte identitet, kur në të vërtetë ajo e copëzon. Shqiptarët mbijetuan shekuj pa shtet, por me gjuhë; sot kanë shtet, por po vënë në pikëpyetje gjuhën dhe vetëdijen e tyre. Një popull që heq dorë nga historia dhe gjuha e vet nuk modernizohet; ai shpërbëhet.

Ngritja e Islamit deri në vitin 2050

Piers Morgan

Kur e shikon botën sot, fillon të kuptosh se diçka e jashtëzakonshme po ndodh. Diçka delikate, diçka e qëndrueshme, diçka e pandalshme. Po ndodh një ngritje e qetë, një ngritje që shumë njerëz nuk mund ta shpjegojnë, por të gjithë mund ta ndiejnë. Është ngritja e Islamit, jo përmes forcës, jo përmes politikës, jo përmes fushatave, por përmes kuriozitetit, bindjes, së vërtetës dhe tërheqjes së pamohueshme të një besimi që u jep njerëzve përgjigje në një botë të mbushur me pyetje. Dhe kjo ngritje nuk është diçka e largët në të ardhmen. Tashmë po ndodh, po përshpejtohet dhe deri në vitin 2050, bota do ta shohë Islamit në një mënyrë që nuk e kishte imagjinuar kurrë.

Njerëzit shpesh pyesin, pse po ngrihet Islami? Ata përpiqen ta lidhin atë me trendet globale, studimet demografike, ngjarjet politike, ndryshimet kulturore. Por ajo që ata nuk arrijnë ta kuptojnë është se besimi nuk ngrihet për shkak të numrave, ai ngrihet sepse i flet shpirtit. Dhe ajo që po ndodh sot, është se miliona shpirtra në të gjithë botën janë të etur për të kuptuar. Ata shikojnë kaosin e jetës moderne, stresin, ankthin, depresionin, vetminë, varësinë, krizën e identitetit dhe shohin se bota përreth tyre premton liri, por sjell boshllëk. Kështu që ata kërkojnë, eksplorojnë

Deri në vitin 2050, Islami parashikohet të bëhet feja më e madhe në botë.

dhe diku përgjatë atij udhëtimit, takojnë Islamit, një fe që nuk flet vetëm për Zotin, por u mëson atyre se kush është Zoti, një fe që nuk u kërkon atyre të braktisin intelektin e tyre, por e forcon atë, një fe që u jep atyre paqe në një botë që “lulëzon” në zhurmë.

Deri në vitin 2050, Islami parashikohet të bëhet feja më e madhe në botë. Jo sepse myslimanët po përpiqen të dominojnë, por sepse njerëzit po zbulojnë diçka që mbush boshllëkun në zemrat e tyre, diçka që u jep drejtim atyre që ndihen të humbur, diçka që u jep qëllim atyre që ndihen të harruar, diçka që u jep forcë atyre që ndihen të thyer. Dhe kur këta njerëz e gjejnë Islamit, nuk është një ndryshim i vogël, ai transformon të gjithë jetën e tyre, familjen e tyre, të ardhmen e tyre dhe përfundimisht shoqërinë përreth tyre. Nëse shikoni nga afër, do ta vini re ndryshimin tashmë.

Çdo vit, më shumë njerëz në Evropë, Amerikë, Kanada, Amerikën Latine dhe Australi e thonë shahadetin e tyre në heshtje por fuqishëm. Në vendet ku Islami dikur keqkuptohej, tani po rishqyrtohet. Në vendet ku myslimanët dikur shiheshin si të huaj, ata tani po formësojnë kulturën, njohuritë, mjekësinë, teknologjinë dhe lidërshtimin. Në universitete, Islami është një nga fetet më të hulumtuara. Në



vendet e punës, myslimanët po ripërcaktojnë profesionalizmin me karakter dhe etikë. Në mediat sociale, përmbajtja e menduar mirë rreth Islamit po arrin miliona çdo ditë, shpesh nga jomyslimanë, që admirojnë bukurinë e tij. Dhe në shtëpitë pas dyerve të mbyllura, njerëzit po e lexojnë Kuranin për herë të parë në jetën e tyre, duke qarë për vargje që nuk e dinin se zemra e tyre kishin nevojë. Dhe kur ecën përpara në kohë dhe imagjinojnë botën e vitit 2050, fillon të shohësh një pamje që nuk është ndërtuar mbi hamendje, por mbi ndryshime të qarta globale. Popullatat myslimane në Evropë do të dyfishohen. Në Amerikë, myslimanët do të tejkalojnë shumë komunitete tradicionale. Në Afrikë, Islami do të jetë feja dominuese në më shumë se 40 vende.

Në Azi, të rinjtë myslimanë do të bëhen liderë në shkencë, teknologji, ekonomi dhe qeverisje. Dhe pjesa më e pabesueshme, kjo rritje nuk do të jetë vetëm për shkak të migrimit apo shkallës së lindjeve, do të jetë sepse njerëzit po vijnë në Islam me dëshirë, me mendim, shpirtërisht. Ata po e zgjedhin Islamit sepse u jep përgjigje kur gjithçka tjetër ofron konfuzion. Ecnin nëpër rrugët e Londrës sot dhe do të shihni gra me hixhab që punojnë me besim në pozicione të larta. Burra që ndjekin punë të rënda në mesxhide që dikur ishin bosh. Të konvertuar që me lot në sy ua mësojnë të tjerëve për Islamit. Tani imagjinojnë të njëjtat rrugë në vitin 2050. Mesxhidet zgjeruan qendrat e reja islame që u hapën, bizneset hallall lulëzojnë, Institutet e Kuranit janë të mbushura me studentë të çdo prejardhjeje. Imagjinojnë Nju Jorkun, Parisin, Berlinin, Toronton, Sidnein, Johannesburgun, qytete që dikur kishin vështirësi ta kuptonin Islamit, tani e përfaqojnë atë si pjesë të identitetit të tyre kulturor. Jo sepse Islami ndryshoi për t'iu përshtatur botës, por sepse bota ndryshoi kur u përball me Islamit.

Tani, ngritja e Islamit nuk ka të bëjë vetëm me numrat, ka të bëjë me transformimin e zemrave, me ringjalljen e identitetit brenda vetë myslimanëve. Sot, myslimanët e rinj po zgjohen me një nivel krenarie dhe vetëbesimi që brezat e mëparshëm nuk e kishin pasur kurrë. Ata po mësojnë arabisht, po studiojnë Kuranin, po eksplorojnë historinë islame, po rilidhen me Sunetin, po korrigjojnë keqkuptimet, po ndërtojnë aplikacione islame, po projektojnë perandori modeste të modës, po lançojnë institute, po prodhojnë dokumentarë, po krijojnë platforma për të mbrojtur të vërtetën. Dhe deri në vitin 2050, kjo ringjallje do të jetë edhe më e fortë. Do të rritet një brez që e di saktësisht se kush është, saktësisht se çfarë përfaqëson dhe saktësisht se ku po shkon. E shihni, për një kohë të gjatë, Islami u portretizua përmes lenteve negative, stereotipave mediatike, agjendave politike, fushatave të dezinformimit, por tani këto lente po çahen.

E vërteta po del në pah dhe njerëzit po e kuptojnë se Islami nuk është fe e shtypjes, por fe e çlirimit, nuk e skllavëron mendjen, por e çliron atë, nuk i hesht gratë, por i nderon ato. Nuk çon në dhunë, por udhëzon drejt paqes me drejtësi. Dhe ndërsa më shumë njerëz i përjetojnë myslimanët nga afër, në shkollë, në punë, në sport, në biznes, ata fillojnë të kuptojnë se Islami nuk është ajo që tregojnë titujt kryesorë të konglomeratit mediatik, por ajo që ndien zemra. Deri në vitin 2050, do të shihni shkencëtarë myslimanë që udhëheqin përparime në mjekësi, inxhinierë myslimanë që projektojnë qytete të së ardhmes, sipërmarrës myslimane që ndërtojnë biznese etike, aktivistë myslimanë që formësojnë biseda mbi drejtësinë, studiues myslimanë që ringjallin njohuritë islame për të cilat bota moderne ka nevojë urgjente. Do ta shihni Kuranin duke u bërë një nga librat më të studiuar edhe jashtë botës myslimane, do të shihni jomyslimanë që citojnë mësimet profetike, sepse ato mbartin mençuri universale. Do

të shihni një ndryshim ku njerëzit nuk do të pyesin më se çfarë është Islami, por në vend të kësaj do të pyesin se si nuk e pashë këtë më parë? Dhe ndoshta pjesa më e bukur e kësaj rritjeje është se po ndodh pa pasur nevojë që myslimanët të bëjnë kompromis me besimin e tyre. Në vend që ta përshtatin Islamin me modernitetin, myslimanët po e përshtatin modernitetin me Islamin. Rritja e industrive hallall, investimet etike, markat modeste të stilit të jetesës, psikologjia islame, mbështetja për shëndetin mendor mysliman, reforma e arsimit islam. Këto nuk janë gjëra të vogla, janë shenja të një komuniteti që po formëson të ardhmen e vet në vend që të formësohet nga forcat e jashtme. Imagjinoni një fëmijë mysliman të lindur në vitin 2050, që do të rritet në një botë ku Islami respektohet, ku myslimanët janë kontribuues, jo karikatura, ku vlerat islame shihen si zgjidhje, jo si pengesa, ku të qenit mysliman nuk është diçka që e fshih, por diçka që e përfaqëson me krenari. Ai fëmijë do të studiojë në shkolla ku mësimet islame kuptohen, do të rritet me modele që i ngjajnë atij dhe ndajnë besimet e tij.

Do të shohë myslimanë në leadership, shkencë, arte, diplomaci, teknologji dhe nuk do të ndihet kurrë i pasigurt për identitetin e tij ashtu siç ndihen shumë myslimanë sot. Dhe pastaj imagjinoni atë fëmijë që shikon njerëz të rinj që hyjnë në Islam çdo ditë - mjekë, profesorë, atletë, regjisorë filmash, udhëheqës biznesi, fqinjë, miq, sepse e vërteta vazhdon t'i thërrasë. Imagjinoni ata duke dëshmuar unitetin e xhumasë, duke u forcuar, zgjimin e spiritualitetit duke u thelluar dhe ringjalljen e diturisë islame duke u zgjeruar në çdo cep të globit. Deri në vitin 2050, Islami nuk do të jetë thjesht duke u ngritur, do ta riformësojë botën në mënyra paqësore, etike, të qëndrueshme dhe frymëzuese. Kjo ngritje nuk mund të ndalet sepse nuk është një ngritje e ndërtuar mbi politikën apo pushtetin. Është një ngritje e ndërtuar mbi vërtetën. Një ngritje e ndërtuar mbi sinqeritetin. Një ngritje e ndërtuar mbi zemrat që gjejnë paqe në rikujtimin e Allahut. Një ngritje e ndërtuar mbi një mesazh që ka mbetur i pandryshuar për 1400 vjet dhe do të mbetet i pandryshuar deri në fund të kohës. Bota po ndryshon. Njerëzit po zgjohen dhe deri në vitin 2050, Islami do të qëndrojë si një far qartësie në një botë plot konfuzion. Dhe pavarësisht nëse dikush e pranon këtë ngritje apo e mohon, pavarësisht nëse i gëzohet apo i frikësohet, pavarësisht nëse e përqafon apo i reziston, realiteti nuk ndryshon.

Islami po rritet, zemrat po hapen, e vërteta po përhapet dhe bota po lëviz drejt një të ardhmeje ku drita e udhëzimit shkëlqen më fort se kurrë më parë. Ky nuk është vetëm një parashikim, është një realitet që po shpaloset para syve tanë. Dhe kur flasim për ngritjen e Islamit deri në vitin 2050, duhet të shohim jo vetëm ndryshimin e botës së jashtme, por edhe transformimin e botës së brendshme të myslimanëve. Sepse një nga shenjat më të rëndësishme të ringjalljes nuk është

hyrja e njerëzve në Islam, por kthimi i myslimanëve në Islam. Ata zemra që dikur ishin të largëta bëhen të afërta, praktikat që dikur ishin harruar bëhen të gjalla, vlerat që dikur ishin dobësuar bëhen përsëri të forta. Dhe sot, tashmë mund ta shihni këtë të ndodhë kudo. I shihni të rinjtë myslimanë që u rritën në epokën digjitale të rrethuar nga shpërqendrimet dhe tundime, të cilët tani kërkojnë thellësi, që do të thotë disiplinë dhe pastërti. I shihni duke u zgjuar, duke dëgjuar leksione ndërsa ngasin makinën, duke debatuar për historinë islame, duke bërë pyetje të thella teologjike, duke mësuar përmendësh Kuranin, duke udhëtuar për umre e haxh, duke ndërtuar organizata bamirësie, duke ushqyer të pastrehët, duke ndihmuar refugjatët, duke zgjedhur qëllimin mbi kënaqësinë.

Ky transformim i brendshëm nuk është i vogël, është themeli i ngritjes globale që po vjen, sepse çdo ringjallje në histori filloi me zemra, jo me tituj lajmesh. Dhe deri në vitin 2050, ky zgjim shpirtëror do të jetë edhe më i fortë. Myslimanët në çdo vend do të kenë më shumë akces në arsimin islamik se kurrë më parë. Fëmijët do ta mësojnë përmendsh Kuranin, duke përdorur aplikacione që nuk ekzistonin në brezat e mëparshëm. Familjet do ta mësojnë hadithin përmes platformave që e bëjnë të mësuarit të lehtë dhe tërheqës. Dokumentarët, filmat dhe historitë islame do të përhapin njohuritë në mënyra që vetëm librat nuk do të mundnin kurrë. Ky kombinim i traditës me teknologjinë do të krijojë një brez që është si i ditur ashtu edhe i sigurt, një kombinim për të cilin umeti ka nevojë thellësisht.

Po shohim gjithashtu një rritje të bamirësisë islame dhe punës humanitare globale. Diçka që do ta riformësojë të ardhmen në mënyra që bota nuk e ka kuptuar plotësisht. Myslimanët po bëhen donatorët kryesorë në mbështetjen e refugjatëve, iniciativat për ujë të pastër, misionet mjekësore dhe lehtësimin e varfërisë. Organizatat e ndihmës islame po zgjerojnë shtrirjen e tyre në të gjithë kontinentet. Imagjinoni se si do të duket kjo deri në vitin 2050? Spitalet e udhëhequra nga myslimanët në Afrikë. Shkollat e financuara nga myslimanët në Azi. Strehime të ndërtuara nga myslimanët në Amerikën Latine. Jetimët e mbështetur nga rrjetet globale myslimane. Projekte të qëndrueshme bujqësore të financuara nga zekati dhe sadakaja. Komunitete të tëra të ngritura nëpërmjet bujarisë së një umeti që e sheh dhënien si adhurim. Këto akte shërbimi, jo vetëm që i ndihmojnë njerëzit, por ato u zbusin zemrat, u hapin mendjet dhe i sjellin njerëzit më afër të vërtetës. Kur njerëzit shohin se Islami çon në dhembshuri, përgjegjësi dhe mirësi, ata fillojnë të bëjnë pyetje, fillojnë të eksplorojnë, fillojnë të reflektojnë dhe shumë prej tyre fillojnë të ndryshojnë. Ky është lloji i ngritjes që bota nuk mund ta ndalojë, një ngritje nëpërmjet karakterit.

Një tjetër komponent kyç i rritjes së Islamit është zëri në rritje i grave myslimane. Për dekada, bota i pikturoi gratë

myslimane si të shtypura, të heshtura dhe të padukshme. Por sot, ky rrëfim po shkatërrohet, gratë myslimane po hyjnë në fushat e shkencës, mjekësisë, inxhinierisë, drejtësisë, gazetarisë, sipërmarrjes, akademisë dhe aktivizmit, ndërsa me krenari qëndrojnë të lidhura me besimin e tyre. Ato po organizojnë shfaqje, po shkruajnë libra, po udhëheqin kërkime, po ndërtojnë biznese dhe po mentorojnë të rinjtë. Ato po i dëshmojnë botës se Islami nuk i hesht gratë, por i lartëson ato. Dhe deri në vitin 2050, gratë myslimane do të jenë ndër zërat më me ndikim që riformësojnë diskursin mbi identitetin, familjen, spiritualitetin dhe lidhësimin.

Pastaj është ringjallja e njohurive islame. Për shumë vite, studimet islame shiheshin si të largëta, të kufizuara në institucionet tradicionale, por sot shihni një valë të re studiuesish dhe studentësh që dalin duke folur rrjedhshëm shumë gjuhë të arsimuara si në shkencat islame ashtu edhe në fushat moderne të bazuara në traditë, duke adresuar kështu sfidat bashkëkohore. Ato po u përgjigjen pyetjeve në lidhje me marrëdhëniet e shëndetit mendor, financat, etikën, politikën dhe teknologjinë përmes një lente islame. Imagjinoni thellësinë e studimeve që do të ekzistojnë deri në vitin 2050, kur kjo gjeneratë të bëhet studiuesja e lartë që mëson mijëra njerëz në të gjithë botën.

Por ndoshta një nga ndryshimet më interesante që çojnë në ngritjen e Islamit është ndryshimi në narrativat globale. Njerëzit janë të lodhur nga premtimet sipërfaqësore të modernitetit. Ata po e pranojnë se kanë nevojë për vlera, vlera të vërteta. Dhe kur kërkojnë këto vlera, e gjejnë Islamin duke pritur me parime të përjetshme, ndershmëri, drejtësi, përlësi, disiplinë, mirënjohje, modesti, durim dhe dhembshuri. Ngritja e Islamit deri në vitin 2050 nuk do të jetë thjesht rritja e myslimanëve, do të jetë kthimi i vlerave, njerëzimi ka humbur. Sepse Islami nuk ngrihet për të marrë kontrollin, ngrihet për të rivendosur ekuilibrin, për t'ia kujtuar botës moralin, dinjitetin, familjen, respektin, përgjegjësinë dhe themelet shpirtërore. Dhe ndërsa njerëzit vazhdojnë të eksplorojnë Islamin, diçka e bukur fillon të ndodhë, ata fillojnë ta shohin Pejgamberin Muhamed ndryshe, të lexojnë për karakterin e tij, për mëshirën e tij, për udhëheqjen e tij, për durimin e tij, për

guximin e tij, për përsosmërinë e tij. Ata e kuptojnë se bota nuk ka prodhuar kurrë një njeri më të plotë se ai. Dhe sa më shumë të mësojnë për të, aq më shumë e respektojnë. Deri në vitin 2050, kurioziteti global për jetën e Pejgamberit do të arrijë nivele të papara, shkollat, universitetet, studiuesit, dhe historianët do të thellohen më thellë në mësimet e tij jo vetëm si një figurë fetare, por si një model universal për etikën, paqen dhe njerëzimin.

Ky ndryshim do të ndryshojë gjithashtu mënyrën se si kuptohet qytetërimi islam. Njerëzit do të rizbulojnë epokën e artë të Islamit, kontributet e matematikanëve, mjekëve, astronomëve, filozofëve, arkitektëve dhe mendimtarëve myslimanë. Ky rizbulim do të frymëzojë një brez të ri inovatorësh myslimanë, që do ta çojnë këtë trashëgimi

përpara në vitin 2050 dhe më tej. Dhe diku në këtë transformim global, do të shihni diçka tjetër që po ngrihet - uniteti. Për një kohë të gjatë, bota myslimane ka qenë e ndarë nga politika, kufijtë dhe dallimet, por tani me komunikimin më të lehtë se kurrë, me njohuri të arritshme për të gjithë, me sfida globale të përbashkëta nga të gjithë, po formohet një ndjenjë e re lidhjeje. Myslimanët nga prejardhje të ndryshme po mësojnë të punojnë së bashku, të mbështesin njëri-tjetrin dhe të ngrënë moralin e njëri-tjetrit. Do të shihni bashkëpunime midis vendeve myslimane në shkencë, arsim dhe punë humanitare, do të shihni aleanca që i japin përparësi paqes dhe zhvillimit, do të shihni një umet që ngadalë shëron thyerjet e tij dhe fillon të qëndrojë përsëri si një. Dhe ky unitet, nuk është vetëm politik, është shpirtëror, është emocional, është kulturor. Myslimanët nga të gjitha kontinentet do të ndihen më afër sepse ndajnë të njëjtin Kuran, të njëjtën lutje, të njëjtin pejgamber, të njëjtin drejtim, të njëjtin shpresë. Ky unitet shpirtëror do të forcojë praninë globale të Islamit në mënyra që brezat e kaluar nuk mund t'i imagjinonin kurrë. Dhe ndërsa Islami vazhdon të ngrihet, shumë njerëz do të kthehen te mesazhi i tij më i thjeshtë dhe më i fuqishëm, te qëllimi.

Në një botë ku miliona ndihen të humbur, Islami do t'ua kujtojë atyre se janë krijuar qëllimisht, se jeta e tyre ka rëndësi, se ekzistenca e tyre është kuptimplote. Deri në vitin 2050, ky mesazh do të jetë një nga arsyet më të mëdha pse njerëzit përqafojnë Islamin. Të kuptuarit se besimi u jep atyre identitet, qartësi dhe drejtim.

Përktheu nga gjuha angleze: Hajrudin S. Muja

Njerëzit do të rizbulojnë epokën e artë të Islamit, kontributet e matematikanëve, mjekëve, astronomëve, filozofëve, arkitektëve dhe mendimtarëve myslimanë.

Libër që mbështillet me semantikë të pasur dhe argumentuese

Bilall Maliqi

(Avni Aliu, “Myslimani bashkëkohës”, BI, Gjilan, 2024, f. 260)


“Gjuha ruhet atje ku shkruhet”, apo: çdo gjë që shkruhet edhe ruhet. Me këtë thënie popullore po e nis këtë vështrim për një libër të veçantë me titull “Myslimani bashkëkohës”, i botuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame i

Gjilanit, dhe për një njeri po ashtu të veçantë, për hafëz Avni ef. Aliun. Ky libër është i veçantë për temat që ka trajtuar autori, por edhe për faktin se, si dorëshkrim i mbetur, botohet katërmbëdhjetë vjet pas vdekjes së tij.

Libri në fjalë është i ndarë në tre kapituj: Besimi islam, Etika islame dhe Hytbe dhe

Ky libër është i veçantë për temat që ka trajtuar autori, por edhe për faktin se, si dorëshkrim i mbetur, botohet katërmbëdhjetë vjet pas vdekjes së tij.





ligjërime, në të cilët ngjeshen tematika interesante dhe me interes për lexuesin, të trajtuara nga pena e një njeriu kompetent për shtjellimin e këtyre çështjeve, të sistemuara me kujdes në kapitujt përkatës.

Nuk thuhet kot se: “Pena e dijetarit është më e shenjtë se gjaku i dëshmorit” apo “Ngjyra e lapsit të nxënësit është më e shenjtë se gjaku i luftëtarit.” Këto thënie, që i atribuohen traditës islame, e lartësojnë vlerën e dijes dhe të shkrimit.

Kjo thënie i përshtatet këtij libri dhe shkrimeve të tjera të hairit, të cilat japin pozitivitet në shoqëri dhe në përditshmërinë tonë, duke synuar përmirësimin e devijimeve të mundshme shoqërore. Kjo më së miri pasqyrohet në kapitullin e parë, me titull “Besimi në Islam”, ku trajtohen tema interesante, të sistemuara me kujdes nga autori. Ai shpërfaq cilësitë e një myslimani të devotshëm në rrugën e Allahut, ngritjen e personalitetit të tij në Islam, ndjekjen e rrugës së Zotit, si dhe trajton botëkuptime të gabuara mbi jetën. Në këto trajtime jepen argumente të mbështetura në literaturën

islame dhe në ajetet kuranore, duke e bërë tekstin më të plotë, më të lexueshëm, më të pranueshëm dhe me qasje analitike.

Në kapitullin e dytë, me titull “Etika islame”, paraqiten trajtime të ngjeshura dhe me rëndësi për lexuesin, shumë prej të cilave mund të mos kenë qenë të njohura për një pjesë të tyre. Autori, me mjeshtëri krijuese, ka ditur çfarë t’u ofrojë lexuesve dhe çfarë ata kanë nevojë të dinë më tepër për etikën (hijeshinë) islame, e cila duhet ruajtur, kultivuar dhe zbatuar në përditshmërinë tonë, në çdo rrafsh jetësor. Këtu trajtohen tema si: përgjegjësia nga këndvështrimi islam, qëndrimi i Islamit ndaj hallallit dhe haramit, ku theksohet qartë se, si në aspektin fetar ashtu edhe në atë moral, harami mbetet haram dhe e huaja nuk bëhet e jotja; përpjekja që ajo që fitojmë dhe konsumojmë të jetë hallall; pikëpamja e Islamit për bashkësinë njerëzore, për punën dhe veprën, për sinqeritetin dhe forcimin e tij, për zbutjen e mjerimit dhe ndihmën ndaj shtresave më të përvuajtura të shoqërisë, si dhe për planifikimin e një jete dinjitoze. Kapitulli përmbyllet me trajtimin e ndodhive përtej varrit, temë kjo me interes të veçantë për lexuesin.

Në kapitullin e fundit paraqiten ligjëratat që hoxha i nderuar i ka mbajtur ditëve të xhumasë dhe në raste të ndryshme, ku i është dhënë mundësia të trajtojë tema të ndryshme, të cilat më pas i ka sistemuar në këtë libër.

Në libër janë përfshirë edhe hytbetë e mbajtura në xhami, me tematika që lidhen me Ramazanin, muajin e shenjtë, agjërimin dhe begatitë që ai sjell, bereqetin e Natës së Kadrit dhe kuptimin shumëdimensional të namazit. Me këto tema përmbyllet përmbajtja e këtij libri.

“Vendi më i mirë në dynja është vendi ku bën sexhde, ndërsa shoku më i mirë është libri.”

Me këtë thënie po e përmbyll vështrimin tim për këtë libër, i cili ka vlerën e vet të padiskutueshme. Duke e lexuar, lexuesi pajiset me dije shtesë, duke përfutuar nga përmbajtja e tij dhe duke u mbështjellë me të mira, pozitivitet, drejtësi, kuptimshmëri dhe me porositë që dalin nga kapitujt dhe nënkaptujt që e përshkojnë librin.

Ky libër i bën nder shkencës islame; prandaj duhet të jetë pjesë e të gjitha bibliotekave, si atyre islame ashtu edhe atyre publike, me qëllim që t’i ofrohet për lexim popullatës sonë.

Ndriçime historike (2)

ZËRAT E QËNDRESËS – HOXHALLARËT QË MBROJTËN FENË DHE ATDHEUN

Harun Shabanaj


Historia e hoxhallarëve shqiptarë në Kosovë nuk është vetëm histori e shërbimit fetar, por edhe histori e qëndresës kombëtare, e sakrificës dhe e përballjes së vazhdueshme me dhunën shtetërore, ideologjike dhe kulturore. Në periudha të errëta, pushtimi dhe represioni, imamët shqiptarë ishin jo vetëm udhërrëfyes shpirtërorë të popullit, por edhe zëra të guximshëm të ndërgjegjes kombëtare, të cilët me fjalë, vepra dhe qëndrim, mbronin fenë islame, identitetin shqiptar dhe të drejtën për të jetuar të lirë në tokën e vet.

MULLA DESTAN (SHABAN) PAQARIZI (1911-1986)

Destan Paqarizi i takon brezit të hoxhallarëve dhe atdhetarëve, të cilët, edhe në kushte të jashtëzakonshme, u shkolluan dhe u edukuan në frymën fetare islame dhe atë kombëtare shqiptare. Ai, për asnjë moment, nuk pushoi së vepruari në të mirë të fesë islame dhe interesit të kombit shqiptar, me qëllim çlirimin e Kosovës nga pushtimi serbo-jugosllav.

Destan Paqarizi lindi në vitin 1911 në fshatin Dragobil të trevës së Llapushës. Që në ditët e para të fëmijërisë mbeti jetim, pasi i vdesin të dy prindërit, duke mbetur nën përkujdesjen e vëllait të tij, Hasanit.

“Ju serbët nuk keni ardhur këtu për të na civilizuar, por qëllimi juaj kryesor është të na detyroni ta lëshojmë Kosovën dhe të shkojmë për në Turqi. Ju garantoj se ne shqiptarët nuk lëvizim nga ky vend; kemi lindur, këtu do jetojmë dhe këtu do të vdesim. Allahu ka dashur kështu dhe na ka krijuar këtu.”



Mulla Destan (Shaban) Paqarizi (1911-1986)

Mësimet e para i mori nga kushëriri i tij, mulla Sejdi Paqarizi. Në kushte të rënda ekonomike, ai u detyrua të punonte si shitës. Në moshën 17-vjeçare u regjistrua në Medresenë e Gjakovës, ku pas dy vjet shkollimi, u transferua në Medresenë e Prizrenit dhe përfundoi me sukses shkollimin për hoxhë. Pas mbarimit të shkollës, Mulla Destani u emërua imam në fshatin Peqan të Suharekës, ku punoi për 17 vjet.

Gjatë aksionit për heqjen e havales (mbulesës), organet e sigurimit shtetëror në Suharekë, nën drejtimin e Spasoje Gjakoviçit, urdhëruan mbajtjen e një mbledhjeje me

pjesëmarrjen e popullit dhe hoxhallarëve. Para të pranishmëve foli zyrtari Gjakoviç. Pas tij, fjalën e mori Mulla Destani, i cili shpjegoi se mbulesa është urdhër nga Allahu xh.sh., e padiskutueshme për myslimanët, dhe iu drejtua punonjësve shtetërorë:

“Ju serbët nuk keni ardhur këtu për të na civilizuar, por qëllimi juaj kryesor është të na detyroni ta lëshojmë Kosovën dhe të shkojmë për në Turqi. Ju garantoj se ne shqiptarët nuk lëvizim nga ky vend; kemi lindur, këtu do jetojmë dhe këtu do të vdesim. Allahu ka dashur kështu dhe na ka krijuar këtu.”

Reagimi i organeve shtetërore ishte i menjëhershëm: Mulla Destani arrestohet dhe mbahet në një bodrum ku rrihet dhe keqtrajtohet. Të nesërmen lirohet, por urdhërohet të paraqitet çdo ditë në stacionin e Policisë në Suharekë. Një ditë arrestohet përsëri dhe mbahet nën tortura nga punonjësi Millan Guriqi. Ai u detyrua të ecte krah për krah me Millanin në ditën e tregut, me qëllim komprometimin e tij. Megjithatë, populli e respektoi dhe nderoi Mulla Destanin, duke treguar autoritetin e madh që kishte.

Pas kësaj ngjarjeje, Millani largohet dhe Mulla Destani largohet nga detyra e imamit në Peqan, duke vazhduar punën në xhaminë e “Hoqa Mahallës” në Prizren, më pas në Mushtisht të Suharekës dhe në Rogovë të Hasit për muajin Ramazan. Organet shtetërore, duke penguar grumbullimin e popullit, mbyllin xhaminë, por Mulla Destani organizoi faljen e teravive në odën e Beqë Selimit dhe namazin e Bajramit në livadh të hapur.

Gjatë kohës kur popullsia shqiptare shpërngulej për në Turqi, Mulla Destani bënte thirrje që të mos lëshohej trualli i të parëve, gjë që rezultoi në arrestimin e tij për të tretën herë dhe futjen në listën e UDB-së.

Pas një angazhimi të gjithanshëm në shërbim të fesë dhe kombit, Mulla Destani vdiq në vitin 1986.

MULLA AZEM SINANI (1919-1974)

Azem Sinani lindi në fshatin Carrallukë më 1919. Mësimet e para i mori në mejtepin e Carrallukës nga Mulla Musli efendi Ramadani. Shkollën katërvjeçare në gjuhën serbo-kroate e përfundoi në vendlindje, ndërsa shkollimin e mesëm e vijoi për disa vite në Medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren. Nga Medreseja e Prizrenit, ai transferohet në Medresenë e Madhe të Gjakovës, ku ndiqte mësimet nën drejtimin e hoxhës së njohur Fahri efendiu.

Gjatë kohës si nxënës në Medresenë e Gjakovës, ai përveç mësimëve, përcillte me kujdes edhe shtypin dhe rrjedhat politike. Si djalosh i përgatitur dhe përparimtar, në vitin 1939 i bashkohet lëvizjes së Ballit Kombëtar dhe betohet përmes veprimtarit dhe patriotit Mit’hat Frashëri.



Mulla Azem Sinani (1919-1974)

Pas qëndrimit në Shqipëri, në prill të vitit 1940, ai u kthye në Kosovë dhe u dërgua në shërbimin ushtarak në Krlevograd të Beogradit. Më 7 prill 1941, pas sulmit të Gjermanisë ndaj Jugosllavisë, Azemi kthehet në Kosovë. Në Mitrovicë arrestohet nga ushtria gjermane, qëndroi dy javë në burg, u arratis dhe u kthye në fshatin e tij, Carrallukë, duke rinisur studimet në Gjakovë. Ai mësoi edhe te mulla Maliq Sylejmani dhe mori pjesë në aktivitete politike me Mulla Ademin, Mulla Destanin, mulla Haxhi Rifatin dhe Mulla Rexhen.

Në dimrin e vitit 1943, me urdhër të Ballit Kombëtar, Azemi bashkë me luftëtarë nga Kosova kalojnë kufirin dhe hyjnë në Shqipëri, duke luftuar në dy fronte: kundër nazifashizmit dhe kundër komunistëve, të cilët ishin në aleancë me komunistët jugosllavë.

Gjatë vitit 1944, Azemi kthehet në Kosovë dhe qëndron një vit në ilegalitet. Në vitin 1945, dorëzohet pranë policisë serbo-jugosllave, me garancinë e Metë Sahitit se nuk do të pushkatohej, por do të mbahej në burg. Ai dërgohet fillimisht në burgun e Rahovecit, pastaj në Prizren dhe Prishtinë, ku qëndroi një vit dhe keqtrajtohet në mënyra të rënda fizike dhe psikologjike.

Pas lirimit, ai detyrohet të paraqitet çdo javë në organet shtetërore, por vazhdon të ketë probleme me UDB-në dhe individë si Drag Kuqi dhe Milosvli. Mulla Azemi merr pjesë në aktivitete fetare dhe shpreh hapur mendimet kundër sistemit komunist, duke demaskuar politikën komuniste dhe duke paralajmëruar për rrezikun ndaj shqiptarëve.

Në vitin 1950, organet serbo-jugosllave bastisin shtëpinë e tij në Carrallukë dhe e arrestojnë për një vit në burgun e Rahovecit për aktivitet antikomunist. Në vitin 1952, kundërshtoi fushatën për heqjen e havales dhe për këtë qëndrim arrestohet dhe mbahet tre muaj në burg.

Pas këtyre persekutimeve, Mulla Azemi nuk i ndahet kurrë shërbimit ndaj fesë dhe kombit. Ai nuk u lejua të punonte imam i rregullt, por kryente funksionin e hoxhës si imam i Ramazanit në Kijevë, Volljakë dhe Bubavec.

Pas një veprimtarie disavjeçare, Mulla Azemi vdiq në vitin 1974, duke lënë një trashëgimi të pasur patriotike dhe fetare, dhe duke mbetur shembull i virtytit dhe karakterit të lartë.

MULLA HALIT KASTRATI (1920-1999)

Halit Kastrati lindi në vitin 1920 në Turjak të trevës së Llapushës. Mësimet e para për dy vjet i kreu te mulla Hilmi Maliqi në Rahovec. Medresenë “Mehmed Pasha” e kreu në Prizren, ku për gjashtë vjet arriti suksese të mëdha. Pas përfundimit të shkollimit në Prizren, ai vazhdoi mësimet edhe në Gjakovë. Megjithatë, Haliti nuk arriti të marrë ixhazetin, pasi shteti ia kishte hequr këtë të drejtë hoxhallarëve.

Përveç mësimave, Haliti ndiqte edhe ligjëratat e hoxhallarëve. Ai ishte dashamirës i madh i librit dhe i dijeve të reja, çka tregohet edhe nga fakti se gjatë kohës si nxënës në Medrese bleu bibliotekën e mësimdhënësit të tij, mulla Avdullah Hafëzit.

Pas përfundimit të medresesë, Haliti u emërua imam në xhaminë e fshatit Zatriq, vend nga i cili rridhte familja e tij. Ai filloi të kundërshtonte sistemin komunist dhe ligjëronte kundër komunizmit dhe padrejtësive ndaj popullit shqiptar. Po ashtu, u angazhua kundër heqjes së havales (mbulesës). Aktiviteti i tij vëzhgohej hap pas hapi nga organet shtetërore serbe, të cilat e arrestuan dhe e dërguan në burgun e Rahovecit. Atje ai u keqtrajtuar në mënyra çnjerëzore. Pas hetimeve, u dënua me tre vjet burg, të cilin e vuajti në Dush të Sferkës së Klinës, pastaj në Nish dhe Prizren.

Aktiviteti i tij i gjithanshëm bëri që të futet në listën e UDB-së për shpërngulje në Turqi bashkë me familjen. Ai kundërshtoi fuqishëm këtë dhe këshillonte popullin që të mos lëshonin trojet shqiptare, duke theksuar se është më mirë të vdesësh në vendin tënd se sa të jetosh në vend të huaj.

Mulla Haliti ishte iniciator i ndërtimit të një godine të xhamisë në fshatin Turjak, gjë që alarmoi organet shtetërore, të cilat e thërrisnin në stacionin e policisë dhe i ndalonin ndërtimin.



Mulla Halit Kastrati (1920-1999)

Mulla Haliti ishte iniciator i ndërtimit të një godine të xhamisë në fshatin Turjak, gjë që alarmoi organet shtetërore, të cilat e thërrisnin në stacionin e policisë dhe i ndalonin ndërtimin. Në vitin 1961, ai filloi detyrën e imamit në xhaminë e fshatit Samadrexhe të Suharekës, ku punoi për 16 vjet. Në vitin 1981, policia e arrestoi për armë të mbajtur në ilegalitet, ndërsa nga viti 1984 deri në 1989, punoi si imam në xhaminë e fshatit Marali, duke e kryer detyrën pa kompensim.

Mulla Haliti dha kontribut të madh në jetën e komunitetit, duke përfshirë ndërtimin e shkollës dhe organizime të tjera lokale. Ai nuk la trashëgimtarë dhe vdiq në vitin 1999.

MULLA HAXHI RIFATI (1923-1977)

Haxhi Rifati lindi në vitin 1923 në fshatin Vërmicë. Mësimet e para i mori nga babai i tij dhe më pas te mulla Maliq Sylejmani. Shkollën fillore katërvjeçare në gjuhën serbo-kroate e kreu në Carallukë. Shkollimin e mesëm e përfundoi në Medresenë e Madhe të Gjakovës. Pas përfundimit të medresesë, ai u punësua si imam në fshatin e tij të lindjes, Vërmicë.

Me fillimin e punës si imam, u shqua për edukimin e brezave të rinj dhe bënte thirrje për dashuri ndaj kombit dhe fesë. Ai angazhohej në aktivitete atdhetare, ndikimi i të cilave ishte i ndikuar edhe nga lidhjet familjare, duke qenë mik me Mulla Metën e Krajkovës, i cili ishte i përndjekur si delegat i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.



Veprimtaria kombëtare e tij ra në sy të organeve të sigurimit shtetëror serbo-jugosllav, të cilat e vunë nën ndjekje. Për t'iu shmangur thirrjeve të policisë, në vitin 1951 u nis për në Shqipëri dhe qëndroi atje për disa kohë. Në vitin 1953, kthehet në Kosovë dhe një ditë ndalohet nga policia. Pas kontrollit i gjetën në xhep një flamur kuq e zi, i ndaluar atëkohë në Kosovë, dhe u arrestua. Ai mbahet dy vjet në burgim në Prizren (1955-1953), dhe më pas pesë vjet në burgun e Nishit (1955-1960), ku u keqtrajtuar në mënyra barbare, duke përfshirë qëndrimin në ujë të ftohtë me akull.

Vuajtjet e tij ishin të njohura edhe për familjen. Motrat e tij Sedberia dhe Suba, së bashku me djalin Izetin, vizituan Mulla Haxhin në burg. Dëshmia e Izetit tregon gjendjen e rëndë fizike të babait dhe ndikimin emocional të familja.

Pas lirimt në vitin 1960, mulla Haxhi Rifati duhej të paraqitej çdo tre muaj në stacionin policor. Ai izolohej gjatë vizitave të zyrtarëve jugosllavë dhe serbë për shkak të ndikimit të tij të madh në popull. Pas lirimt nuk u kthye më si imam aktiv për shkak të shëndetit dhe kaloi pjesën më të madhe të jetës në spitale.

Mulla Haxhi Rifati vdiq më 15 maj 1977. Ai mbahet mend si një hoxhë që gjithmonë

Figura e hoxhës nuk është thjesht simbol fetar, por një vlerë morale dhe patriotike, një kujtesë e gjallë e qëndresës shqiptare për të mbrojtur fenë, identitetin dhe tokën e tyre.

nxiste dashuri për fenë, kombin shqiptar dhe atdheun.

Historia e këtyre hoxhallarëve shqiptarë është dëshmi e jashtëzakonshme e guximit, besnikërisë ndaj fesë dhe përkushtimit ndaj atdheut. Ata nuk ishin thjesht udhërrëfyes shpirtërorë, por edhe mbrojtës të identitetit kombëtar, të drejtave të popullit dhe të lirisë për të jetuar në tokën e tyre. Përballë represionit, përndjekjes, burgimeve dhe torturave, ata qëndruan të palëkundur në parimet e tyre dhe në detyrën e tyre ndaj Zotit dhe kombit shqiptar.

Ky ndriçim historik ka për qëllim të ruajë kujtesën për kontributin e tyre, të denoncojë padrejtësitë që ata përjetuan dhe të shërbejë si shembull frymëzimi për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Figura e hoxhës nuk është thjesht simbol fetar, por një vlerë morale dhe patriotike, një kujtesë e gjallë e qëndresës shqiptare për të mbrojtur fenë, identitetin dhe tokën e tyre.

Në një kohë kur sfidat ndaj fesë islame dhe figurës së hoxhës vazhdojnë, kujtimi dhe dokumentimi i jetës dhe veprimtarisë së këtyre personalitetëve bëhet një detyrë morale dhe kombëtare, që ruan të vërtetën historike dhe nderon sakrificën e atyre që dhanë gjithçka për kombin dhe fenë.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA EMIRI I KATARIT, TAMIM BIN HAMAD AL THANI

Më 23 shkurt 2026, me ftesë të emirit të Katarit, Tamim bin Hamad al Thani, kryetari i Bashkësia Islame e Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në iftarin e shtruar nga emiri i Katarit.

Myftiu Tërnavë ishte në mesin e shumë mysafirëve të nderit në këtë iftar.

Emiri Tamim bin Hamad al Thani, e shtroi këtë iftar në pallatin e tij, ku të ftuar ishin dijetarë, gjykatës, dhe myftinjë nga vende të ndryshme.

Në këtë iftar morën pjesë edhe sheiku Xhasim bin Hamad al Thani, përfaqësuesi personal i emirit, ministri i Vakëfeve i Katarit, Al Ganimi, si dhe një numër i madh i dijetarëve dhe personaliteteve të shquara islame.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E UNMIK-UT NË KOSOVË, Z. PETER N. DUE

Më 18 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim shefin e ri të Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në Kosovë, z. Peter N. Due. Fillimisht Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me historikun, punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas e uroi atë për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme.

Më pas, gjatë këtij takimi u diskutua për rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës në promovimin e tolerancës ndërfaqetare dhe harmonisë sociale në vend.

Myftiu Tërnavë theksoi se BIK-u ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e bashkëjetesës fetare dhe ka qenë gjithmonë i përkushtuar për të ndërtuar ura mirëkuptimi mes komuniteteve të ndryshme. Ai falënderoi UNMIK-un për

bashkëpunimin dhe mbështetjen në promovimin e dialogut ndërfaqetare.

Nga ana e tij, z. Peter N. Due, fillimisht e falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, e më pas vlerësoi kontributin e BIK-ut në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë. Ai theksoi rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit mes institucioneve fetare dhe organizatave ndërkombëtare për të forcuar kohezionin social dhe respektin e ndërsjellë mes komuniteteve.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E TURQISË, Z. TUNC ANGLI

Më 26 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Tunc Angli.

Me këtë rast, ambasadori Angli, e uroi Myftiun Tërnavë dhe nëpërmes tij gjithë besimtarët myslimanë në Kosovë për muajin e bekuar Ramazan, duke u

dëshiruar agjërime të lehtë dhe të pranuar.

Nga ana e tij, Myftiu Tërnavë, e falënderoi ambasadorin për vizitën dhe për urimet e përcjella, duke shprehur mirënjohje të thellë për shtetin mik turk për ndihmat e vazhdueshme që ka dhënë për popullin e Kosovës, e në veçanti për përkrahjen dhe ndihmat e ofruara në fillim të muajit Ramazan.

Gjatë takimit, u vlerësua lart bashkëpunimi i deritanishëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të Turqisë, duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi në fusha me interes të përbashkët, në shërbim të besimtarëve dhe të shoqërisë në përgjithësi.



MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I MITROVICËS, Z. FATON PEÇI



Më 12 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga kryetari i Mitrovicës, z. Faton Peci.

Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi kryetarin z. Peci për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në udhëheqje. Ai më pas shprehu gatishtësinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për të vazhduar bashkëpunimin e mirë që

kanë pasur dy institucionet ndërmjet vete, gjithnjë për të mirën e qytetarëve.

Nga ana e tij, kryetari z. Peci, falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën, duke theksuar kështu rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PRONARIN E KOMPANISË “AMO”, Z. SAMI MORINA

Më 3 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim pronarin e kompanisë “Amo”, z. Sami Morina.

Gjatë këtij takimi, u vlerësua bashkëpunimi i deritanishëm dhe përkushtimi i kompanisë “AMO” në respektimin e standardeve hallall. Me këtë rast, u bë edhe ricertifikimi i kësaj kompanie nga Instituti Hallall i Bashkësisë Islame të Kosovës.

Po ashtu, Myftiu Tërnavë e falënderoi z. Morina për kontributin e tij të vazhdueshëm si një nga donatorët e rregullt të Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, duke theksuar kështu rëndësinë e mbështetjes së aktiviteteve humanitare dhe sociale.



U KONSTITUUA KËSHILLI DREJTUES I IHSI-SË

Më 4 shkurt 2026, me pjesëmarrjen e kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe të drejtorit të Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, u mbajt mbledhje konstituive e Këshillit Drejtues të këtij Instituti.

Myftiu Tërnavë, në fjalën e tij vlerësoi lart punën dhe angazhimin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame në

organizimin e konferencave, tryezave dhe seminareve të ndryshme, ku me këtë rast, falënderoi anëtarët e deritanishëm të këtij Instituti për punën dhe kontributin e tyre të dhënë. Ai u uroi suksese anëtarëve të rinj, duke u ofruar kështu përkrahjen e nevojshme të Kryesisë së BI-së për projektet e tyre.

Edhe drejtori i IHSI-së, prof. Sabri Bajgora, uroi anëtarët e rinj të Këshillit

Drejtues, duke u uruar punë të mbarë dhe të suksesshme, e njëherësh kërkoi nga ta që të angazhohen maksimalisht për të dhënë kontribut në punët e këtij Instituti.

Këshilli Drejtues tanimë përbëhet nga: Sabri Bajgora, Besim Mehmeti, Orhan Bislimaj, Besir Neziri, Muharrem Tërnavë, Rexhep Suma dhe Abdulkadër Arnauti.



DEKLARATË E KRYESISË SË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në mbledhjen e sotme, të kryesuar nga Myftiu Naim ef. Tërnavë, përveç vendimeve të tjera, vendosi që të përkrahë fuqishëm marshin protestues “Liria ka emër”, i cili është paraparë të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbështetje të çlirimtarëve tanë, që padrejtësisht po mbahen dhe po tentohen të dënohen në Hagë.

Kryesia e BIK-ut, gjyqin në Hagë e konsideron një proces me prapavijë politike, që ka për qëllim atakimin e vlerave të UÇK-së. Për popullin e Kosovës, UÇK-ja mbetet vlera më sublimë, e mishëruar me lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e popullit dhe vendit tonë. Është e papranueshme



që të relativizohen krimet serbe dhe, në të njëjtën kohë, përmes gjyqeve politike të krijohet një baraspeshë e rreme, siç po tentohet të veprohet nga gjykata në Hagë.

Kryesia vendosi që hytbeja e xhumasë, ditën e premte më 13 shkurt, në të gjitha xhamitë e Kosovës, t'i kushtohet 17 Shkurtit – Ditës së

Pavarësisë së vendit dhe tema bosht të jetë mesazhi përkrahës për luftëtarët e lirisë.

Kryesia e BIK-ut po ashtu mbështet fuqishëm deklaratën e djeshme të Myftiut Naim ef. Tërnavë kundër kërkesës së prokurores së Dhomave të Specializuara, e cila ka kërkuar dënim për çlirimtarët tanë.

Presim lirim të çlirimtarëve tanë dhe besojmë se drejtësia do të fitojë. Ftojmë të gjithë që të marrin pjesë në marshin protestues në mbështetje të çlirimtarëve tanë më 17 shkurt në Prishtinë.

Prishtinë, më 10 shkurt 2026

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 10 shkurt 2026, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt, të cilën e kryesoi kryetari i saj, Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Gjatë kësaj mbledhje u diskutua për përgatitjet rreth muajit të bekuar Ramazan, i cili këtë vit fillon më 19 shkurt 2026.

Gjatë kësaj mbledhje Kryesia vendosi që të përkrahë fuqishëm marshin protestues “Liria ka emër”, i cili është paraparë të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbështetje të çlirimtarëve tanë, që padrejtësisht po mbahen dhe po tentohen të dënohen në Hagë.

Ndër të tjera, gjatë kësaj mbledhje u vendos edhe që hytbeja e xhumasë, ditën e premte më 13 shkurt, në të gjitha xhamitë e Kosovës, t'i kushtohet 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së vendit dhe tema bosht të jetë mesazhi përkrahës për luftëtarët e lirisë.



FILLOI IMPLEMENTIMI I PROJEKTIT “SHPORTA USHQIMORE 5 NË REPUBLIKËN E KOSOVËS – 2026”

Më 11 shkurt 2026, në prag të fillimit të muajit të bekuar Ramazan, në Prishtinë, ka filluar së implementuari projekti “Shporta Ushqimore 5 në Republikën e Kosovës – 2026”, e cila mundësohet nga Qendra e “Mbretit Selman” të Arabisë Saudite.

Në hapje të këtij projekti, i pranishëm qe edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Feisal Hifzi, drejtoresha e Mirëqenies Sociale në komunën e Prishtinës, znj. Adelina Sahiti dhe përfaqësuesi i Qendrës së “Mbretit Selman”.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu Tërnavë, falënderoi shtetin mik të Arabisë Saudite për ndihmat e vazhdueshme që kanë dhënë për Kosovën në përgjithësi dhe për Bashkësinë Islame të Kosovës në veçanti. “Më lejoni që para jush të përmendi hadithin e Pejgamberit a.s., i cili ka thënë se nuk e falënderon Allahun, ai i cili nuk ka falënderuar njerëzit, andaj më lejoni që të falënderoj Mbretin e Arabisë Saudite, ambasadorin Feisal Hifzi, përfaqësuesit e Qendrës së “Mbretit Selman” për kontributin dhe përkushtimin e tyre për të qenë pranë popullit të Kosovës dhe pranë Bashkësisë Islame të

Kosovës”, tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Ambasadori i Arabisë Saudite, z. Feisal Hifzi, në fjalën e tij tha se këto ndihma janë vetëm një prej dëshmive të vëllazërisë sonë, andaj sot jemi këtu për të falënderuar Myftiun Tërnavë për gatishmërinë e tij dhe të institucionit që ai drejton për të bashkëpunuar me ne.

Edhe drejtoresha e Mirëqenies Sociale në komunën e Prishtinës, znj. Adelinë Sahiti, falënderoi ambasadorin e Arabisë Saudite për këto ndihma të cilat tashmë janë bërë tradicionale. Ajo tha se përveç tyre, shteti mik i Arabisë Saudite, ka kontribuar në vazhdimësi për popullin e Kosovës në sfera të ndryshme.

Projekti synon të shpërndajë 8,017 pako ushqimore, që përmbajnë artikuj ushqimorë thelbësorë, si: oriz, vaj, makarona, fasule, sheqer dhe miell.

Kjo iniciativë është pjesë e përpjekjeve humanitare dhe ndihmëse të Mbretërisë, të përfaqësuara nga Qendra e Ndihmës Humanitare “Mbreti Selman”.



NË MITROVICË U HAP EKSPOZITA ME XHAMITË E SHKATËRRUARA NË KOSOVË DHE BOSNJE DHE HERCEGOVINË

Më 12 shkurt 2026, është hapur në qytetin e Mitrovicës ekspozita me fotografi nga xhamitë e shkatërruara gjatë luftës në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë.

Përmes fotografive, edhe në këtë qytet po dokumentohen dëmet ndaj objekteve fetare islame gjatë viteve '90, duke sjellë dëshmi vizuale të

shkatërrimeve të planifikuara të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Në hapje të kësaj ekspozite morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të komunës së Mitrovicës, përfaqësues të organeve të sigurisë vendore dhe ndërkombëtare, imamë si dhe një numër i konsideruar i qytetarëve.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu, Naim ef. Tërnavë tha se armiku i përbashkët i Kosovës dhe Bosnjës kishte për qëllim që përmes një gjenocidi të organizuar të shkatërrojë jo vetëm popujt, por kishte për qëllim zhdukjen e identitetit fetar dhe kulturor.

Kryetari i Mitrovicës, z. Faton Peci, tha se përmes kësaj ekspozite po dëgjohet zëri i një krimi të organizuar, si ndaj njerëzve ashtu edhe ndaj kulturës dhe trashëgimisë sonë.

Historiani Enis Kelmendi theksoi se shkatërrimi i objekteve fetare në rajon nuk ishte i rastësishëm, duke përmendur se në Kosovë dhe Bosnje e Hercegovinë afër 80% e xhamive u dëmtuan ose u rrënuan gjatë luftës.



NË FERIZAJ U MBAJT MANIFESTIMI “PAVARËSIA DHE RAMAZANI”

Më 13 shkurt 2026, në Ferizaj u mbajt manifestimi “Pavarësia dhe Ramazani”, i cili u organizua nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Ferizajt.

Në këtë manifestim mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, kryetari i Ferizajt, z. Agim Aliu, kryetari i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Nexhmedin ef. Bajrami, si dhe shumë të pranishmë të tjerë.

Programi filloi me intonimin e himnit kombëtar dhe shtetëror, e më pas edhe me leximin e disa pjesëve nga Kurani fisnik, ku më pas, me një fjalë përshëndetëse të pranishmëve iu drejtua kryetari i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Nexhmedin ef. Bajrami.

Një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe kryetari i Ferizajt, z. Agim Aliu, i cili tha se ashtu si Pavarësia e Republikës, ashtu edhe i shenjtë muaj Ramazan, që simbolikisht po ndajnë muajin shkurt, kanë vetëm një fjalë që i bashkon dhe i përshkruan: Sakrificë.

Ligjëratën kryesore kushtuar muajit Ramazan dhe përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, e mbajti Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili ndër të tjera tha se jemi mbledhur në këtë ambient të mrekullueshëm, në një çast të veçantë

ku ndërthuren dy ngjarje me peshë të jashtëzakonshme për qenien tonë kombëtare dhe shpirtërore: ardhja e muajit të bekuar Ramazan dhe përkujtimi i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Myftiu Tërnavë më pas foli rreth historisë së Kosovës, për të cilën tha se po t'i kthehemi asaj, qoftë edhe për një çast, do të përballemi me një të kaluar të dhimbshme, të shënuar nga padrejtësi të rënda, nga pushtime të egra dhe përpjekje të pandërprera për zhdukje e asimilim. Megjithatë, përkundër vuajtjeve, historia jonë është një histori qëndrore, një histori e një populli që kurrë nuk e humbi shpresën, as besimin në Zot, as dashurinë për atdheun.

Pas gjithë këtyre viteve të rënda për popullin e Kosovës, Myftiu Tërnavë, kujtoi me krenari edhe shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

“Ky proces arriti kulmin më 17 shkurt 2008, kur Parlamenti i Kosovës, si shprehje e sovranitetit qytetar, shpalli Pavarësinë e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur. Ky akt historik nuk ishte thjesht një vendim politik; ai ishte kurorëzimi i një përpjekjeje shekullore për liri, dinjitet dhe vetëvendosje. Ishte realizimi i amanetit të dëshmorëve, i sakrificës së brezave, i qëndresës së pandërprerë të një populli që kurrë nuk

hoqi dorë nga e drejta e tij për të qenë zot i fatit të vet. Pavarësia e Kosovës shënoi triumfin e drejtësisë mbi shtypjen, të shpresës mbi frikën dhe të lirisë mbi robërinë.”

Myftiu Tërnavë, gjatë fjalës së tij, nuk la pa përmendur edhe padrejtësitë që po u bëhen udhëheqësve të Kosovës nga Dhomat e Specializuara të Hagës. “Njëzet e gjashtë vjet pas përfundimit të luftës çlirimtare, kur Kosova ka ndër-tuar institucionet e saj dhe ka shpallur pavarësinë si shtet sovran, po përballemi me një realitet të ndjeshëm dhe thellësisht emocional për shoqërinë tonë: përpjekjet për të gjykuar krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë”, tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Në fund të fjalës së tij, Myftiu Tërnavë, kërkoi që ta shfrytëzojmë këtë muaj të bekuar për ta forcuar ndërgjegjen tonë kombëtare dhe fetare, për të nderuar me përlësi dëshmorët dhe të gjithë ata që sakrifkuan për lirinë tonë, dhe për të ndërtuar një të ardhme të denjë për gjakun dhe mundin e tyre. Të jemi të bashkuar në vlera, të fortë në besim, të palëkundur në përkushtim ndaj atdheut, fesë e drejtësisë.

Manifestimi më pas vijoi me një program të pasur artistik, me këndimin e ilahive dhe poezive kushtuar Ramazanit dhe Pavarësisë së Kosovës.



MYFTIU TËRNAVA VIZITOI VARREZAT E FAMILJES JASHARI NË PREKAZ

Më 17 shkurt 2026, për nder të 18-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe nga anëtarët e Kryesisë së BIK-ut, vizitoi varrezat e familjes Jashari në Prekaz.

Para varreve të Jasharve, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës, të kryesuar nga Myftiu Naim ef. Tërnavë, kënduan nga një Fatiha, duke lutur Zotin e Madhëruar që t'i ketë mëshiruar me mëshirën e Tij dhe t'i pranojë si dëshmorë-shehidë.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË MARRSHIN PROTESTUES “DREJTËSI, JO POLITIKË”

Më 17 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në marrshin protestues “Drejtësi, jo politikë”.

Ky marrsh protestues u organizua në përkrahje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë.

Kujtojmë se ditë më parë, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur, e konsideroi gjyqin në Hagë si një proces me prapavijë politike, që ka për qëllim atakimin e vlerave të UÇK-së. Ajo tha se për popullin e Kosovës, UÇK-ja mbetet vlera më sublimë, e mishëruar me lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e popullit dhe vendit tonë.

Gjithashtu, të premten e kaluar, më 13 shkurt 2026, hytbeja e xhumasë, në të gjitha xhamitë e Kosovës iu kushtua 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së vendit, si dhe u bë thirrje për pjesëmarrje në këtë marrsh përkrahës për luftëtarët e lirisë.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM, Z. NAIM GASHI



Më 18 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), z. Naim Gashi.

Gjatë këtij takimi, u diskutua për rëndësinë e cilësisë në arsimin e lartë, avancimin e standardeve akademike dhe forcimin e bashkëpunimit institucional në funksion të ngritjes së cilësisë në institucionet arsimore në vend, me theks të veçantë në ngritjen e cilësisë në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, duke i vënë rëndësi edukimit cilësor për zhvillimin e shoqërisë.

PRISHTINA NDRIÇOHET PËR NDER TË MUAJIT RAMAZAN



Më 18 shkurt 2026, ashtu siç tashmë është bërë traditë, për nder të fillimit të muajit të bekuar Ramazan, pjesa e Prishtinës së vjetër është ndriçuar me drita dekorative, për të sjellë kështu një atmosferë më të ngrohtë Ramazani. Përveç pjesë së Prishtinës së vjetër, këtë vit, është ndriçuar edhe sheshi kryesor i kryeqytetit, çka e bën edhe më madhështor këtë solemnit.

Në ceremoninë e ndezjes së dritave, të pranishëm qenë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë dhe kryetari i Prishtinës, z. Përparim Rama, shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët e tyre. Ata edhe njëherë uruan për fillimin e muajit të bekuar Ramazan, duke u dëshiruar gjithë agjëruesve, agjërime të lehtë dhe të pranuar.

MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË IFTARIN E SHTRUAR NGA KREU I AAK-SË, Z. RAMUSH HARADINAJ



Më 26 shkurt 2026, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin e shtruar nga kryetari i Aleancës

për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

Kryetari Haradinaj shprehu vlerësimin e tij për kontributin e çmuar të

Bashkësisë Islame të Kosovës në të gjitha periudhat drejt lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit.

Ai me këtë rast uroi të gjithë besimtarët myslimanë për agjërime të lehtë dhe të pranuar, me lutjet që të jemi së bashku gjithmonë në kultivimin e traditave tona të përhershme.

Myftiu Tërnavë falënderoi kryetarin Haradinaj për shtrimin e këtij iftari, duke potencuar kështu faktin se BIK-u, vazhdimisht angazhohet që në Kosovë të ketë harmoni e bashkëjetesë dhe respekt të ndërsjellë mes të gjithë njerëzve, pavarësisht dallimeve etnike dhe fetare që mund t'i kemi.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIN E MINISTRISË PËR ÇËSHTJE ISLAME TË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, MUHAMED BIN TURKI AL SHUMERI

Më 18 shkurt 2026, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i shoqëruar nga shefi i kabinetit të Myftiut, Besim ef. Mehmeti dhe nga zv.kryeimami i Kosovës, Fatmir ef. Iljazi, pritën në takim përfaqësuesin e Ministrisë për Çështje Islame të Mbretërisë së Arabisë Saudite, Muhamed bin Turki al Shumeri, i cili do të qëndrojë në Kosovë gjatë muajit Ramazan.

Gjatë këtij takimi u diskutua për organizimin e aktiviteteve fetare gjatë muajit Ramazan.

Kryeimami Sahiti i uroi mirëseardhje mysafirit, duke vlerësuar lart prezencën e tij në Kosovë, veçanërisht gjatë muajit

të bekuar Ramazan, si një kontribut i rëndësishëm në forcimin e lidhjeve

shpirtërore dhe bashkëpunimit ndër-institucional.



U INAUGURUA PROGRAMI PËR ORGANIZIMIN E IFTAREVE DHE SHPËRNDARJEN E HURMAVE

Më 22 shkurt 2026, në Prishtinë u inaugurua programi i Mbretërisë së Arabisë Saudite për shpërndarjen e iftareve dhe hurmave, i cili do të zgjasë gjatë muajit Ramazan. Programi përfshin organizimin e iftareve në qytete të ndryshme dhe shpërndarjen e hurmave për besimtarët

Zëvendësmyftiu i Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, falënderoi shtetin saudit për mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar rëndësinë e solidaritetit në Ramazan dhe duke shprehur mirënjohje për Mbretin Selman dhe institucionet përkatëse, me shpresë për thellim të bashkëpunimit.



Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, Feisal Hefzi, uroi besimtarët për agjërime të lehtë dhe u shpreh i lumtur që programi po realizohet në Kosovë në frymën e vëllazërisë. Ceremonia përfundoi me shtrimin e iftarit të parë në kuadër të projektit.

NË VUSHTRRI U HAP EKSPOZITA “KUJTESA NË FOTOGRAFI – XHAMITË E SHKATËRRUARA NË BOSNJË E HERCEGOVINË DHE KOSOVË GJATË VITEVE 90”

Më 23 shkurt 2026, në prani të përfaqësuesve të Bashkësisë Islame të Kosovës si dhe përfaqësuesve të Komunitetit të Vushtrrisë, sot, në qytetin e Vushtrrisë, u hap ekspozita “Kujtesa në fotografi – Xhamitë e shkatërruara në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë gjatë viteve 90”, e cila dokumenton shkatërrimin e xhamive në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë.

Fillimisht, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtrri, Ejup ef. Haziri, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe rikujtoi rolin që këto fotografi kanë në ruajtjen e kujtesës kolektive dhe në përcjelljen e së vërtetës tek brezat e rinj.

Kryetari i Vushtrrisë, z. Ferit Idrizi, e vlerësoi lart këtë organizim, duke theksuar rëndësinë e kujtesës dhe të ruajtjes së trashëgimisë fetare. Ai nënvizoi rëndësinë e objekteve fetare, duke theksuar dhimbjen dhe përgjegjësinë për ta ruajtur këtë histori.

“Regjimi serb nuk u mjaftua vetëm me gjenocid, por shkoi edhe më tej, duke kryer sakralocid. Sepse, po ta



zhdukësh një popull fizikisht, kryen gjenocid, por mbetet kultura dhe trashëgimia përmes objekteve fetare. Një fotografi flet sa një mijë fjalë, andaj fjalët tona janë të tepërta”, u shpreh ai.

Ndërkaq, drejtori për Veprimtari Botuese në Bashkësinë Islame të Kosovës, i cili njëherësh është edhe organizator i kësaj ekspozite, Ramadan Shkodra, theksoi se, përtej kontekstit historik, kjo ekspozitë dokumenton shkatërrime të kryera me përmbajtje

kriminale. Sipas tij, në Kosovë këto veprime dëshmojnë një sakralocid, që synonte eliminimin dhe zhdukjen e identitetit të popujve vetëm pse i përkisnin një etnie dhe besimi tjetër.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues institucionesh, imamë dhe qytetarë të shumtë, të cilët patën mundësinë të shohin nga afër dëshmitë fotografike të shkatërrimit të objekteve fetare gjatë luftës.



Zekati jepet në fondin e Bashkësisë Islame të Kosovës, për zhvillimin e jetës fetare dhe ngritjen e vlerave islame në vend, për nevojat e institucioneve fetaro-arsimore (Medresesë, Fakultetit të Studimeve Islame dhe Institutit për Studime dhe Hulumtime Islame), nga ku përgatiten dhe dalin kuadrot e reja për të shërbyer në rrugën e Zotit, si dhe për kategoritë e tjera sociale, përmes shoqatës humanitare “Bereqeti”.

LLOGARITJA E ZEKATIT 2026

| PARATË (euro) | | ARI (gram) | | ARGJENDI (gram) | |
|---------------|----------|------------|-----------|-----------------|----------|
| NGA | JEPET | NGA | JEPET | NGA | JEPET |
| 12,118 € | 302.95 € | 85 gr. | 2.125 gr. | 700 gr. | 17,5 gr. |
| 15,000 € | 375 € | 100 gr. | 2.5 gr. | 800 gr. | 20 gr. |
| 20,000 € | 500 € | 200 gr. | 5 gr. | 900 gr. | 22,5 gr. |
| 50,000 € | 1,250 € | 300 gr. | 7.5 gr. | 1000 gr. | 25 gr. |
| 100,000 € | 2,500 € | 500 gr. | 12.5 gr. | 2000 gr. | 50 gr. |

NË TREGTI-BIZNES

Mbi shumën 12,118 jepet 2.5%

Ky lloj përfshin: mjetet, veglat, rrobat, orënditë e ndryshme, gjërat ushqimore, tokat, makinat, ndërtesat etj. Gjithçka e nxjerrur për shitje, që konsiderohet prej pasurisë së tundshme apo të patundshme, me kusht që të kalojë një vit, nxirret prej tij **2.5%** nëse realisht arrihet nisabi (kuota e përcaktuar prej 12,118€).

ZEKATI NË DELE DHE DHI

PREJ

JEPET

40-120 krerë

1 dele/dhi

121-200 krerë

2 dele/dhi

201-300 krerë

3 dele/dhi

301-400 krerë

4 dele/dhi

401-500 krerë

5 dele/dhi

të gjitha njëvjeçare

ZEKATI NË TË MBJELLA

Për të mbjellat (si gruri, misri, tërshëra, thekra, elbi e të ngjashme), nëse arrijnë masën prej **653 kg**, atëherë sasia e zekatit në to është **10%**, në rast se rendimentet e tilla janë ujitur nga shiu (ujitje natyrore), ndërsa në rast se ujitjen artificialisht, atëherë sasia e zekatit të tyre është **5%**.

ZEKATI NË LOPË, BUAJ DHE BUALLICA

PREJ

JEPET

30-39 lopë/buaj

1 viç njëvjeçar

40-59 lopë/buaj

1 viç dyvjeçar

60-69 lopë/buaj

2 viça njëvjeçarë

70-79 lopë/buaj

1 viç njëvjeçar dhe 1 viç dyvjeçar

80-89 lopë/buaj

2 viça dyvjeçarë

90-99 lopë/buaj

3 viça njëvjeçarë

SHËNIM: Zekati në kohën e Pejgamberit, alejhi selam, jepej në Bejtul-Mal, e që përfaqësonte institucionin që e kishte ngritur vetë ai, alejhi slam.

NË KOHËN TONË KY INSTITUCION ËSHTË BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS!

Për shkak të luhatjeve të forta të çmimit të arit në berzat botërore, ju bëjmë me dije se vlerat monetare të paraqitura në tabelë janë MOMENTALE

DITURIA ISLAME • Nr. 424 | MARS 2026